

**Reagime**  
Kush dëshiron  
ta destabilizojë  
BFI-në?

Fq.3




**QEVERI**  
Në pritje të  
Inspektoratit  
për përdorimin  
e gjuhëve

Fq.6



**Erdhi  
jeta në  
Maqedo-  
ninë e  
Veriut**

Fq.10



# Koha

www.koha.mk



Libri si  
ilaç

Fq.18

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XIII · Numri 3644 · e enjte, 25 prill 2019

8°C | 26°C

15 DEN

EDITORIAL

Rrugët e pa  
ndërtuara,  
humbjet  
me miliona



Kosova në fund të muajin maj do të lëshojë në përdorim autostradën "Arbën Xhaferi", që lidh Prishtinën me Hanin e Elezit, e që do të mundësojë që me një shpejtësi të lejueshme prej 130 kilometrash - në Prishtinë të arrihet për një orë. Prej Shkupit përmes Prishtinës deri në Tiranë arrihet për katër orë maksimumi përmes Rrugës së Kombit. Në autostradën Zagreb-Split nevojiten katër orë e gjysmë... Fq.2

RAJON

Kosovarët  
morën rreth  
3 miliardë  
euro kredi Fq.14

GLOBI

Pas zjarrit në  
Notre Dame,  
priten stuhi  
në Paris Fq.15



S'KA KUSH I GJYKON GJYKATËSIT SELEKTIV

## DREJTËSI E KALBUR



Dënimi me 38 vjet burg për dy të rinjtë shqiptarë në rastin "Sazdovski", për vepër pothuajse të njëjtë me Boban Iliqin që vrau 4-vjeçar Almir Aliu e që u dënua me vetëm 6 vjet burg, tregon se Maqedonia e Veriut është larg anëtarësimit në BE, ndërsa vazhdon gjyqësori selektiv kur në pyetje janë shqiptarët. Reagimet nuk ndalen, ndërsa opozita shqiptare akuzon pushtetin për fjalë boshe "drejtësi për të gjithë" Fq.4

## Askush s'i ka në pronësi votat e shqiptarëve

Shkup, 24 prill - Me 5 maj në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale 2019 dhe votat e mbi 1.8 milion votues do të zgjedhin njërin nga dy kandidatët, Stevo Pendarovskin, mbështetur nga partitë në pushtet LSDM dhe BDI si dhe , Gordana Siljanovska-Davkova, mbështetur nga partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE. Sipas analizës politike deri në mbajtjen e rrethit të dytë

të zgjedhjeve presidenciale, Pendarovski me orientim pro-evropian dhe rivalja Siljanovska me ideologjinë e vjetër nacionaliste maqedonase, do të vazhdojnë t'i ndajnë votuesit maqedonas për të fituar më shumë vota, por edhe me disa oferta të reja për zgjidhjen e disa çështjeve të hapura të shqiptarëve, në mënyrë që të përfitojnë ndonjë votë nga votë shqiptare. Naser Ziberi analist politik... Fq.5



## EDITORIAL

RRUGËT E PA NDËRTUARA,  
HUMBJET ME MILIONA

Fisnik PASHOLLI

Kosova në fund të muajin maj do të lëshojë në përdorim autostradën "Arbën Xhaferi", që lidh Prishtinën me Hanin e Elezit, e që do të mundësojë që me një shpejtësi të lejueshme prej 130 kilometrash - në Prishtinë të arrihet për një orë. Prej Shkupit përmes Prishtinës deri në Tiranë arrihet për katër orë maksimumi përmes Rrugës së Kombit. Në autostradën Zagreb-Split nevojiten katër orë e gjysmë për të përshkuar këtë trase që lidh Detin Adriatik me kryeqendrën kroate. Të dyja akset rrugore kanë rritur dukshëm numrin e turistëve që frekuentojnë pikat turistike në bregdetin kroat, ndërsa për banorët e Kosovës - vikendet edhe prej tre-katër ditë në Durrës, Tiranë apo Vlorë, janë kthyer në përditshmëri gjatë sezonit veror.

Impakti apo ndikim ekonomik për turizmin në një pjesë të madhe nga ndërtimi i Rrugës së Kombit ka ndikuar në ekonominë shqiptare, e cila vetëm në vitin 2017 ka të ardhura prej 1.5 miliardë euro, ndërsa në vitin 2018 të ardhurat nga turizmi arritën në 1 miliardë e 850 milionë euro.

Në Maqedoninë e Veriut, në të kaluarën është ndërtuar me vonesë autostrada nga Kumanova deri në Gjevgjeli, si dhe janë riparuar, rindërtuar dhe zgjeruar me qindra kilometra rrugë. Pritet se shpejti të lëshohet në përdorim edhe autostrada që lidh Shkupin me Shtipin. Për shkaqe të ndryshme objektive apo edhe subjektive, akoma mbetet e pa ndërtuar autostrada që lidh Shkupin me qendrat turistike të Strugës dhe Ohrit, autostradë kjo që pritet të përfundojë në vitin 2021. Vonesa në ndërtimin e kësaj rrugë të rëndësishme, përkundër riparimeve në një pjesë të kësaj rrugë që lidh Gostivarin me Kërçovën dhe më tej me Liqenin e Ohrit, patjetër se ndikon edhe në rendimentet më të ulëta nga vizitat e turistëve të huaj në këtë perlë turistike të vendit. Bile mbetet e pa ndërtuar si rrugë moderne edhe aksi rrugor që përshkohet me kënaqësi edhe rruga prej Ohrit deri në Shën Naum dhe rruga prej Struge deri në Qafë Thanë.

Akoma mbetet i riparuar edhe aksi rrugor prej Mavrovë deri në Zhironicë në rrugën prej Mavrove deri në Dibër, që gjithashtu përkufizon jo vetëm zhvillimin ekonomik të kësaj zone, por edhe ndikon negativisht në fuqizimin e potencialeve të saja turistike. Mbetet në letër edhe aksi rrugor nga qarkorja e Shkupit deri në kufirin e Bllacës. Në plan është që prej shtatorit të fillojë të rindërtohet aksi rrugor Tetovë-Kodra e Diellit. Vitet e kaluara, shtetet e rajonit si Bullgaria, Kroacia, Greqia në mënyrë të përshpejtuar kanë punuar në ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme duke shfrytëzuar edhe fondet evropiane.

Në Serbinë fqinje pritet që deri në fund të muajit prill të lëshohet në përdorim një aks mjaft i vështirë i autostradës Shkup-Beograd nëpër grykën e Gërdelicës, me çka finalizohet Korridori 10 nëpër Serbi. Vlerësohet se rrugët e mira dhe moderne ndikojnë në qarkullimin e shpejtë të mallrave dhe njerëzve, apo me fjalë të tjera - qendrat turistike qoftë malore, banjave apo të detit, kthejnë katër herë më shumë të holla nga mjetet e investuara në infrastrukturë. Andaj edhe humbjet nga rrugët e pa ndërtuara vështirë se mund të llogariten, por me siguri se mund të vlerësohen në qindra e qindra milionë euro për çdo vit të humbur.

Si shtet që varem nga transporti tokësor, mbetet që në të ardhmen të kemi një angazhim më të madh për të investuar në infrastrukturë, për shkak se intensiteti i tanishëm i ndërtimit të infrastrukturës rrugore, nuk mjafton jo vetëm në nivel të autostradave, por edhe të rrugëve të kategorive të tjera. Rrugët lokale, rajonale apo edhe autostradat, për një vendbanim qoftë urban apo rural, nënkuptojnë ringjallje ekonomike, zhvillim lokal dhe shpresë për një të ardhme më të mirë.

REKA TË KRIJOJË LËVIZJE  
TË RE NË MAQEDONI!

"Ndoshta Blerim Reka me Shtabin e tij duhet të formojë një Lëvizje qytetare apo edhe Parti politike që i zhveshë hajdutët nga votat partiake të tyre. Sepse ata e dinë shumë mirë se kush është BDI dhe PDSH, por nuk kanë deri sot asnjë alternativë reale se ku mund të drejtohen.

Na duhet një Lëvizje në RMV që iu flet shqiptarëve me një gjuhë qytetare; që do të thotë: iu flet njëkohësisht edhe maqedonasve ashtu siç iu fliste Blerim Reka dhe si depërtoi me më shumë se 8000 vota edhe në qytetet ku ka vetëm qytetarë maqedonas si Gjevgjelia, Strumica, Velesi, Prilepi, Kavadarci, Sveti Nikolle, lagjet që njihen si shoveniste në Shkup- Aerodrom, etj. Na duhet pra një parti e vërtetë qytetare, sepse asnjë parti tjetër nuk është zgjidhje inteligjente e bashkë-ekzistencës në Maqedoni. Të drejtat e barabarta mund t'i fitojmë vetëm atëherë kur maqedonasit na shohin si të barabartë, por ata nuk mund të na shohin si të tillë nëse ne zgjedhim njerëz me diskurse etno nacionaliste, që vazhdimisht flasin sikurse tjetri është armik ekzistencial, etj, etj. Ne duhet ta bëjmë këtë çarje në politikë, dhe aktualisht kjo çarje ka emër dhe mbiemër, quhet Blerim Reka, prandaj është absolutisht e domosdoshme, imperativ politik kohor, që ky moment, ky kapital i akumuluar politik të mos humbet. Është kapital i madh dhe mund të investohet në krijimin e një Lëvizje moderne qytetare. Kjo do të ishte diçka plotësisht e re në politikën tonë, do të ishte njëkohësisht një revolucion në organizimin e partive dhe strukturave politike, do të ishte një përmbyse e vlerave përcarëse me prapavijë etnike, do të ishte një hap i jashtëzakonshëm në krijimin e një hapësire të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të vërtetë mes qytetarëve pavarësisht prapavijave etnike, si dhe do të ishte parti e vërtetë qytetare. Kjo nuk është bërë asnjëherë, dhe atë për dy arsye mendoj:

E para: nuk kemi pasur njerëz vizionarë dhe as shqiptarë, as maqedonas për ta marrë një hap radikal të tillë.

E dyta: nuk ka ekzistuar terren për daljen në skenë të partive të tilla, madje edhe po të kishim kandidatët.

Politika në Maqedoninë tonë, por edhe në Ballkan, në përgjithësi, është bërë në vija të trasha të ndarjeve etnike. Kjo mbase e kuptueshme në kohën e vetë. Tani ka ardhur koha që ta tejkalojmë atë, dhe pasi që ajo nuk tejkalohet vetvetiu, por duhet aktivisht të punojmë për tejkalimin e saj, dhe pasi që ka shkëndija shprese për një realitet të ri qytetar, një gjë e këtille më nuk është e pamundshme. Profesori Reka, është agjenti i fillimit të realizimit të një vizioni qytetar modern për shqiptarët dhe për maqedonasit por edhe për të gjitha grupet e tjera. Unë me gjithë qejf i nënshkruhem një pakti të këtille, shkruan në profilin e tij në FB, profesor Sead Zimeri.

## VOTA E SKLLAVIT

"Skllavi më përpara voton për padronin se sa për të ngjashmin e vet - e kjo me gjasë vlen për shumë popuj, klasa, shtresa e grupe të shtypura shoqërore. Prandaj duhet puna e përditshme organizative dhe strukturuese, e jo thjesht fushata, që të mos e riprodhojë pafundësisht veten skllavëria", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti Arbër Zaimi.

## MEDIACitate

Koalicioni  
opozitar kundër  
zgjedhjeve në  
Shqipëri

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbylli të martën, (23.04.2019) regjistrimin e subjekteve politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Janë 34 subjekte politike që do të konkurrojnë, mes tyre 10 parti opozitare. Por pikërisht në ditën e skadimit të afatit ligjor për regjistrimin në KQZ, dy ngjarje të rëndësishme kanë ndodhur në jetën politike të Tiranës: është krijuar Koalicioni i Bashkuar Opozitar nën drejtimin e Partisë Demokratike, (PD) dhe partia më e re opozitare, "Bindja Demokratike" (BD) ia ka dalë mbanë, në momentin e fundit, të regjistrohet në KQZ.

Dy ngjarjet kanë kahe të kundërta: PD dhe 7 partitë e Koalicionit opozitar vendosën që nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, kurse BD shpalli që do të marrë pjesë si një forcë politike opozitare e djathtë, që ka në përbërje figura të njohura dhe ish-drejtuës të PD edhe pse kryetari i PD, Basha e quajti të martën, "një opozitë fallco". Kryeministri Rama e cilësoi vendimin e koalicionit opozitar për të mos marrë pjesë në zgjedhje, "një tjetër vetëvrasje politike" duke lënë të kuptohet se "vetëvrasja e parë" ishte heqja dorë "në bllok" nga mandatet parlamentare, në shkurtin e kaluar. Ai bëri gjithashtu me dije se zgjedhjet lokale të 30 qershorit, as nuk ndalen as nuk shtyhen.

Por Koalicioni i sapoformuar opozitar në strategjinë e tij synon edhe shtyrjen, edhe ndaljen. Tetë partitë e tij zotohen se "do të regjistrohen për të marrë pjesë në zgjedhje vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Rruga e vetme për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme është formimi i një Qeverie kalimtare, e cila do të përgatisë zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe zgjedhje lokale, të lira e të ndershme". Me fjalë të tjera realizimi prej opozitës i këtij synimi presupozon shtyrjen e zgjedhjeve lokale përtej 30 qershorit.

Largimi i kryeministrit Rama dhe formimi i qeverisë kalimtare përbëjnë për koalicionin "një hap të panegociueshëm që do të garantojë zbatimin e ligjeve aktuale, reformën zgjedhore, zgjedhje të lira dhe të ndershme". Koalicioni nuk ka arritur marrëveshje vetëm të mos marrë pjesë në zgjedhje pa u plotësuar kushtet e mësipërme. (DW, 24 prill)

REAGIME PAS NDËRHJRJES SË GJYQËSORIT NË PËRZGJEDHJEN E REISIT

# KUSH DËSHIRON TA DESTABILIZOJË BFI-në?

"Kjo është normale, është ditë rutine e punës. Kemi takimet e rregullta...", tha Rexhepi pasi u ul në zyrën e tij në BFI. Në ndërkohë, vazhdojnë reagimet kundër përfshirjes së politikës në puçin e radhës në BFI. Përveç partive shqiptare në pushtet, ka reaguar edhe opozita shqiptare, por edhe VMRO-DPMNE



re Islame".

Edhe Aleanca për Shqiptarët ka detektuar tentim për përfshirje të politikës në BFI. "Aleanca për Shqiptarët shpreh shqetësimin e saj në lidhje me rastin e fundit në Bashkësinë Fetare Islame. BFI është një institucion me vlerë të jashtëzakonshme shpirtërore për mijëra besimtarë myslimanë, dhe si tillë duhet të jetë autonom. Fatkeqësisht, politika vazhdon t'i fus duart në këtë institucion dhe të ketë ndikim në këtë Bashkësi. Kreu i BFI-së dëshmoi me gojën e tij se paska qenë i instrumentalizuar nga politika një kohë të gjatë dhe si i tillë - nuk e meriton të mbaj më pozicionin që ka. Ndërsa vendimi i gjykatës ndërmjet dy cikleve zgjedhore bën të dyshosh se përsëri qëllimi është instrumentalizimi për qëllime politike i këtij institucioni", thuhet në reagim. Më tutje, ASH ka kërkuar që rasti të zbardhet dhe publiku të informohet drejt, duke përkujtuar që BFI është institucion që i përket popullit.

"Aleanca për Shqiptarët insiston që rasti të zbardhet dhe opinioni të informohet drejt. Ju përkujtojmë se Bashkësia Fetare Islame është institucion që i përket popullit dhe nuk është vegël partishe dhe qëllimesh politike. Shpresojmë shumë që ky institucion të gjej forcën për të bërë ndryshimet e duhura dhe të domosdoshme, pa u bërë instrument i një strategjie të errët të ndonjë partie po-

litike që kërkon të komandojë edhe Zotin", thuhet në reagimin e ASH-së.

Edhe deputeti i VMRO-DPMNE-së, Vlatko Gjoçev, përmes një postimi në rrjetin social Facebook, ka reaguar ndaj tentimit për shkarkimin e Reis Ul Sulejman Rexhepi nga disa persona, të cilët në mënyrë jashtëligjore hyrën në objektin e BFI-së. Gjoçev për këtë akuzon kryeministrin Zaev dhe deputetin shqiptar nga kjo parti Muhamet Zekiri. Ai thotë se Zaevi dhe Zekiri nuk mund dhe nuk duhet ta zgjedhin kreun e BFI-së. Gjoçev thotë se BFI ka organet e saja, hoxhallarë dhe besimtarë. Gjoçev thotë se me hyrjen e policisë në BFI, është përzjerje direkte e Qeverisë së LSDM-së në punët e brendshme të BFI-së.

## REXHEPI: NUK IA HARROJË KËTË TË KEQE LSDM-SË

Reis Sulejman Rexhepi të martën mbrëma pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Rijasetit të BFI-së kërcënoi LSDM-në se ndërhyrjen në punët e BFI-së asnjëherë nuk do ta harrojnë. "Nga sonte nuk jemi më në të njëjtën anë me këtë qeveri. Këtë të keqe kurrë nuk do t'ju harrojmë", tha Rexhepi, ndërsa akuzoi se vendimi gjykatës është i njëanshëm dhe se BFI asnjëherë nuk do të lejohet të emërohet një marionetë e diriguar nga shteti. "Ky shtet është shtet policor dhe këtu funksionon vetëm pushteti ekzekutiv, nuk ka

as pushtet legjislativ, as pushtet gjyqësor, as prokurori të pavarur... asgjë të pavarur nuk ka. Struktura e pushteti sot kanë pasur premtime të pamohueshme që do të bëjnë reforma të hatashme. Përse Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organet e shtetit janë kundër BFI-së? Unë jam ai i cili ftohesha nëpër shtëpi private për ta luftuar të keqen, Nikolla Gruevskin. Janë këta njerëz të kësaj Qeverie që më ftonin. Unë ju be-tohem se nëse emërohet Skender Buzuku ulema i BFI-së, e njëjta më nuk do të ekzistojë", ka deklaruar kreu i BFI-së, Sulejman Rexhepi, pas mbledhjes të së martës së Rijasetit që u diskutua situata e fundit.

## GJYKATA: VENDIMI PËR REIS UL ULEMA NUK ËSHTË I PLOTFUQISHËM

Gjykata Themelore Shkup 2, me një komunikatë zyrtare ka sqaruar vendimin e marrë për emërimin në procedurë gjyqësore të Skender Buzakut për reis të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut (BFI) nga gjykatësja Suzana Donçevska. Madje, nga Gjykata theksojnë se nuk bëjnë ndryshime, por se gjykata zbaton dhe vërteton vendime të BFI-së që janë sjell në seancë të jashtëzakonshme të Riassetit e në bazë të nenit 36 dhe nenit 68 nga Kushtetuta e BFI-së.

"Në bazë të sjelljes së dorëheqjes së përvokueshme të Reis Ul Ulema-së të Bashkësisë Fetare Isla-

me, Sulejman Ef. Rexhepi e pranuar me datën 25.03.2019 dhe të evidentuar me numër 15-13/174, Rijaseti i BFI-së në R.M.V me datën 30.03.2019 ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme ku është pranuar dorëheqja e Reis Ul Ulema-së të deritanishmit dhe në të njëjtën seancë për Reis Ul Ulema është zgjedhur Skender Buzaku. Në bazë të vendimeve të miratuara të Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame në datën 03.04.2019, në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup është parashtruar kërkesë për ndryshim të personit për përfaqësim të BFI-së", thuhet në njoftimin e Gjykatës Themelore Shkup 2.

Nga atje thonë se kanë vepruar në bazë të kërkesës së parashtruar, në datën 17 prill 2019, dhe është sjell Aktvendim me të cilën kërkesa e BFI për ndryshim dhe kryerje të funksionit Reis Ul Ulema është pranuar dhe në bazë të dokumenteve të parashtruara është kryer ndryshimi i funksionit Reis Ul Ulema, dhe si Reis Ul Ulema është regjistruar Skender Buzaku. Megjithatë, askund në njoftim nuk theksohet se kush i ka dorëzuar procesverbalet, të cilët BFI thotë se janë të falsifikuara. Ndërsa në lidhje me pyetjen nga gazetarët se dorëheqja e përvokueshme e Reis Ul Ulema Sulejman Rexhepi është apo jo e falsifikuar, nga Gjykata thonë se ajo mund të jetë lëndë e një procesi tjetër.

"Në procedurën në pajtim me Ligjin për Gjendje Juridike të kishës, Bashkësisë Fetare dhe Grupe Religjioze, gjykata kryen vetëm vërtetim të vendimeve të miratuara nga Bashkësia Fetare dhe të njëjtat i shpreh në Aktvendim për ndryshim. E theksuara aq më tepër është se të gjitha vendimet në kërkesën për ndryshim të Reis Ul Ulema-së janë me vull të Bashkësisë Fetare dhe të evidentuara me numër në librin evidentues të bashkësisë", thonë nga Gjykata Themelore Shkup 2.

Ndryshe, Drejtoria e Policisë Financiare i ka përgënjeshtro informacionet se të martën, nga ana e personave të autorizuar të Drejtorisë është kryer verifikim dhe kontroll në hapësirat e Bashkësisë Fetare Islame (BFI). "Drejtorja e Policisë Financiare nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi dhe aktiviteti me qëllim të kontrollimit të punës financiare të BFI-së", theksohet në njoftimin drejtuar mediave, ndërsa shtojnë se dje, kanë marrë paraqitje me shkrim me kërkesë për kontroll financiar në BFI. Edhe Ministria e Punëve të Brendshme ka hedhur poshtë akuzat e drejtuara nga zyrtarë të BFI-së se ministri Oliver Spasovski dhe vet MPB ka gisht në puçin e radhës në institucionin fetar islam.

Koha Destan JONUZI

Shkup, 24 prill - Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Sulejman ef. Rexhepi ka nisur ditën e djeshme njëjtë sikurse ditëve tjera në zyrë dhe brenda objektit të BFI-së, njëjtë sikurse ditëve tjera. Në objektin e BFI-së nuk erdhi reisi i shpallur dje nga Gjykata Shkup II, Skender Buzaku. "Kjo është normale, është ditë rutine e punës. Kemi takimet e rregullta...", tha Rexhepi pasi u ul në zyrën e tij në BFI. Në ndërkohë, vazhdojnë reagimet kundër përfshirjes së politikës në puçin e radhës në BFI. Përveç partive shqiptare në pushtet, ka reaguar edhe opozita shqiptare, por edhe VMRO-DPMNE.

## POLITIKA LARG BFI-SË

Për BDI, është e papranueshme që struktura të caktuara të ndërhyjnë në punën autonome të institucionit më të lartë fetar islam në vend. "Bashkimi Demokratik për Integrim shpreh pakënaqësinë e plotë për mënyrën se si disa struktura tentuan të ndërhyjnë në punën e Bashkësisë Fetare Islame. Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet sekular dhe pavarësia e bashkësive fetare është kategori kushtetuese, të cilën institucionet e shtetit duhet ta garantojnë. Si parti politike japim mbështetje të plotë autonomisë së Bashkësisë Fetare Islame dhe vlerësojmë se kompetentë të vetëm për zgjidhjen e çështjeve të brendshme janë organet e Bashkësisë Fetare Islame dhe askush tjetër", thuhet në reagimin e BDI-së. Më tutje, kjo parti ka apeluar deri tek të gjitha institucionet që të veprojnë konform parimeve kushtetuese. "Apelojmë te të gjithë institucionet qeveritare dhe gjyqësore të veprojnë konform parimeve kushtetuese që garantojnë autonominë dhe pavarësinë e bashkësive fetare dhe t'i respektojnë vendimet e organeve të Bashkësisë Feta-

## BUZAKU NUK TREGON KUSH I FALSIFIKOI PROCESVERBALET

Skender Buzaku, reisi i shpallur me një vendim të Gjykatës Shkup 2, edhe pse një ditë më parë premtoi, të mërkurën nuk u paraqit në zyrat e BFI-së. Megjithëse nuk përgjigjet drejtpërdrejt në akuzat për falsifikim të procesverbeleve ku thuhet se Rexhepi ka dhënë dorëheqje, ai këmbëngulë se vendimi i Gjykatës Shkup 2 është valid. "Nuk presim ne që Sulejman Rexhepi të thotë diçka të mirë, të gjitha procedurat e brendshme edhe aktet janë respektuar në mënyrë



demokratike dhe Gjykata ka marrë vendim. Të gjitha aktet e brendshme çka është dashur të respektohen, janë respektuar. Kështu që, ai që ka ankesa mund të bëjë ankesa. Unë tanimë jam reis", ka thënë për KOHA, Buzaku, ndërsa në pyetjen se pse nuk është në zyrë nëse është reis legjitim, Buzaku përgjigjet: "Do të bëjë padi për masë të përkohshme që të më jepet mundësia që të vazhdojë punën në objekt. Por nuk luftohet për objekt, por luftohet për procedurë".



### Pollozhani: Segregacion të këtyllë nuk ka pasur as në kohën e komunizmit

"Gjykatat maqedonase e shfrytëzojnë ligjin si peshkatori rrjetën. Kur janë në pyetje shqiptarët, e përdorin rrjetin për ti gjuajtur edhe krijesat më të imta të ujit, kurse kur janë në pyetje maqedonasit, ata e përdorin rrjetin nëpër të cilin mundet të kalojë edhe një peshkaqen. Kjo drejtësi selektive është shumë ofenduese dhe diskriminuese për shqiptarët. Diskriminim dhe segregacion të këtyllë nuk ka pasur as në kohën e komunizmit. Turp i madh për klasën shqiptare politike. Diskriminimi i shqiptarëve nga gjykatat fashiste duhet të vihet në rend dite në Parlament", thotë Shpëtim Pollozhani, kryetar i Shoqatës së të burgosurve politik shqiptarë.



### Rexhepi: Të ndërhyjë Këshilli i prokurorëve

"Është koha që Këshilli Gjyqësor të jetë institucion bartës i një procesi shumë të nevojshëm, edhe për shtetin edhe për qytetarët të jetë më me përgjegjësi dhe më funksional. Këshilli gjyqësor është Qeveria e gjyqësorisë, nuk mund të ndërhyjë në lëndët, por në çështjet procedurale të gjyqit dhe tek gjykatësit, është më se kompetent. Nuk mund ta ndryshojë vendimin e gjyqit Këshilli Gjyqësor, por në rast të shkeljeve procedurale, Këshilli Gjyqësor është kompetent dhe i thirrur të ndërhyjë, sidomos në rastin e fundit në BFI. Është koha që Këshilli gjyqësor në këtë moment serioz që jemi, para anëtarësimit në NATO dhe BE, ku gjithë sytë e faktorit ndërkombëtar janë drejtuar nga reformat, të jetë më funksional dhe transparent. Shteti dhe qytetarët janë të etur për një shtet ligjor", thotë Bekim Rexhepi, ish-anëtar i Këshillit të prokurorëve.

Dënimi me 38 vjet burg për dy të rinjtë shqiptarë në rastin "Sazdovski", për vepër pothuajse të njëjtë me Boban Iliqin që vrau 4-vjeçar Almir Aliu e që u dënua me vetëm 6 vjet burg, tregon se Maqedonia e Veriut është larg anëtarësimit në BE, ndërsa vazhdon gjyqësori selektiv kur në pyetje janë shqiptarët. Reagimet nuk ndalen, ndërsa opozita shqiptare akuzon pushtetin për fjalë boshe "drejtësi për të gjithë"

Koha Vedat MEMEDALIU

Shkup, 25 prill - Gjykimi i dy të rinjve shqiptarë, Besir Bela dhe Skender Demirin me 38 vjet burg, nga 19 për secilin, në rastin "Sazdovski" tregon se drejtësia e kalbur dhe selektive vazhdon të qëndrojë këmbëkryq në Maqedoninë e Veriut. Madje, të kota duken deklaratat se reformat në drejtësi kanë filluar dhe se vendi është gati të nis negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Aktakuza "vrasje në mënyrë mizore" për Belën dhe Demirin është aktakuzë një shkallë më poshtë se vepra "terrorizëm", ndërsa të njëjtit u dënuan më maksimum vite burg, edhe pse asnjë dëshmi nga pala mbrojtëse nuk u pranua nga Trupi gjyqësor i udhëhequr nga gjykatësjja Daniella Aleksovska - Stojanovska. Reagime të shumta vijojnë në opinion, ndërsa janë prononcuar edhe partitë politike shqiptare në vend.

Deputeti Artan Grubi dje nga foltorja e Parlamentit kërkoi që pika e tretë nga rendi i ditës, e cila kishte të bëjë me Propozim-ligjin për Këshillin gjyqësor Maqedonisë në lexim të dytë, të jetë pika e parë nga rendi i ditës. Ai, kërkesën e justifikoi me ngjarjet e djeshme me Bashkësinë Fetare Islame (BFI) dhe Gjykatën dhe Gjykatën dhe, siç tha, nevojat për reforma të thella në gjyqësi. "Vendimi për BFI-në është absolutisht e papranueshme për BDI-në dhe bashkësinë myslimane. Të njëjten ditë ka ndodhur një aktvendim skandaloz gjyqësor, me të cilin u dëshmuar drejtësia selektive, qoftë të përkatësisë etnike, fetare ose partiake. Janë dënuar dy të rinj me dënim me burg prej nga 19 vjet, ndërsa vrasësi i Almiriut të vogël vetëm me gjashtë vjet burg. Nëse kjo nuk është drejtësi selektive, atëherë nuk e di çka është. Dëshmi për drejtësi selektive janë edhe rastet 'Sopot' dhe 'Monstra', tha Grubi.

Mbështetje Grubi pati edhe nga koordinatori i VMRO-DPMNE-së, deputeti Nikolla Mickoski,

S'KA KUSH I GJYKON GJYKATËSIT SELEKTIV

# DREJTËSI E KALBUR PËR SHQIPTARËT



KONSTADIN KONSTADINOV

**Zëdhënësi i LSDM-së, Konstadin Konstadinov, nuk ka pranuar të komentojë drejtësinë selektive, konkretisht dënimin në rastin "Sazdovski" dhe atë të Boban Iliqit në rastin e Almir Aliut. "Ne asnjëherë nuk kemi komentuar vendime gjyqësore", ka thënë shkurt Konstadinov.**

tha se edhe ai i bashkohet kërkesës, sepse, siç tha, VMRO-DPMNE-ja vazhdimisht sugjeron në të gjitha këto punë dhe është nën sulm direkt të këtij pushteti.

"Regjimi është gjallë, vrasja aksidentale u dënua si vrasje mi-

zore", thotë kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela. "Kush kënd do ta përkrah? Kush me cilin bën tregti e pazar? Me Stevon a me Gordanën? Po kush është me hallet e shqiptarit të zakonshëm?! Po, po sot para hundës tuaj vrasja aksidentale u dënua si vrasje mizore. Tridhjetë e tetë vite burg! Dje vrasja mizore e Almiriut u trajtua si aksident trafiku dhe liri për vrasësin. Filantropi dënohet për terrorizëm e terroristi amnistohet. Në gjykata s'ka rëndësi vepra që ke bërë, por emri dhe mbiemri që mban dhe gjuha që flet. Sklleverit duhet dënuar që qytetarët të jenë të kënaqur. Regjimi është ende gjallë", thotë Sela.

**KASAMI: REFORMA  
BOSHETË ZAEVIT**

Drejtësi tjetër për shqiptarët dhe tjetër për maqedonasit, ndërsa deklaratat e kryeministrit Zoran Zaev për reformim të sistemit gjyqësor, janë boshe dhe jo serioze, thotë për gazetën KOHA, krye-

tari i Lëvizjes BESA, Bilall Kasami. "Vendimet e fundit të gjykatave në vend që lidhen me rastin e 'Sazdovskit' si dhe rastin e BFI-së, janë skandaloze dhe tregojnë edhe një herë se sa tendencioze dhe selektive janë gjykatat në vend. Duke iu referuar deklaratave publike të kryeministrit, se në vend nevojiten reforma në drejtësi, siç duket mbeten vetëm deklarata boshe dhe për pikë politike. Problemi kryesor i gjyqësorit edhe më tej ngelet kualifikimi i veprave penale, varësisht nga përkatësia etnike e kryerësit të veprës penale, veçanërisht kur janë në pyetje shqiptarët, ashtu edhe shqiptohet lartësia e dënimit ndaj autorëve të asaj veprë penale. Kjo tregon se në Maqedoni ende kemi drejtësi selektive dhe nuk kemi 'drejtësi për të gjithë', e cila do t'i ngjante një drejtësie ashtu siç janë në shtetet perëndimore", thotë Kasami. Si Lëvizje BESA, thotë ai, kërkojmë rishqyrtimin e këtyre rasteve nga gjykatat e vendit.

## "SAZDOVSKI", VENDIM JASHTË ÇDO PRAKTIKE GJYQËSORE

Dënimi i shqiptuar nga gjykatësjja e Gjykatës Shkupi 1 është jashtë kuadrit të praktikës gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kështu shpreh avokati Bashkim Ameti, ndërsa thotë se praktika gjyqësore askund në botë nuk njeh dënime të këtyllë në raste si ajo e "Sazdovskit". "Nëse merret dhe analizohet praktika gjyqësore për raste të këtyllë dhe të ngjashme si kjo, do të konstatohet se dënimet janë dukshëm më të ulta se sa dënimi që u shqiptua për të akuzuarit Bela dhe Demiri. Jeta e gjithsecilit



qytetar duhet të mbrohet nga forca e Ligjit, pa dallim etnie e statusi civil, por edhe ndëshkimet duhet bazuar në ligj dhe në praktikën gjyqësore. Kurse vendimet gjyqësore nuk duhen keqpërdorur nga partitë politike për poenë politik, sepse çdo koment politik vetëm se shkon në dëm të drejtësisë së vërtetë. Prej nesër, sytë e opinionit duhet drejtuar nga Gjykata e Apelit, e cila është vendi ku duhet rishqyrtuar ky vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë", thotë Ameti.

"Lëvizja BESA kërkon sqarime nga gjykata, prokuroria dhe ekspertiza që njëherit janë edhe hallka kyçe në proceset gjyqësore: Si mund që vrasjet me paramendim t'i rikualifikoj si vepra penale të kryera nga fatkeqësia në komunikacion me pasoja vdekjeprurëse si në rastin e Almiri, me pretextin që e njejtë vepër nuk është kryer me paramendim dhe për kryerësin (Boban Iliq) të shqiptohet dënimi me vetëm 6 vite burg? Ndërsa në anën tjetër për një tjetër rast me pothuajse pasoja identike (vdekjeprurëse), mirëpo me autorë të veprës penale në këtë rast dy shqiptarë, kualifikim i veprës penale (vrasje në mënyrë të dhunshme) të jetë kaq i ndryshëm nga rasti i Almiri dhe shqiptimi i dënimit të jetë shumë më i lartë me nga 19 vite vuajtje burg! Ne si Lëvizje BESA kërkojmë rishqyrtimin e këtyre dy rasteve, por edhe gjithë rasteve të tjera të gjykuara me prapavijë politike dhe diskriminuese ndaj shqiptarëve", thotë Kasami.

#### "ALMIRI" DHE DËSHIMI I DREJTËSISË

Por, e kundërta e vendimit në rastin "Sazdovski" shihet te vendimi për vrasjen e Almir Aliu. Katër vjeçari nga Kumanova u shkelë për vdekje nga Boban Iliq, vrasës ky që nga Gjykata e Kumanovës u dënua me vetëm 6 vite burg, ndërsa vepra penale nga "vrasje" u rikualifikua në "aksident me pasojë vdekje". Pati protesta, reagime, por gjykata e bëri të veten. Gjykata e Apelit e riktheu rastin nga fillimi, megjithëse gjykatësja Maja Denkoska dhe prokurorja e lëndës, Suzana Kusigerska, kanë vendosur të mos i marrin parasysh vërejtjet e Apelit, ndërsa rigjykimi që pritet të fillojë më 16 maj, do të nis me dëshmi të vjetra dhe ekspertizë të falsifikuar.

Dhe, në gjithë këtë falje të vrasësit, ishte kryeprokurori Lubomir Jovevski, mbrojti vendimin për rikualifikim të lëndës, ndërsa nuk bëhet i gjallë kur shqiptarët, për vepër të njëjtë sikurse Boban Iliqi, dënohen me trefishin e dënimit real.

Edhe ndërhyrja e gjyqësisë në rastin e përzgjedhjes së kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame tregon se drejtësia i fut gishtat vetëm kur në pyetje janë shqiptarët dhe institucionet islame. Nuk njih historia e drejtësisë në Maqedoni rast kur gjyqësia apo gjykatës të caktuar përzihen në punët e Kishës Ortodokse të Maqedonisë, ndërsa politika maqedonase e mbështetur nga drejtësia selektive gjithmonë kanë "kërcënuar" krerët e BFI-së për hetime dhe masa tjera ndëshkuese.

#### JANUSHEV:

##### LSDM TREGON ZHGENJIMIN

"Drejtësia në Maqedoni është e kapur, kemi të përdjekur politik, ndërsa sistemi gjyqësor vështirë po reformohet. Nuk duam ti komentojmë vendimet e fundit gjyqësor, për shkak të sensitivitetit dhe ngjeshmërisë, por edhe për shkak të fushatës zgjedhore", thonë nga VMRO-DPMNE.

"Ndodhitë e fundit në Bashkësinë Fetare Islame të Maqedonisë (BFI) i kualifikojmë si skandaloze dhe të palejueshme, dhe ashpër i dënojmë. Ajo që pamë është përzjerje e shtetit në punën e bashkësive fetare, që për Maqedoninë si shtet sekular, është plotësisht e papranueshme. Të kujtojmë vetëm se, në të kaluarën, nënkryetari i Zaevit, nënkryetari i LSDM-së, jepte kualifikime për Reisin e BFI-së ku e quante rezil, e keqja, maçorri i mbrojtur e të ngjashme. Ashpër e dënojmë futjen e shtetit në punët e bashkësive fetare. Presim që institucionet përgjegjëse, të cilat u paraqitën në vendin e ngjarjes me porosi dhe e bënë atë që e pamë të gjithë të martën, presim të tërhiqen dhe t'i marrin të gjitha masat për pastrimin e këtij rasti. Ne disa herë kemi theksuar se gjithçka që ka ndodhur në periudhën e fundit, posaçërisht kjo dje dhe ajo para zgjedhjeve, është zhgënjimi i LSDM-së në zgjedhje dhe në prag të raundit të dytë të zgjedhjeve presidenciale. Pushteti nuk ka legjitimitet, LSDM për dy vite me pushtetin e saj dyvjeçarë, padrejtësitë, kriminalitetin dhe korrupsionin, ka humbur rreth 300 mijë vota", ka thënë në takimin e së martës me gazetarët, zëdhënësi Igor Janushev, sekretar i përgjithshëm i VMRO-DPMNE-së.

## RRETHI I DYTË, NJË GARË EVËSHTIRË

# ASKUSH S'I KA NË PRONËSI VOTAT E SHQIPTARËVE

Në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale më 5 maj, do të jetë garë e vështirë mes kandidatit të LSDM-së Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska nga VMRO-DPMNE. Sipas analistëve beteja kryesore do të jetë se si të motivohen votuesit shqiptarë që të dalin në numër më të madh në votime sepse tani shqiptarët nuk kanë kandidat të tyre



Koha

Zejnula VESELI

Shkup, 24 prill - Me 5 maj në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale 2019 dhe votat e mbi 1.8 milion votues do të zgjedhin njërin nga dy kandidatët, Stevo Pendarovskin, mbështetur nga partitë në pushtet LSDM dhe BDI si dhe , Gordana Siljanovska-Davkova, mbështetur nga partia opozitare maqedonase VMRO-DPMNE. Sipas analistëve politik deri në mbajtjen e rrethit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, Pendarovski me orientim pro-evropian dhe rivalja Siljanovska me ideologjinë e vjetër nacionaliste maqedonase, do të vazhdojnë t'i ndajnë votuesit maqedonas për të fituar më shumë vota, por edhe me disa oferta të reja për zgjidhjen e disa çështjeve të hapura të shqiptarëve, në mënyrë që të përfitojnë ndonjë votë nga votë shqiptare. Naser Ziberi analist politik vlerëson se rrethi i dytë i zgjedhjeve presidenciale më 5 maj do të jetë një garë e vështirë në aspektin se si ta motivojnë elektoratin të dalin në votime. "Duhet të ofrojnë diçka më shumë e sidomos për votuesit shqiptarë. Është bukur vështirë që edhe njëherë të motivohet elektorati që të ketë pjesëmarrje më masovike duke pasur parasysh se në rrethin e parë mezi u arrit pragu zgjedhor. Pra beteja kryesore do të jetë se si të motivohet votuesit e sidomos elektorati shqiptarë që të dalin në numër më të madh në votime sepse tani shqiptarë nuk kanë kandidat të tyre që duhet të dalin e ta votojnë", thotë Ziberi. Ndërsa sa i përket rezultatit final te zgjedhjeve të 5 majit Ziberi supozon se kandidati i shumicës parlemenater do të jetë fitues. "Me vetë faktin se retorikën të cilën e përdori 20 ditë gjatë fushatës zgjedhore para mbajtjes së rrethit të parë të zgjedhjeve Siljanovska si kandidate e VMRO-DPMNE-së përjashtojnë e mundësinë që në rrethin e dytë ta voton elektorati shqiptarë. E ne veçanti duke pasur në konsideratë të kaluarën e kandidates dhe VMRO-DPMNE-së rreth çështjeve siç janë ligji për gjuhën shqipe dhe disa ligje tjera që

avancojnë çështjen shqiptare dhe Marrëveshjes së Prespës Ato votues shqiptarë që do të dalin të votojnë me 5 maj jam shumë i bindur se nuk do të përcaktohen për kandidaten e VMRO-DPMNE-së", thotë Ziberi. Mirëpo por kur është fjala për retorikën që në fushatë e përdori kandidati i LSDM-së mbështetur nga BDI-ja e cila ishte shumë ndryshe nga kundër kandidatja kryesore Siljanovska Ziberi është i bindur se qytetarët shqiptarë tani më e kanë të qartë se duhet të mbështete Pendarovski për kryetar të shtetit. "Sigurisht rrethin e dytë Pendarovski do të ketë me shumë vota në raport me kandidaten e VMRO-DPMNE-së. Përsërisht edhe njëherë kjo do të e jet e mundshme vetëm nëse në rrethin e dytë plotësohet pragu zgjedhor prej 40 për qind dalje në votim. Ajo që është e rëndësishme në këto zgjedhje e që u vërtetua edhe në rrethin e parë është se votuesit shqiptarë do të votojnë sipas bindjes së tyre. Edhe ne rrethin e dytë shanset janë shumë të vogla që elektorati shqiptarë të ndikohen nga institucionet partiake", thotë Naser Ziberi. Analistja politike Olivera Trajkovska shprehet se në rrethin e parë të zgjedhjeve ideja për votimin e një kandidati konsensual nga partitë në pushtet u tregua jo e mirë sepse elektorati votues nuk i dha mbështetjen ashtu siç i kishin bërë matematikat LSDM e sidomos BDI.

"U pa qartë se kjo ide e konsensualitetit dështoi. Ideja se është koha për kandidat konsensual që në start dështoi. Rezultate përfundimtare të rrethit të parë për dalje shumë të vogël të votuesve ndodhi për shkak se dikush idenë e BDI-së nuk e përkrahi për kandidat konsensual për president shteti", thotë Trajkovska. Trajkovska shprehet se kur kemi parasysh se ideja e konsensualitetit kishte përparësi në rrethin e parë votuesit, treguan se këtë ide e përjashtojnë.

"Mendoj se nuk është fer nga BDI-ja që ende manipulon me votuesit në përgjithësi se pa amin e saj nuk mund të ketë president shteti dhe kjo është përpjekje e gabuar, sepse si do që të

vendosin se cilin kandidat ta votojnë votuesit shqiptarë në rrethin e dytë, BDI-aspak nuk të drejtë të deklaroj se është meritë e saj. Gjithashtu do përpiqet të bind votuesit shqiptarë se rrethi i parë ishte një garë ku Aleanca dhe BESA nuk fituan asgjë. Nëse në rrethin e dytë kemi rezultat që do ta zgjedhë presidentin e shtetit, BDI-ja këtë do ta llogaris si meritë të sajën që nuk do të jetë aspak e vërtetë. BDI në terren vetë e minoi idenë e konsensualitetit vetëm e vetëm të dëshmojë se në rrethin e dytë të dëshmojë se sa e fortë është politikisht", thotë Olivera Trajkovska analiste politike. Ndërkaq sa i përket çështjes se a ka mosmarrëveshje midis Aleancës për Shqiptarët dhe Lëvizjes BESA që mbështetin kandidaturën e Blerim Reka rreth asaj se 80 mijë votat e rrethit të parë, në rrethin e dytë mund të shkojnë për kandidatin e VMRO-DPMNE-së, Arjanit Hoxha nga Lëvizja Besa i quan spekulime sepse edhe Reka por edhe liderët e dy partive pas përfundimit të rrethit të parë deklaruan se me votat e shqiptarëve për Rekën nuk do të bëhen pazare me asnjërin prej kandidatëve.

"Nuk besoj se ka përçarje midis dy partitë që mbështetin Blerim Rekën për president shteti. Deklarata e fundit e të dy liderëve dhe kandidatit ishin të qarta se nuk do të bëhet pazar me votën e votuesve të Rekës. Kjo është zyrtare dhe jashtë kësaj asgjë tjetër nuk është e vërtetë", shton Hoxha. Ndërsa sa përket çështjes se në rrethin e dytë elektorati duhet të del të votoj ashtu siç do të kërkojnë partitë shqiptare, si në pozitë apo opozita, Hoxha shprehet se kjo nuk do të ndodhë. "Liderët e partive dhe kandidati Reka i falënderuan votuesit që e dhanë votën e tyre për konceptin tonë. Mendoj se në këto zgjedhje për herë të parë votuesit shqiptarë treguan se e bëjnë atë që mendojnë se është më mirë par ata. Votuesit shqiptarë treguan vetëdije të lartë dhe nuk pin ujë më ajo forma që dikush tjetër t'i urdhëroj ata se për kë duhet të votojnë dhe se asnjë parti shqiptare nuk i ka në pronësi të tyre", tha për KOHA, Arjanit Hoxha.

MINISTRIA E DREJTËSISË VONON PROPOZIM-LIGJIN

# NË PRITJE TË INSPEKTORATIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Informatat e fundit janë se Ligji është në fazën përfundimtare të përgatitjes dhe sipas Hoxhës, pritet që së shpejti këto dy ligjet t'i dërgohen Qeverisë për miratim

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 24 prill - Inspektorati dhe Agjencia për mbikëqyrjen e përdorimit të gjuhës shqipe janë dy institucione që dalin nga ligji për përdorimin e gjuhëve dhe të njëjtit shumë shpejt do të fillojnë me funksionim e plotë të tyre. Sipas zëdhënësit të Qeverisë, Muhamet Hoxha, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim të veçantë ka obliguar Ministrinë e Drejtësisë të përgatis Propozim-ligjin për inspektoratin. Informatat e fundit janë se Ligji është në fazën përfundimtare të përgatitjes dhe sipas Hoxhës, pritet që së shpejti këto dy ligjet t'i dërgohen Qeverisë për miratim.

"Pasi Qeveria në njërin nga seancat e radhës do të miratoj Ligjin për Inspektoratin, i njëjti do t'i dorëzohet Parlamentit për miratim. Me fillim e punës të këtyre dy institucioneve për mbikëqyrjen e përdorimit të gjuhës shqipe, dukshëm do të ketë efekte pozitive që në të ardhmen mos të kemi gabime gjuhësore në mbishkrimet në institucionet e pushtetit qendror dhe atij lokal", tha Hoxha. Ai informoi se në mbledhjen e



fundit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut u shqyrtua dhe u miratua Informacioni për rritjen e pjesëmarrjes së shteteve anëtare në buxhetin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, në funksionin e realizimit të aktiviteteve programore dhe solli konkluzion të obligojë Ministrinë e Punëve të Jashtme në kuadër të koordinimit të saj me Fondin e Ballkanit Perëndimor të konfirmojë gatishmërinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke filluar nga viti 2019, për arkëtimin e kontributeve vjetore ndaj buxhetit në Fondin për Ballkanin Perëndimor, të përcaktuara me vlerë prej 60.000 mijë eurosh.

Gjithashtu, Hoxha njoftoi se në seancën e fundit Qeveria nxori vendim për themelimin e Komisionit për zbatimin e procedurës për projektin e partneritetit publiko-privat për ndërtimin e sistemit të ri për shpërndarjen e gazit natyror në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

"Komisioni synon të zbatojë procedurën

e plotë për vendosjen e partneritetit publiko-privat për ndërtimin e sistemit të ri për financimin, projektimin, ndërtimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet ankandit publik për përzgjedhjen e partnerit publik me procedurë të dialogut konkurrues me ankand, përkatësisht të hartojë shpalljen publike, dokumentacionin e tenderit, përfshirë edhe draftin e marrëveshjes dhe të hartojë raport për vlerësimin e ofertave, si dhe Qeverisë t'i dorëzojë propozim për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm për zgjedhjen e partneritet publik për financimin, projektim, ndërtim, menaxhim, mirëmbajtje dhe zhvillim të sistemit të shpërndarjes së gazit natyror në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose propozim për asgjësimin e procedurës", tha Muhamet Hoxha zëdhënës i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Sëmuret dëshmitari, "Maxhar Telekom" shtyhet për më 8 maj

Shkup, 24 prill - Për shkak të problemeve shëndetësore të dëshmitarit Stevica Josifovski, seanca e djeshme për lëndën "Maxhar Telekom" të Prokurorisë Speciale Publike, është shtyrë për më 8 maj, kur do të dëshmojë profesori Borçe Davitkovski. Dëshmitari Josifovski do të dëshmojë më 19 qershor me kërkesë të prokurores Lile Stefanova, me elaborim se duhet të përgatitet për dëshminë e tij, sepse i njëjti në vitin

2009 në Prokurorinë Publike ka dhënë deklaratë se në vijim është hetimi i brendshëm i pavarur të aprovuar nga këshilli i drejtorëve të kompanisë, dhe ka theksuar se pas hetimit do të mund të prononcohet. Ajo nga personi i autorizuar i Telekomit të Maqedonisë ka kërkuar që ky dokument të sigurohet për seancën e radhës, ndërsa përmendi si ai është i klasifikuar si i besuar, nevojitet të bëhet rikualifikimi i tij. Prokurorja Stefa-

nova, me kërkesë të mbrojtjes që të prononcohet për propozimin e tyre në lëndën të dëshmojë ish-kryeministri Vllado Buçkovski, tha se nuk ka mundësi të prononcohet në seancën e sotme, sepse siç sqaroi, duhet të ndërmarrë veprime shtesë, duke theksuar se Buçkovski është i dyshuar në procedurë parahetimore të PSP-së për lëndën e cila është e lidhur me "Maxhar Telekom".



Shkup, 24 prill - Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në kuadër të seancës së 95-të i miratoi më shumë ligje të cilat presidenti Gjorge Ivanov refuzoi t'i nënshkruaj dhe i ktheu mbrapa tek deputetët, në mesin e së cilave edhe ligjet për regjistrin qendror të po-

SEANCA E 95-TË E PARLAMENTIT

## Miratoheh për të dytën herë ligjet që i ktheu Ivanovi


pullatës dhe për zbatimin e sanksioneve. Deputetët, pa debat si ligje në lexim të tretë i votuan edhe ligjet për menaxhim elektronik dhe shërbime elektronike, për shërbime, për duhan, prodhime të duhanit dhe prodhime të ngjashme për regjistrimin e pagesave me para në dorë, për shpërblime shtetërore si edhe për ratifikimin e Marrëveshjes me Malin e Zi për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella pronësore-juridike.

Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, informoi se në pajtim me informacionin e presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Parlamenti këto Ligje i shqyrton si ligje në fazën e leximit të tretë. "Në pajtim me nenin 75 paragrafi 2, Parlamenti përsëri e shqyrton Ligjin dhe nëse e miraton me shumicë votash prej numrit të përgjithshëm të deputetëve presidenti obligohet ta nënshkruaj dekretin", theksoi Xhaferi. Presidenti

aktual i shtetit Gjorge Ivanov, me dekret të 3 prillit 2019 e ka informuar Kuvendin se ka vendosur që të mos i nënshkruaj ligjet e sjellja në seancën e mbajtur më 27 mars 2019. Deputetët paraprakisht e votuan edhe Propozim vendimin për ndryshimin e Vendimit për dërgimin e pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë për pjesëmarrje në operacionin paqësor të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "UNIFIL" në Republikën e

Libanit. Ndryshimi kryesor në propozim vendim është në lidhje me Marrëveshjen e Prespës dhe ndërrimin e fjalëve "Republika e Maqedonisë" me "Republika e Maqedonisë së Veriut" si edhe fjalët "prill" me "maj". Parlamenti në fillim i miratoi propozim ligjet e plotësuar për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik dhe për mbikëqyrje inspektuese, të dy në lexim të dytë.

(Z.V)



## Dy procedura kundërvajtëse kundër Ivanovit

Shkup, 24 prill - Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) në seancën e djeshme solli vendim për ngritjen e dy procedurave kundërvajtëse kundër presidentit të shtetit, Gjorge Ivanov për dekretet e sjella për avancimin dhe vendosjen e eporëve në Armatë gjatë periudhës zgjedhore, të publikuara në Gazetën Zyrtare më 26.02.2019, që paraqet mosrespektim të ndalesave të përcaktuara në Kodin zgjedhor dhe Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe përplasjes së interesave.

Siç u sqarua, presidenti Ivanov me dekret e ka avancuar në pozitë gjeneral-nënkolonel nga gjeneral-major Vasko Gjurçinovskin, shef aktual i Shtatmadhorisë. Është konstatuar se gjatë avancimit të këtij eporri në gradë më të lartë nuk është vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit për shërbim në Armatë, ku qëndron se shefi i Armatës gjegjësisht MM zbaton procedurë për avancim dhe i jep propozim presidentit, që në këtë rast, siç është theksuar në përgjigjen e MM deri tek KSHPK, nuk është dorëzuar. Sipas KSHPK kjo shkakton dyshimet se Ivanov i ka tejkualuar autorizimet ligjore dhe ka sjellë vendim pa zbatimin paraprak të procedurës së përcaktuar me ligj. Me sjelljen dhe zbatimin e dekretit, vlerësojnë nga KSHPK, Gjurçinovskit do t'i jepet pagë e rritur, veprim i cili ndalohe në periudhën e zgjedhjeve.

Me dekretet e presidentit Ivanov me të cilat vendoset gjenerali i brigadës Orce Jordev zëvendëskomandant i KOB dhe nënkolonel Dragan Kovački komandant i Brigadës së parë të mekanizuar këmbësorike dhe kolonel Besnik Emini si shef i Shtabit të KOB, të sjella pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve do t'u paguhet pagë e rritur, veprim i ndaluar në periudhën zgjedhore. Me ndërmarrjen e këtyre veprimeve presidenti Ivanov ka kryer shkelje të dispozitës së nenit 8-a paragrafi 1 linja 2 për çka edhe KSHPK solli vendim për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

Parandalimi i fatkeqësive të mundshme në procesin e punës, por edhe zbatimi i ligjeve në praktikë dhe jo mbetja e tyre shpesh në letër lidhur me sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve mbeten sfidat kryesore të mbrojtjes së punëtorëve në vendin e punës

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 24 prill - Parandalimi i fatkeqësive të mundshme në procesin e punës, por edhe zbatimi i ligjeve në praktikë dhe jo mbetja e tyre shpesh në letër lidhur me sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, mbeten sfidat kryesore të mbrojtjes së punëtorëve në vendin e punës. Në vitin e kaluar janë konstatuar lëndime në punë tek 1790 punëtorë, ndërsa pasoja fatale ka pasur për 23 punëtorë. Si sektorë më të rrezikshëm janë ndërtimtaria, bujqësia, industria përpunuese dhe xehtaria. Kjo ndër të tjerash u theksua në shënimin e 28 prillit si ditë ndërkombëtare e sigurisë dhe shëndetit në punë.

"Ligjet në Maqedoni për shëndetin në vendin e punës janë të mira, mirëpo ngec implementimi i tërësishëm i tyre si dhe i rregulloreve të ndryshme në praktikë. Njëherazi nevojitet që të gjithë së bashku të angazhohemi për kushte më të mira të punës dhe për rritjen e vetëdijes për këtë çështje", thotë Milan Zhivković nga zyra e Fondacionit Fridrih Ebert në Shkup.

PARANDALIMI I FATKEQËSIVE

# PËR SIGURI NUK MJAFTOJNË VETËM LIGJET



Nga Ministria e Punës dhe Çështjes Sociale thonë se trendi i lëndimeve në vendin e punës në shtet nuk është i ri por është konstant, megjithatë si ekzekutiv angazhohen për siguri dhe shëndet më të madh për punëtorët.

"Siguria dhe shëndeti i një punëtorë kanë një rëndësi të madhe për të pasur punëtorët më produktiv. Punëtorët më produktiv nënkuptojnë edhe rritje ekonomike dhe zhvillim të shtetit, andaj në të ardhmen parandalimi i fatkeqësive në punë mbetet një nga prioritetet kryesore. Në këtë drejtim në vitin e kaluar Inspektorati i Punës ka kryer 12 mijë kontrole prej të cilave 7000 kanë qenë të rregullta dhe 5000 kanë qenë pas parashtresave", thotë ministrja e Punës dhe Çështjeve So-

cialle, Mila Carovska. Sipas saj, së shpejti do të dalë edhe raporti me parregullsitë më të mëdha të kësaj fushe, ndërsa përmes dialogut social me të gjitha palët do të punohet në anulimin e tyre.

Sipas ekspertës Jovanka Karaxhinovska nga Këshilli kombëtar për siguri dhe shëndet në punë, ndryshimi i mënyrës së jetesës apo punës si dhe globalizimi imponojnë edhe një qasje ndryshe ndaj mbrojtjes në vendin e punës.

"Prioritet dhe sfida në të ardhmen tek ne dhe në botë do të jenë ndër të tjerash edhe çështjet demografike dhe proceset e plakjes, puna në turme, ekonomia informale, puna e natës, hyrja e grave në tregun e punës, apo edhe fakti se në vend më shumë kemi raste të

vdekjes nga sëmundjet kardiovaskulare", thotë Karaxhinska.

Sipas saj një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet edhe ndryshimeve klimatike, përdorimit më të madhe të teknologjitë e reja, si dhe rreziqet lidhur me teknologjitë informatike dhe robotikën.

Ndryshe, analizat tregojnë se legjislacioni vendor për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës është i harmonizuar me legjislacionin evropian, megjithatë ajo çka mungon është krijimi i një sistemi unik dhe të vetëm për grumbullimin e të dhënave për lëndimet dhe fatkeqësitë në punës për shkak se institucione të ndryshme disponojnë me të dhëna të ndryshme. Kërkohet edhe përmirësimin e mëtejshëm të rregullativës ligjore.

## Qeveria me 60 mijë euro në Fondin për Ballkanin Perëndimor

Shkup, 24 prill - Qeveria vendosi ta rrisë pjesëmarrjen në Fondin për Ballkanin Perëndimor, duke filluar prej këtë vit, informoi zëdhënësi qeveritar Mile Boshnjakovski.

"E rritëm pjesëmarrjen financiare të vendit tonë në Fondin për Ballkanin Perëndimor, me idenë për realizim më të mirë të aktiviteteve programore të këtij fondi, dhe ajo do të thotë se vendi fillon nga viti 2019 të paguajë kontribute vjetore të rritura në buxhetin e këtij Fondi ose në vlerë prej 60.000 euro", tha Boshnjakovski. Ai theksoi se të gjitha qeveritë e rajonit në suaza të këtij Fondi së bashku punojnë në projektet më të madha infrastrukturore të lidhura me sektorin qytetar, me arsimin, që janë në nivel rajonal.

"Të gjitha vendet kontribuojnë, ashtu që edhe ne kontribuojmë. Ky është Fond me mjete që vijnë nga buxhetet e vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga BE-ja dhe nga vendet tjera dhuruese, dhe paratë shpenzohen në projekte të rajonit", shtoi zëdhënësi qeveritar.

Fondi i Ballkanit Perëndimor me seli në Tiranë, është fondi i parë i krijuar nga qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndërsa qëllimi i tij është të përforcohet bashkëpunimi mes vendeve nga rajoni, me qëllim të përparimit të integritimit në Bashkimin Evropian.

## Protestë më 1 Maj

Shkup, 24 prill - Përfaqësues të Konfederatës së organizatave sindikale paralajmëruan se me rastin e 1 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Punës, do të organizojë protestë. Marijan Risteski, përfaqësues i Konfederatës, theksoi se këtë vit

përfaqësuesit sindikal do t'i zgjerojnë kërkesat e tyre për mbrojtje të drejtave të punëtorëve.

Potenco se, për shkak se në kohën e fundit regjistrohen sulme ndaj pjesëmarrësve të policisë pyjore, të burgut si dhe policisë së

rregullt, do të kërkojnë ndryshime ligjore me të cilat do të rritet mbrojtja e tyre. U bëri thirrje të gjithë punëtorëve të përfshihen në protestë.

"Vjen koha e përfaqësuesve sindikalë të cilët dinë se si t'i

mbrojnë të drejtat e punëtorëve. Ka punë jashtë orarit, ka shkelje të drejtave të punëtorëve, nuk respektohet Ligji për marrëdhënie të punës. Ne si punëtorë patjetër duhet ta ngremë zërin", theksoi Risteski.

## Aksion për pastrimin e deponive të egra

Shkup, 24 prill - Ndërmarrja publike "Higjiena Komunale" - Shkup është organizator i aksionit masiv për pastrimin e deponive të egra që filloi dje në të gjitha komunat e Shkupit. Në aksion marrin pjesë administrata e ndërmarrjes dhe komunat, studentët e të gjitha universiteteve të Shkupit, përfaqësuesit e sektorit joqeveritar, si dhe shkollat e mesme dhe fillore. Fillimin e aksionit e shënoi drejtori i NP "Higjiena komunale" - Shkup, Abdusamed Shabani, i cili theksoi se qëllimi i aksionit është ngritja e vetëdijes te qytetarët për

dëmin e veprimt të pandërgjegjshëm me mbeturinat dhe rrezikun e deponive të egra, që siç tha, paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë për qytetarët.

Mjedisi i pastërt është një prej vlerave thelbësore evropiane që duhet t'i promovojmë dhe të punojmë për atë sa më shumë për shkak se "fshesa" hyri në politikën e lartë, dua të dërgojë apel deri te politikanët se duhet të kapen edhe për këtë "fshesën" e vërtetë, reale, që të mund të ballafaqohemi me problemet reale të qytetarëve dhe në këtë mënyrë të vijmë në kon-

takt të drejtpërdrejtë me idetë e tyre dhe propozimet dhe sfidat e tyre, e pikërisht kjo na duhet tani për t'u ballafaquar me qytetarët dhe nevojat e tyre", tha kryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani. Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov theksoi se qyteti i pastërt është diçka që fillimisht e meritojmë. Përdërisa, në vitin 2018 një qytetar prodhon për tetë për qind më shumë mbeturina sesa në vitin 2017.

"Duke e marrë këtë parasysh, qyteti realizoi veprime dhe janë furnizuar kontejner të ri me kapa-



citet më të madh prej 3.2 litrave, automjete të reja, shporta për mbeturina. Qëllimi jonë është që të mundësojmë si qytet, si admini-

stratë infrastrukturë adekuate që të mund qytetarët të sillen në mënyrë adekuate ndaj mbeturinave komunale", tha Shilegov. (Q.A)

FORMOHET QENDRA INFORMATIVE TURISTIKE

# MUNGOJNË TABELAT INFORMUESE PËR TURISTËT



Përveçse në qytetin e Tetovës, mungesa e tabelave të këtilla informuese vërehet edhe përgjatë autostradës Shkup-Tetovë, ku ka tabela për vende të largëta mbi 100 kilometra siç është Vevçani dhe Mavrova, por mungojnë për Xhaminë e Pashës dhe Kodrën e Diellit

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 24 prill - Shumë pak tabela vërehen në qytetin e Tetovës për pikat turistike dhe monumentet historike apo kulturore. Kjo krijon edhe shumë vështirësi për ato turistë që vijnë nga jashtë për orientim më të mirë, ose për vizitë të vendeve që llogariten si atraksion turistik. Tabelat mungojnë për në Kodrën e Diellit, Xhaminë e Pashës, Arabati Baba Teqenë, Hamamin e Tetovës, por edhe për Kalanë e Tetovës. Këto janë ndër të paktët vende në këtë qytet, që vizitohen nga turistë të huaj, por e kanë vështirë që t'i gjejnë lokacionet e tyre, sidomos nëse bëhet fjalë për Arabatin Baba Teqenë, Kalanë apo Kodrën e Diellit. Në seancën e parafundit të këshillit të Komunës së Tetovës, është vendosur që të formohet Qendër Informativ Turistik. Kryetari i këshillit të Komunës së Tetovës,

Bekim Memeti thekson se një qendër e këtillë ka munguar shumë në këtë qytet sepse turistët nuk kanë orientim të saktë për vendndodhjen e këtyre lokaliteteve që kanë peshë historike, fetare apo kulturore.

"Në seancën e fundit miratuar pikën rreth Qendrës Informativ Turistik. Bëhet fjalë për një projekt info dhe promo-qendra të mençura. Ky projekt është propozuar në kuadër të forumeve rajonale të Pollogut dhe është përkrahur nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim, implementuar nga Qendra e Rajonit Planor të Pollogut në bazë të prioritetit. Është një projekt që i ka munguar Tetovës, sidomos turistëve, të cilët vijnë për të vizituar qytetin e Tetovës. Jemi dëshmitarë se më herët nuk kemi patur një qendër të këtillë, dhe kjo do të ndikojë pozitivisht në orientimin e turi-

stëve të cilët vijnë", tha Memeti. Nga ana tjetër, edhe përfaqësues të institucioneve përkatëse shprehin shqetësimin e tyre që nuk ka tabela informuese lidhur me këto objekte që vizitohen nga turistë të huaj.

Nga Xhamia e Pashës kërkohet që institucionet më shumë të bëjnë në këtë drejtim, që të përmirësohet infrastruktura informuese nëpër qytet. Mensur Miftari, Kryetar i Këshillit të Xhamisë së Pashës, shfaq shpresë se institucionet do të gjejnë mënyra dhe forma që të përmirësohet mungesa e tabelave informuese. Ai thotë se objektet apo pikat turistike duhet që më shumë të promovohen nga institucionet.

"Është çështje shumë shqetësuese. Edhe ne si këshill i Xhamisë por edhe si Myftini e Tetovës, jemi të shqetësuar dhe shpresojmë që të paktën institucionet komunale të na përkrahin në këtë

drejtim, pra këto dy apo tri objekte që janë në Tetovë të promovohen edhe më shumë", thotë Miftari nga Këshilli i Xhamisë së Pashës në Tetovë. Përveçse në qytetin e Tetovës, mungesa e tabelave të këtilla informuese vërehet edhe përgjatë autostradës Shkup-Tetovë, ku ka tabela për vende të largëta mbi 100 kilometra siç është Vevçani dhe Mavrova, por mungojnë për Xhaminë e Pashës dhe Kodrën e Diellit. Sipas informacioneve, është paraparë që në kuadër të Qendrës Informativ Turistik në Tetovë të punësohen dy persona të cilët në kohë reale do të mund të japin informacione për turistët që kanë vendosur të vizitojnë këto objekte, në ndërkohë apelojnë që edhe institucionet qendrore do të duhet që më shumë të kujdesen dhe të vendosin tabela të këtilla është jashtë territorit të komunës së Tetovës.

## Padi për tre persona që abuzuan seksualisht 14-vjeçarin

Shkup, 24 prill - Prokuroria Themelore Publike e Gostivarit parashtrori aktakuzë kundër tre personave që në mars dhe në korrik të vitit 2018 kanë përdhunuar një fëmijë, duke bërë kështu vepra penale për të cilat ekziston dënim me burg prej të paktën 12 vitesh. Prokurori kompetent publik nga PTHP-ja e Gostivarit së bashku me aktakuzën në Gjykatën Themelore të Gostivarit parashtrori propozim për vazhdimin e masës së arrestit për të akuzuarit.

Siç është cituar në njoftimin e Prokurorisë Publike, i akuzuari i parë ngarkohet me vepër penale Abuzim seksual ndaj një fëmije që nuk ka mbushur 14-vjeç. Ai në mars të vitit 2018 duke lëvizur me makinë e ka takuar fëmijën në rrugë dhe me forcë e ka futur në automjet. Më pas e ka çuar në një vend të vetmuar ku edhe ka kryer dhunë seksuale ndaj fëmijës-viktimës, të cilës pas kryerjes së veprës i ka dhënë kompensim financiar. I akuzuari i dytë në korrik

të vitit 2018 i ofroi para fëmijës-viktimë, duke e çuar në shtëpinë e tij ku edhe ka bërë abuzimin seksual. Gjatë muajve të ardhshëm i akuzuari i dytë i ka ofruar para fëmijës që të realizojë kontakte me të përmes rrjeteve sociale më qëllim realizimin e marrëdhënies seksuale me persona të tjerë, ndërsa për këtë ka kërkuar që fëmija të kërkojë para dhe ta njoftojë atë. Për shkak të asaj që ka bërë, i dyshuari i dytë përveç Abuzimit seksual me fëmijë që nuk

ka mbushur 14 vjeç, ngarkohet edhe për vepër penale Ndërmjetësim në kryerjen e prostitucionit.

I akuzuari i tretë, i cili ndiqet për vazhdimësinë e kryerjes së veprës penale, ka abuzuar seksualisht disa herë me fëmijën-viktimë. Në aktakuzë ky person ngarkohet për vepër të kryer penale në vazhdimësi Abuzim seksual ndaj një fëmije që nuk ka mbushur 14-vjeç, shtohet në njoftimin e Prokurorisë Publike. (U.H)

## KRONIKË

### Minoreni përdhunon minorenen

Një minorene nga Kavadari është përdhunuar nga i afërmi i saj gjithashtu minorenen, informacion ky i konfirmuar nga Verolub Dodevski, zëdhënës i SPB Veles. "Më datën 22 të këtij muaji në orën 21:00 në Stacionin e policisë në Kavadar personi O.K. ka denoncuar se vajza e tij minorene është përdhunuar nga një i afërm i tyre gjithashtu minorenen nga Kavadari", kumtoi Dodevski. Merren masa për zbardhjen e rastit.

### Policia i gjen marihuanë, arrestohet tetovari

Të martën në periudhën prej ora 11 e 30 minuta deri ora 12 e 20 minuta, pjesëtarët e Sektorit për punë të brendshme Tetovë, në rrugën "Radovan Conić" kanë kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirat ndihmëse të 33 vjeçarit B.L nga Tetova. Gjatë bastisjes, në disa hapësira të caktuara në vende të ndryshme, janë gjetur sasi të ndryshme të marihuanës. Personi B.L është arrestuar dhe është mbajtur në Stacionin policor Tetovë për procedurë të mëtejshme, ku ndaj tij do të pasojnë edhe parashtrora adekuate.

### Paditet 37-vjeçari, sulmon policinë

Të martën rreth orës 11 e 40 minuta, në bulevardin "Marshall Tito" përpara Tregut të gjelbër në Tetovë, 37-vjeçari A.E është sjellë në mënyrë agresive ndaj pjesëtarëve të policisë, të cilët kanë kryer detyrën. Pas dokumentimit të rastit, kundër tij do të pasojnë edhe parashtrora adekuate.

### Shkup, 11 aksidente me 9 të lënduar

Nëntë persona janë lënduar më lehtë në pesë nga gjithsej 11 aksidente të evidentuara në 24 orët e fundit në rajonin e SPB Shkup. Në gjashtë aksidente, është shkakuar dëm material, janë sanksionuar 31 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, janë përgjatur nga komunikacioni 24 persona para se të marrin të drejtën e lejes për vozitje, si dhe 13 automjete të parregjistruara. Janë shqiptuar 75 masa për parkim të parregullt, ndërsa karrotreci ka marrë 63 automjete. Katër shoferë kanë kaluar në dritë të kuqe të semaforit, 16 nuk kanë mbajtur rrip të sigurimit, 20 kanë folur në celular, shtatë janë rreshtuar keq. (U.H)



Kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova propozoi që për nënkryetar të KE-së të LSHPM-së të zgjidhet Mentor Qoku, ekspert i së drejtës, me përvojë të pasur si jurist, prokuror dhe avokat, i cili pas pensionimit, në mënyrë aktive është i përfshirë në organizimin e pensionistëve, si kryetar i SHP Çair.

Më 12 prill 2019 u mbajt seanca konstituive e Këshillit ekzekutiv të LSHPM-së në përbërje të re. Në seancë, në të cilën ishin prezentë të gjithë anëtarët, mori pjesë edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM-së, Mr. Ilija Adamoski. Me seancën udhëhoqi kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova. Në fillim të seancës, kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova i përshëndeti të pranishmit dhe në pika të shkurta i potencoi detyrat dhe qëllimet kryesore të anëtarëve të Këshillit ekzekutiv të LSHPM dhe tha se të jesh anëtar i Këshillit ekzekutiv është nderë dhe obligim. Këshilli ekzekutiv është organ operativ dhe ekzekutiv, i cili i përgatit seancat e Kuvendit, e përcakton programin, Statutin dhe dokumentet tjera financiare. Gjithashtu, KE është i obliguar t'i respekton vendimet dhe konkluzionet e sjella nga Kuvendi i LSHPM-së. Ajo bëri thirrje për bashkëpunim të mirë, i cili do të mbështetet në motivim, kreativitet dhe shqyrtim kritik ndaj punës,

## SEANCA KONSTITUIVE E KETË LSHPM-së TË JESH PJESË E UDHËHEQËSISË SË LSHPM-së ËSHTË NDERË DHE OBLIGIM



dhe rëndësi të veçantë do të ketë respektimi i mendimit të të tjerëve dhe mendimit personal.

Të pranishmëve iu drejtua kryetari i Kuvendit të LSHPM-së, Mr. Ilija Adamoski, i cili edhe një herë u falënderua për besimin e dhënë dhe premtoi që së bashku me kryetaren e LSHPM-së, Stanka Trajkova maksimalisht do të angazhohen që të gjitha problemet me interes të pensionistit, organeve dhe shoqatave të pensionistëve të zgjidhen në kufi të mundësive.

Kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova propozoi që për nënkryetar të KE-së të LSHPM-së të zgjidhet Mentor Qoku, ekspert i së drejtës, me përvojë të pasur si jurist, prokuror dhe avokat, i cili pas pensionimit, në mënyrë aktive është i përfshirë në organizimin e pensionistëve, si kryetar i SHP Çair. Pas propozimit të kandidaturës së

tij, Mentor Qoku njëzëri u zgjodh si nënkryetar i KE-së të LSHPM-së. Ai u falënderua për besimin e dhënë duke theksuar që për të paraqet nderë dhe obligim të madh dhe premtoi që funksionin do ta kryejë duke investuar me përvojën dhe njohurinë e tij.

Kryetarja e LSHPM-së, Stanka Trajkova së pari e shpjegoi rolin e funksionit të sekretarit të KE-së të LSHPM-së, ndërsa pastaj për sekretar në periudhën e mandatit 2019-2023 e propozoi Menka Temelkovskën, ekonomiste e diplomuar, me përvojë në sferën e aspektit juridik analitik dhe ekonomik. Propozimi njëzëri u miratua, me çka Temelkovska u falënderua.

Pastaj Trajkova i lexoi përmbajtjet e trupave dhe komisioneve të KE të LSHPM-së dhe tha se gjatë përbërjes së të njëjtave është marrë parasysh përfshirja sa më e madhe

e shoqatave, afinitetet dhe arsimiti i anëtarëve të propozuar, si dhe përkatësia gjinore dhe nacionale. U propozuan dhe miratuan komisionet dhe trupa të KE të LSHPM-së. Të gjitha komisionet dhe trupat u miratuan njëzëri.

Në seancë u mor vendimi që për përzgjedhës të Revysë së 9-të Republikane dhe Revysë së 17-të rajonale të këngës, muzikës dhe lojëra të jetë Tomçe Stojkov, regjisor me përvojë shumëvjeçare në RTM, i cili këtë funksion e ka realizuar me sukses disa vite më parë.

Të pranishmit u informuan që edhe këtë vit Revytë janë të mbështetura nga Ministria e kulturës, si projekt me interes nacional, duke u falënderuar angazhimit të kryetares Trajkova. Gjithashtu u përcaktuan terminet për Garat republikane dhe Garat e 24-ta rajonale të sportit. (K.S Andonova)



## Pllakë argjendi për Besnik Pocestën

Kuvendi i Lidhjes të shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë më 19 mars 2019 mbajti seancë me karakter raportues por edhe solemn. Të pranishmëve në seancë iu drejtua ish kryetari i Kuvendit të LSHPM-së, Besnik Pocesta duke i falënderuar të pranishmit për bashkëpunimin e shkëlqyer.

"Në vitet e kaluara, në të cilat unë isha kryetari i parë shqiptar i Kuvendit të LSHPM-së, me kënaqësi mund të theksoj që bashkëpunimi me juve ka qenë në nivel të lakmueshëm. Të gjitha qëllimet programuese dhe detyrat janë realizuar me sukses. Veçanërisht dua të theksoj bashkëjetesën tonë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Si projekte të mia dua t'i potencoj faqen e pensionistëve në gjuhën shqipe në "Penzioner plus" dhe shkrimet për pensionistët në gazetën "KOHA". Gjatë tërë kësaj periudhe si kryetar i Kuvendit të LSHPM-së, kam qenë i kyçur në të gjitha aktivitetet e Lidhjes, veçanërisht në vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me pensionistët nga Sllovenia, Serbia, Kroacia, Shqipëria, Bullgaria, dhe tani këtë vit me pensionistët e Kosovës, përderisa nga Konfederata e pensionistëve të Pogradecit - Republika e Shqipërisë, jam shpallur si anëtar nderi i asociacionit të tyre. Veçanërisht, krahas një numër të madh të falënderimeve të marra për aktivitetet e mija në LSHPM, më të preferuarën e kam Pllakën e dhuruar për aktivitete të theksuara si kryetar i Kuvendit, me rastin e 70 vjetorit e organizimit pensional në Maqedoni në vitin 2016. Kemi punuar të gjithë së bashku dhe prandaj kemi rezultate për respekt. Shpresoj që edhe më tej do të jetë ashtu dhe këtë e dëshiroj me sinqeritet dhe nga zemra. Më vjen keq që do të ndahem nga të gjithë ju, por mendoj që ishte mjaft. Koha është që të më zëvendësojë dikush tjetër, të cilit i uroj sukses në punë", është shprehur Pocesta. Në seancën e Kuvendit të LSHPM-së më 29 mars 2019 Besnik Pocestës kryetar i dikurshëm i Kuvendit të LSHPM-së i është dhënë pllakë argjendi për kontribut të veçantë në kryerjen e funksionit dhe për kontributin e tij në zhvillimin e organizimit pensional në Maqedoni. Pllakën ia dorëzoi ish kryetari i LSHPM-së Dragi Argirovski.

## SEANCA ZGJEDHORE E LIDHJES SË SHOQATAVE TË PENSIONISTËVE TË MAQEDONISË

## LSHPM, PAS 73 VITEVE TË EKZISTIMIT, ME KRYETAR GRUA



Më 29 mars 2019, Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë ka mbajtur seancën e saj zgjedhore. Pas zgjedhjes së kryesisë së punës së Seancës zgjedhore të Kuvendit të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, procesverbalist dhe dy verifikues, u miratua Rregullorja për punën e seancës dhe u zgjodhën anëtarët e Komisionit verifikues dhe kandidues. Për kryetar të ri të LSHPM-së dhe gjithashtu kryetar i Bordit Ekzekutiv të Lidhjes për periudhën prej 2019-2023, është zgjedhur Stanka Trajkova, sekretare e deritanishme e Bordit ekzekutiv të Lidhjes, aktiviste dhe eksperte e theksuar me njohuri të mëdha në problematikën e pensionistëve, jurist e diplomuar dhe bashkautore dhe autore e komentimeve të ligjit

për sigurim pensional dhe invalidor dhe pjesëmarrëse në reformat e pensionistëve. Trajkova është edhe bartëse dhe autore e më shumë projekteve në lidhje me pensionistët në LSHPM.

Pas zgjedhjes, Trajkova para të anëtarëve të Kuvendit të ri të përzgjedhur prezantoi Programin e saj dhe tha, "Të nderuar anëtarë, për arsye të rëndësishme të funksionit kryetar i Bordit ekzekutiv dhe Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, ndërsa njëkohësisht edhe kryetar i Lidhjes, konsideroj që para juve anëtarë të Lidhjes të parashtrij dhe prezantoj Programin për aktivitetet, të cilat do të jenë në fokusin e punës sime, si kryetar të Lidhjes, për periudhën e mandatit 2019-2023. Do të përkushtohem dhe në mënyrë aktive do të punoj që në pikëpamje historike, Lidhja si organizatë qytetare ekziston më

shumë se 73 vite dhe është një nga asociacionet qytetare më masive me një atribut statutor të organizimit joqeveritar, apartiak dhe multietnik të pensionistëve, i pavarur në organizimin dhe realizimin e qëllimeve, interesave dhe veprimtarive të shoqatave të pensionistëve në Maqedoni - anëtare të Lidhjes. Programi i aktiviteteve të cilat do të jenë në fokusin e punës sime si kryetar i Lidhjes, për periudhën e mandatit 2019-2023 do të përkushtohem dhe në mënyrë aktive, do të punoj në sigurimin e pagesës së rregullt të pensioneve, ndërtim të shtëpive të pleqve dhe pensionistëve, përmirësim të kushteve në sferën e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtje shëndetësore dhe furnizim me ilaçe, mbështetje të punës vullnetare dhe bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, riorganizim të fondit solidar dhe azhurnim të të dhëna-

ve të mara nga FSPIM, përkrahje dhe ndihmë në aktivitetet tradicionale me aktivitet të përforcuar të veprimtarive humanitare, përkrahje të shoqatave më të vogla, bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe organizata tjera qytetare dhe përmirësim të bashkëpunimit të ndërsjellë".

Pas fjalimit të saj, përmes duartrokitjeve nga delegatët prezentë dhe anëtarët e Kuvendit të ri të zgjedhur, Stanka Trajkova u zgjodh kryetare e LSHPM-së dhe njëkohësisht kryetare e Bordit ekzekutiv të Lidhjes. Në seancë u potencua që për herë të parë pas 73 viteve nga themelimi i LSHPM-së për kryetar është zgjedhur një grua.

Pastaj u zgjodhën anëtarët e Bordit ekzekutiv, anëtarët e Bordit mbikëqyrës dhe anëtarët e Komisionit Statutor. Anëtarët e propozuar u zgjodhën njëzëri pa asnjë votë kundër apo të përmbajtur.

# Erdhi jeta në Maqedoninë e Veriut

Nga  
Lume HYSEINI



Mos vritni maqedonas! Vritni vetëm shqiptarë, sa më të vegjël të janë aq më pak dënim do të merrni! Mos vritni maqedonas, do dënoheni me 19 burg dhe mbi 100 000 euro dëmshpërblim. Vritni në mënyrën më mizore fëmijë shqiptarë. Mjafton që të keni emra dhe mbiemra maqedon ose serb si Boban Iliçi dhe babai juaj të jetë anëtar i LSDM-së!

Po të kenë mend vrasësit potencial maqedonas dhe ata shqiptarë në të ardhmen do të vrasin vetëm shqiptarë sepse dënimi është i vogël dhe kushton badihava e jo mbi 100 000 euro. Ky mesazh u ripërsërit nga gjykatësja Aleksovska-Stojanovska në seancën e fundit gjyqësore, të gjykuarit Bela dhe Demiri kishin ratur për vdekje tash të ndjerin Nikolla Sazdovski dhe u dënua për veprën penale, vrasje në kushte mizore sipas nenit 123 të Kodit Penal.

Kodi penal parasheh dënim të ndryshme për vepra të ndryshme penale. I ndjeri ishte i ratur dhe si pasojë e lëndimeve ndërroi jetë. Kodi Penal parasheh dënim për veprën penale ushtrim dhune me ç'rast pason vdekja mirëpo gjykata e kualifikoi veprën penale si vrasje në kushte mizore dhe shqiptoi dënimin maksimal. Në anën tjetër, vrasja mizore e Almiri 4 vjeçar nga Kumanova nga ana e vrasësit që mban emrin Boban Iliq, vrasje e paskrupullt të cilën ata që kanë zemër mundën ta ndjekin edhe në youtube nga ana e gjykatës themelore në Kumanovë u kualifikua si vrasje me paramendim ndërsa pas referimit të lëndës në Prokurorinë Republikane, akuza u rikualifikua si "aksident komunikacioni me pasojë vdekje" dhe si pasojë shtaza Boban Iliq djali i anëtarit të LSDM-së, u dënua me 6 vite burg dhe natyrisht asnjë dëmshpërblim për dhembjen dhe humbjen e shkaktuar familjes së Almir Aliut.

Pas gjithë peripecive dhe luftës për mbijetesë për sa kohë që ekziston ky shtet, kush mund ta mohojë se nuk erdhi jeta në Maqedoninë e Veriut! Tani bile më shumë se kurrë, të gjithë ata maqedonas, turq, boshnjak e veçanërisht shqiptarë që votuan opSIONIN e "jetës për të gjithë"

në Maqedoni mund të gëzohen sepse me votën e tyre dënuan vrasësin serb të Almir Aliut, djalin e anëtarit të LSDM-së me 6 vite burg dhe vrasësit shqiptarë të Nikolla Sazdovskit, Besir Bela dhe Skender Demiri me nga 19 vite burg.

Tani parulla e mirënjohur "shqiptari mirë, shqiptar i vdekur" me ardhjen e "Jetës për të gjithë" përfundimisht është institucionalizuar, normuar dhe legalizuar. Ka mbetur vetëm të zgjidhet presidenti i shtetit dhe ky vend të integrohet në NATO dhe BE, koncepte këto që janë larg nivelit mendor dhe shpirtëror të fukarave kronik që udhëheqin masat pakurizore që pas dy javësh do dalin ta votojnë konceptin "Së bashku përpara" apo "Drejtësinë për Maqedoninë". Integrimi i shtetit në BE është prioritet, thonë ata por ama mundësitë reale të integritit të këtij shteti specifik në BE do ishin sa mundësitë që ka një njeri i pastrehë, i leckosur që qelb erë të hyjë në një VIP klub nate!

Realisht, ky shtet as që është i përbashkët, as që mund të shkojë përpara e as që është i drejtë. Dhe

për hir të së vërtetës as nuk mund të llogaritet si shtet sepse ka organizim fisnor, institucione të brishta dhe inivid të fuqishëm që imponojnë interesin e tyre personal dhe fisnor dhe e bëjnë këtë vend të jetueshëm vetëm për llojin e tyre primitiv dhe pakurizor. Ky është një organizim hibrid ku udhëheqësit shtiren se udhëheqin teksa veshin këpuca të shtrenjta dhe kënaqen në privilegjet që ua jep pushteti ndërsa masa e gjerë shtiret se pason teksa ec këmbëzbathur dhe funksionon tamam si një hordhi që flet gjuhë të ndryshme! Një hordhi e pabarabartë në sallën e gjykatës ku jeta e një maqedonasi vlen trefish më tepër se jeta e një shqiptari por e barabartë në varfëri, mungesë të perspektivës, sistem arsimor që ka efektin e kursit kundër analfabetizmit, shëndetësi katastrofale, mjedis të pistë jetësor, infrastrukturë të vjetër e të shëmtuar, mungesë të kushteve bazike për zhvillim normal psiko-social dhe zgjedhje, shumë zgjedhje parla-

**Një hordhi e pabarabartë në sallën e gjykatës ku jeta e një maqedonasi vlen trefish më tepër se jeta e një shqiptari por e barabartë në varfëri, mungesë të perspektivës, sistem arsimor që ka efektin e kursit kundër analfabetizmit, shëndetësi katastrofale, mjedis të pistë jetësor, infrastrukturë të vjetër e të shëmtuar, mungesë të kushteve bazike për zhvillim normal psiko-social dhe zgjedhje, shumë zgjedhje parlamentare, lokale dhe presidenciale**



mentare, lokale dhe presidenciale ku qoftë edhe për një muaj masat këmbëzbathura ndjehen të çmuar dhe të respektuar nga ata anëtarë nga mesi i tyre që patën fatin të bëhen udhëheqës dhe të pasurohen shumë në kuriz të hordhisë së tyre të varfër.

Tash dilni e votoni në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale se ka ardhur jeta për të gjithë! Të gjithë jeni të barabartë në mizerien që ua servojnë partitë të cilat rregullisht i votoni veç kujdes, nëse jeni shqiptarë, mos i vritni maqedonasit sepse do të dënoheni shumë. Nëse jeni maqedonas vritni rahat shqiptarët sepse i tërë sistemi gjyqësor do të vihet në shërbimin tuaj që të ju dënojë shumë pak sa mos të jetë hiç! Dhe ju që votoni fukaratë kronik nga mesi juaj me cilën do shpresë patetike që keni, nëse jeni shqiptarë, ruani fëmijët tuaj! Mund ti humbni lehtë sepse jeta e tyre vlen shumë pak ndërsa shkencërisht është e përdëftuar që edhe njeriu pa pikë dinjiteti dhe pikë logjike të shëndoshë ndjen dhembje të madhe për humbjen e fëmijës së vetë!

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Sloboden Pecal" - rr. Kej 13 Noemvri nr.31-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë, 24 prill 2019 | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribucion: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# Mao Ce Duni ende ka ndikim në Kinë dhe mbarë botën

The ECONOMIST

Mijëra njerëz, qëndrojnë çdo ditë në radhë për të parë trupin e tij të balsamosur në një sarkofag prej xhami. Kur Barack Obama ishte president, një biznesmen në Kinë prodhoi një imazh që përzie veshjen e despotit me fytyrën e amerikanit, dhe e stampoi atë në bluza. Shumë njerëz - duke përfshirë edhe turistët perëndimorë - i blenë ato. Edhe nëse mund të mos e kenë vënë re, se me atë gjest ata ishin duke e barazuar udhëheqësin e Amerikës, me një figurë që shkaktoi dhjetëra miliona të vdekur.

Mao Ce Dun, ka qenë gjithmonë kështu: një despot, imazhi global i të cilit u formua dhe u përshtat, pa marrë parasysh njeriun që ai ishte. Ai nuk mbajti asnjë përgjegjësi për tmerret që shkaktoi - vrasjet e pronarëve të tokave, persekutimet e intelektualëve, dhe urinë masive që përfshiu vendin në fillim të viteve 1960. Libri i tij i Vogël i Kuq, u lexua me padurim nga studentët rebelë në kampuset perëndimore, po ashtu edhe në botën në zhvillim. Nuk ishte aspak e turpshme, po të visheshe me një kostum si të Maos. Ndërsa Xhulia Lovell nga Birkbek, Universiteti i Londrës, përshkruan në librin e saj "Maoizmi: Një histori globale", kryetarin abstrakt që frymëzoi revolucionarët në mbarë botën, nga malësitë e Perusë, në xhunglat e Kamboxhias, nga kafenet e Parisit në SHBA-në e mesperëndimit. Ideologjia e Maos, e "distiluar" në disa epigrama të ngurta ("të rebelohesh, është e justifikueshme!", "t'i shërbejmë popullit!" dhe "të bombardojmë se-



**Emrat e diktatorëve më të përgjakshëm të shekullit XX-të, janë sinonim i së keqes. Hitleri, Pol Poti, Stalini: madje të qeshësh me ta, është një shaka pa kripë. E megjithatë, emri i një tirani vazhdon të ketë një ndikim sado modest. Në fakt, shumë njerëz e fyejnë. Fytyra e tij, gjendet në pothuajse çdo kartëmonedhë në qarkullim në ekonominë e dytë më të madhe në botë**

litë!", që janë gjithçka që ju duhet të dini), ndihmoi në nxitjen e vuajtjeve dhe trazirave jo vetëm në vendin e tij, por edhe anembanë botës.

Ai ishte mendja pas Pol Potit, dhe fushave të tij vrastare në Kamboxhia. Ishte kulti i tij i personalitetit, ai që inkurajoi një ziliqar si Kim Il Sung që ta shtynte veten në lartësi të ngjashme të absurditetit; me Korean-veriorët që mbeten edhe sot të tmerruar prej tij. Kulti i Maos, nuk përfundoi me anarkinë e Revolucionit Kulturor në vitet 1960-1970. Ai ka gëzuar një jetë të përhershme, që nuk ka marrë vëmendjen që meriton. Siç pohon Lovell, paaftësia e studimit të ndikimit global të Maoizmit, nuk është vetëm rezultat i pavëmendjes. "Ajo është gjithashtu pasojë e suksesit të post-maoist të

Kinës, në komunikimin e një narrative të veçantë të së kaluarës së tij" - shkruan ajo.

Imazhi i Maos, vazhdon të manipulohet. Ai ka ende një joshje të fuqishme në Kinë dhe gjetkë. Origjina e legjendës së tij, i detyrohet shumë një amerikani. Zonja Lovell zbulon rolin befasues që ka luajtur Edgar Snou në krijimin e mitit të Maos, më shumë se një dekadë para se ai të merrte pushtetin në vitin 1949. Snou ishte një gazetar, që arriti të depërtojë në zonën e largët veri-perëndimore të Kinës, ku përfunduan Mao dhe pasuesit e tij pas Marshimit të Gjatë, për t'i shpëtuar forcave të Çang Kai Shisë. Libri që ai shkroi mbi bazat guerile dhe takimet e tij me Maon, "Ylli i kuq mbi Kinën", i botuar në vitin 1937, u bë një best-seller ndërkombëtar.

Asnjë gazetar tjetër, nuk kishite pasur një qasje të tillë. Përshkrimi i Maos nga Snou, asokohe në fillim të të 40-ave, si një idealist që donte të shpëtonte Kinën nga autokracia e korruptuar e Çang Kai Shisë, dhe të ndërtonte një vend demokratik, e magjepsi botën. Siç shprehej Snou, qëllimi i Maos ishte të ndërgjegjësojë kinezët "për të pasur besim tek të drejtat e njeriut", dhe t'i bindte ata "të luftojnë për një jetë të drejtësisë, barazisë, lirisë dhe dinjitetit njerëzor". E çfarë mund të ishte e pakëndshme tek kjo? Libri i Snou, thotë zonja Lovell, "e përshkroi Maon si një personalitet politik kombëtar dhe global, përpara se në Partinë Komuniste Kineze të lindte Maoizmi". Përkthim kinez i librit, i joshi kinezët e mirëarsimuar të qyteteve të shkonin pas Maos. Jashtë vendit, ai u shndërrua në një dora-

cak për partizanët anti-nazistë në Rusi, për guerilët Huk në Filipine, dhe për revolucionarët anti-britanikë në Indi. Ai libër ishte, thotë Lovell, një "tekst thelbësor" për mijëra indianë, të cilët u bashkuan me një kryengritje maoiste, që ende vlon atje. Përshkrimet e Lovell për këto (dhe të tjera) fillesa globale të maoizmit, janë të mirëhulumtuara. Ajo e përfundon librin e saj, duke shqyrtuar jetën në Kinë pas vdekjes së Maos. Aty është më e dukshme, rëndësia e besimit. Pas shumë vitesh, gjatë të cilave Mao është bërë gjithnjë e më shumë i marginalizuar në kulturën politike kineze, udhëheqësi aktual i Kinës, Xi Jinping, po përpigjet të rivendosë autoritetin e kryetarit të ndjerë. Ai ka urdhëruar anëtarët e partisë që të pastrojnë ideologjinë maoiste.

Sukseset e Kinës, gjatë epokës së fundit të "reformimit dhe hapjes", nuk duhet të përdoren për të hedhur poshtë aspiratat e dikurshme nën Mao, këmbëngul ai. Në këtë mënyrë Xi është bërë një personazhet më të dashura të mbështetësve të mendimeve të Maos në Kinë, të cilët druhen prej kohësh nga lëvizja e partisë drejt kapitalizmit të tregut të lirë. Ata e admirojnë simpatinë e tij, për një lloj ekonomie më të udhëhequr nga shteti. Kjo bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, nëse kihet parasysh politika e jashtme e zoti Xi. Libri i zonjës Lovell, ofron një kujtesë të vlefshme se nën Maon, Kina donte të ishte lidere e një revolucioni global. Udhëheqësit e mëvonshëm kinezë, u përpoqën ta minimizojnë këtë aspekt të maoizmit, të frikësuar ndoshta se mos ushqenin dyshimet perëndi-

more ndaj komunizmit kinez. Mëgjithatë, Xi e ka bërë të qartë se ai dëshiron ta bëjë Kinën një lojtare qendrore në skenën botërore. Ai thotë se socializmi i stilit kinez, ka "hapur një shteg të ri" për vendet e tjera. Këto janë fjalë, që i bëjnë jehonë të kaluarës.

Për të gjithë këto arsye, analogjia është e vështirë të qëndrojë më këmbë. Xi nuk është në një mision revolucionar. Ai dëshiron të sigurojë një hapësirë globale të sigurt për komunizmin kinez, por jo ta konvertojë gjithë botën në të. Ai nuk është mbështetës i kryengritjeve. Ai është i lumtur të krijojë marrëdhënie miqësore me fuqitë jo komuniste, në rast se ato nuk sfidojnë të drejtën e tij për të sunduar. Në shtëpi zoti Xi e përdor maoizmin, si një mënyrë për të imponuar disiplinën partiake: duke përdorur fjalët e kryetarit për të dëshmuar besnikërinë ndaj partisë. Xi nuk do që anëtarët e parties, të mos ta marrin shumë fjalë për fjalë ideologjinë maoiste.

Tek e fundit, siç thotë zonja Lovell, Mao "zotëronte një gjenialitet" për teoritë që justifikonin mospërputhjen dhe kontradiktat. Kur "ka kaos të madh nën Qiell, situata është e shkëlqyer", thoshte ai. Xi nuk dëshiron një anarki në stilin e Gardistëve të Kuq që shkaktoi Mao, pasi druhet se partia nuk do t'i mbijetonte dot. Në shumë aspekte, ai është e kundërta e Maos. Ai dëshiron me çdo kusht stabilitet. Megjithatë, siç thotë në librin e saj zonja Lovell: "Si një virus që qëndron zakonisht në gjumë, maoizmi ka dëshmuar një talent të fortë dhe global, për të vepruar në fshehtësi".

## Rama ka të drejtë, zgjedhjet nuk duhet të shtyhen



Nga  
Andi BUSHATI

Edi Rama dhe zëdhënësi i tij më i zellshëm diplomatik, shefi i OSBE-së, kanë folur sot lidhur me mundësinë e ndryshimit të datës së zgjedhjeve. Kryeministri ka qenë i prerë, shtyrje nuk do të ketë. Ndërsa Bernd Broshard ka pyetur me ironi reporterët që i kanë zgjatur mikrofonin: "E ç'të mirë do të sillte shtyrja?"

Në fakt edhe pohimi i Ramës edhe ai i diplomatit, jetëgjatësia e të cilit varet nga projektet që i mi-

raton qeveria, kanë diçka racionale. Sepse 30 qershori si një datë tashmë e dekretuar nga Presidenti do të kishte kuptim të ndryshohej vetëm me kushtin e pjesëmarrjes së opozitës në garën lokale. Po a ka sot opozita mundësi të përfshihet në këtë garë, pasi ka djegur mandatet me arsyetimin se nuk zhvillohen dot zgjedhje të ndershme, të lira dhe të barabarta me këtë kryeministër. Një veprim i tillë do të ishte një kamikazeri politike e pa imagjinueshme.

Sepse, zgjedhjet në këtë vend nuk mund ti shpëtojë, as ndonjë lëmoshë e minutave të fundit, as ndonjë garanci ndërkombëtare, apo premtimi se Gjushi në Durrës apo Lala në Elbasan u hoqën qafe, e aq më pak ndonjë kompromis për 'lëshimin' e ndonjë qyteti të madh. Nëse me largimin përfundimtar nga parlamenti, opozita pati si qëllim ta nxjerrë lakuriq regjimin Ramës, nëse ajo u vetë-sakrifikua për të shërbyer si pasqyrë, ku njerëzit të shohin se të

gjitha pushtetet e i ka në dorë një njeri i vetëm, ajo duhet ti shkojë në eksterm kësaj rruge. Pra ti braktisë edhe zgjedhjet lokale. Ta lërë të shpërfaqet deri në fund parodia e një pushteti që do të garojë me vetveten, që do të bëjë sikur ndeshet me paloçot që ka krijuar vetë, e që do kthejë në lolo vëzhguesit ndërkombëtarë që do të sillen sikur monitorojnë në garë të rregullt.

Pra, në këtë kuptim ajo që opozitës i duhet më pak, është një

shtyrje e datës së zgjedhjeve. Prandaj dhe Rama ka të drejtë kur deklaron me vendosmëri se 30 qershori nuk preket. Ai nuk mund të falë një gjë që, as nuk ja ka kërkuar kush, as nuk i duhet kujt. Por edhe mbështetësi i tij Broshard nuk e ka gabim kur ngre dilemën se ç'do përfitohej nga zhvendosja e 30 qershorit. Këtu të gjitha palët bien dakord: E pse u dashkan bërë zgjedhjet detyrimisht me opozitën?

(lapsi.al)

# NIKKA

## NDONJËHERË ËSHTË MIRË TË KTHESH KOKËN PRAPA

Ka publikuar deri më tani shumë videoprojekte dhe ka zënë tashmë vend të rëndësishëm në skenën shqiptare. Nikka rikthehet këto ditë me një tjetër videoprojekt, detajet e të cilit i zbulon edhe në intervistën për InfraRed të gazetës KOHA. Ndonjëse e re ajo vazhdon të punojë fuqishëm për të sjellë para publikut gjëra të bukura

Koha Bisedoi: Blerand REXHEPI

**KOHA: Nikka me një klip të ri? bëhet fjalë për një klip të gëzueshëm apo të trishtuar?**

Po këtë javë do lancohet projekti më i ri ku përzgjedhja e temës së këngës është për dashurinë, me një klip të trishtuar sipas temës së këngës.

**KOHA: Me çfarë imazhi prezantoheni në këtë videoklip?**

Hmm, një femër e zhgënjyer nga dashuria dhe që nuk e pranon rikthimin e asaj dashurie, qëndron e fortë pa dashuri (rol, imazhi që kam interpretuar në klip).

**KOHA: Klipi i paraprind albumit që ju përgatiteni të hidhni në treg në muajt në vazhdim?**

Nuk është kjo njëra ndër planet e mia për album ende...

**KOHA: Besoni tek festivalet që organizohen dhe çmimet që jepen në to?**

Të tregohem e sinqertë jo edhe aq shumë.

**KOHA: Mendoj se këngët tuaja kanë tekste të bukura. Është i rëndësishëm për ju teksti?**

Botëkuptimi dhe thelbi i këngës është teksti, patjetër që është i rëndësishëm.

**KOHA: Është e nevojshme që një këngëtarë të provokojë në skenë, apo s'mund të kuptohet një këngëtarë i pëlqyeshme sot pa provokimet skenike?**

Nuk është e nevojshme gjithsesi që një këngëtare të provokojë në skenë, publiku shohin më thellë, mjafton këngëtarja të shpalojë te publiku mirësinë e brendshme të personalitetit dhe karakterit, ata kanë dëshirë të shohin publikun dhe patjetër artin të cilin e krijon.

**KOHA: Si e organizon Nikka një ditë, një javë, një muaj, një vit, përveç këngës a keni angazhime të tjera?**

Jam më shumë një person spontan, nuk i dua edhe aq shumë gjërat e planifikuara dhe mund të them që tani jam totalisht e përkushtuar vetëm te muzika që krijoj për publikun tim.

**KOHA: Imazhi juaj skenik adhurohet nga publiku, ju pëlqen kjo gjë?**

E si mund të them jo, patjetër që po sepse shoh rezultatet e mira të punës dhe për mua shumë vlerë ka publiku, sepse muzikën e bëj për ta.

**KOHA: E shikoni karrierën si një mundësi të mirë për të qenë e lumtur?**

Muzika dhe karriera është vet lumturia e jetës sime falë Zotit!

**KOHA: Apo mendoni se karriera ndonjëherë të bën të ndieshëm e vetmuar?**

Për të arritur ndonjë gjë të madhe kërkon sakrificë por që vetminë nuk e ndiej asnjëherë sepse së pari në shoqërim e kam gjithmonë muzikën dhe prej muzikës kam fansat e mi dhe publikun që e ndjejnë praninë e tyre të kohës me komente dhe mesazhe, jam shumë falënderuese.



**KOHA: Ju ka lindur ndonjëherë dëshira t'i ikni realitetit?**

Ka pasur raste.

**KOHA: Besoni tek dashuria me fund të lumtur?**

Patjetër që po!

**KOHA: Po tek fundi i një dashurie pasionante?**

(Qesh), këtu nuk ia kam idenë fare ende...

**KOHA: Tek kalimi i një dashurie në miqësi?**

Ndoshta po! Paqja është mbi të gjitha në këtë jetë.

**KOHA: A keni ndonjë ide të qartë për martesën?**

Ka kohe të mendoj idetë e martesës nuk jam as afër në këtë ide.

**KOHA: Jeni tipi i femrës që shikoni vetëm përpara apo ktheni shpesh kokën mbrapa?**

Ndonjëherë është mirë të kthesh kokën prapa për të parë se sa kanë ndryshuar gjërat ose sa ke arritur si person...



# PETRO XHORI

## KËTË HERË "PËR TY" ËSHTË DEDIKIM...!

Baladat e Petro Xhorit tashmë janë bërë himne për zemrat e dashuruara dhe mezi presin që ai të sjellë diçka të re po aq ose më të bukur se e para. "Për ty" është një baladë shumë e bukur që Petro Xhori ka vetëm pak ditë që e ka publikuar por që është pëlqyer kaq shumë nga të gjithë. Me Petron kemi folur pak më shumë për muzikën, përditshmërinë dhe shumë e shumë të pathëna të tjera të gjitha këto në InfraRed të gazetës KOHA

**KOHA: Petro, vetëm pak ditë ka që është publikuar "Për ty" dhe duket që është pritur mjaft mirë, kanë vërshuar videot, komentet, vlerësimet...!**

Jam i lumtur që njerëzit e pëlqejnë muzikën time dhe për këtë di të them vetëm "Faleminderit", faleminderit pa fund për mbështetjen dhe pritjen e ngrohtë që më jepni sa herë që sjell një këngë të re.

**KOHA: Pse ia vlen "Për ty"?**  
"Ndoshta këtë përgjigje nuk mund ta jap unë, por që mendoj se është muzikë shpirti prandaj ia vlen

**KOHA: A është kjo këngë një dedikim?**

Po është dedikim këtë herë, prandaj e ka dhe titullin e tillë.

**KOHA: Sa kohë kishe që merresh me realizimin e këngës? Kush tjetër ka meritë në suksesin e kësaj kënge dhe klipi?**

U bë gati një muaj që merremi muzika si gjithmonë Irlenc Hyka dhe Jojo, ndërsa video është realizuar nga Marin Mikeli!

**KOHA: Cila është kënga që kur shkon në koncertet publiku e kërkon përsëri e përsëri?**

Është kënga ime e parë "Prej teje" (Qesh) Tani që po e mendoj me titullin e paskam përsëritur pak veten!

**KOHA: Muzika, fama edhe paraja janë të lidhura ngushtë më njëra-tjetrën. Ti, pa cilën nga këto të treja do të mund të jetoje?**

Muzika ushqen shpirtin, paraja stomakun. A bëhet ti kem të dyja këto?(Qesh)

**KOHA: Më mirë të jetosh një ëndërr, apo një realitet të hidhur, ashtu si në këngë?**

Më mirë të jetosh një realitet, i hidhur ose jo mjafton që ta jetosh. Ëndrrat janë në momen-

tet që bëhet muzikë ose flihet gjumë. (Qesh)

**KOHA: Ndërkohë që të njohim si një djalë të talentuar në muzikë, ç'di të bësh tjetër?**

Aaah kjo pyetja më pëlqeu! S'e di por që besoj se do kisha qenë një kuzhinier shumë i zoti!(Buzëqesh)

**KOHA: Ka ndryshuar shoqëria për ty tani që je bërë i njohur? Mos më thuaj se tani e pi kafën vetëm në ambiente "in"..!**

Jam i njëjti Petro me të njëjtat rutina, e pi kafën pranë studios kështu që se di, nuk është se i kam këto probleme!

**KOHA: Femra ideale për ty duhet të jetë...**

Duhet të jetë 1.78 me flokë të zeza sterrë, sytë blu (Qesh) Shaka. Mjafton që të na bëjë zemra bam!

**KOHA: Cila është dëshira më e madhe që ke të parrealizuar?**

zuar?

Muzika është dëshira ime më e madhe dhe shqyr Zotit kjo gjë po pëlqehet kështu që mund të them se po e realizoj dalëngadalë!

**KOHA: Kur u zgjove këtë mëngjes, bërë telefonatën e parë me...**

Akoma s'e kam bërë asnjë telefonatë deri tani! (Qesh)

**KOHA: Mesazhi më i çuditshëm që ke marrë nga ndjekësit e tu...?**

Ishte një grua që më thoshte "të dashuroj" gjatë gjithë kohës e mesazheve që dërgonte, që s'e njihja fare por që shkruante shumë!

**KOHA: Më thuaj si do e mbyllim këtë intervistë..!**

E mbyllim me dashurinë për muzikën, dashuri për gjithçka, bëhemi njerëz më të mirë nëse duam dhe dhurojmë dashuri!



**BASHKË PËRPARA 3**

**STEVO PENDAROVSKI**  
për President



ПОЧИТУВАЈ, НЕ МРАЗИ!  
RESPEKTO, MOS URREI!  
SAYGI GÖSTER, NEFRET ETME!  
RESPECT, DON'T HATE!



**Klemens Koja**

Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup

Liria e fjalës buron nga ideja e të drejtave të barabarta për të gjithë. Megjithatë, ajo mund të keqpërdoret në situata kur grupe ose individë të caktuar shprehin ide rreth superioritetit të një race, feje apo kombi. Në këtë rast liria e shprehjes mund të shndërrohet në fenomenin e quajtur gjuha e urrejtjes. Ekzaminimi i simptomave dhe gjetja e mjeteve për parandalimin e gjuhës së urrejtjes kanë rëndësi thelbësore. Duke njohur rreziqet që paraqet urrejtja, ne në Misionin e OSBE-së në Shkup vazhdojmë të promovojmë dhe ndihmojmë në zhvillimin e instrumenteve efektive për të mundur një përgjigje më të fuqishme në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.



Kampanjата е иницирана и спроведена од АДХПМ | Fushata е inicuar dhe realizuar nga AMMSHM | The campaign is initiated and implemented by APNPM

СЛОВОДЕН ПЕЧАТ. Бечер ПОРТА 3 Капитал М Лажт ZAMAN БИРОС Бесрук  
Koha НЕЗАВИСЕН ДОКУМЕНТ ЗЕНИТ ШЕНЈА M ИСТОРИЈА Македонија

# EUROSTAT: IMPORTET E VESHJEVE NË BE NGA SHQIPËRIA U RRIËN ME 11%

BE importoi nga Shqipëria 215 milionë euro veshje në 2018-n, rreth 11% më shumë se një vit më parë. Pjesa më e madhe e tyre kishin si destinacion Italinë, ku vetëm në 2018-n importet e veshjeve nga Shqipëria zinin rreth 158 milionë euro, të cilat u rritën me 10% në raport me 2017-n, sipas të dhënave të publikuara nga EUROSTAT



Pas Italisë, e cila përgjigjet për 73% të totalit të eksporteve të veshjeve nga Shqipëria, renditet Gjermania për vlerën më të lartë të veshjeve të importuara me mbi 23 milionë euro. Në Greqi janë eksportuar 16.7 milionë euro, ndërsa në Rumani, 12 milionë euro. Edhe Çekia renditet në 5 vendet ku Shqipëria ka pasur eksportet më të larta me 1.2 milionë euro në total.

Eksportet e tekstileve drejt vendeve të BE-së kanë peshë në totalin e eksporteve shqiptare.

Vendet anëtare të BE-së importuan rroba me vlerë prej 166 mi-

liardë euro në 2018-n, dhe gjysma prej tyre vinin prej vendeve jo anëtare të BE-së (51% apo 84 miliardë euro). Krahasuar me vitin 2013, importet e veshjeve në vendet anëtare të Bashkimit Europian janë rritur me 25% në vlerë.

Ndërsa vendet anëtare eksportuan rreth 116 miliardë euro veshje, pjesa më e madhe e të cilave kishin destinacion vendet e tjera anëtare (77% apo 89 miliardë euro). Krahasuar me 2013-n, eksportet janë rritur me 36% në vlerën e totalit të eksporteve të vendeve anëtare.

## GJERMANIA, IMPORTUESJA MË E MADHE E VESHJEVE NË EUROPE

Në 2018-n, rreth 17 miliardë euro veshje u importuan drejt Gjermanisë nga vendet jo anëtare (20% në vlerën totale të veshjeve të importuara nga vendet jo anëtare të BE-së).

Kjo e bën Gjermaninë importuesen më të madhe të veshjeve nga vendet jo anëtare, e ndjekur nga Mbretëria e Bashkuar me 12 miliardë euro, Spanja me 12 miliardë euro, Franca me 10 mld, Holanda me 10 mld dhe Italia me 8 mld euro.

## KINA, VENDI KRYESOR I ORIGJINËS SË VESHJEVE

Importet e veshjeve nga vendet jo anëtare të BE-së vijnë kryesisht nga Kina, rreth 27 miliardë euro apo 32% e totalit të importeve nga vendet jo anëtare. Më pas renditet Bangladeshi me 16 miliardë euro, Turqia me 10 miliardë euro, e ndjekur nga India me 5 miliardë euro, Kamboxhia me 4 miliardë, Vietnami mbi 3 miliardë euro, Maroku dhe Pakistani me përkatësisht 3 miliardë. Importet nga Shqipëria në BE- zënë rreth 0.3% të totalit të importeve nga vendet jo anëtare të BE-së.



## Shtetasit e Kosovës morën rreth 3 miliardë euro kredi

Qytetarët e Kosovës po vazhdojnë të hyn në kredi në banka. Në Bankën Qendrore të Kosovës kanë treguar se kosovarët deri në muajin shkurt të këtij viti kanë marrë kredi rreth 3 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.4 për qind.

"Sektori bankar, si komponenti kryesor i sistemit financiar në vend, në vitet e fundit ka përshpejtuar rritjen e aktivitetit kreditues, duke dhënë kështu kontribut të shtuar në financimin e rritjes ekonomike në Kosovë. Krahas rritjes së aktivitetit kreditues, përmirësim të mëtejshëm shfaqën edhe treguesit e shëndetit financiar, gjë që flet për rritje të shëndetshme të këtij sektori. Kreditë e sektorit bankar, në muajin shkurt 2019, arritën shumën prej 2.77 miliardë eurosh, duke shënuar rritje vjetore prej 11.4%", kanë thënë në BQK për Monitor.al. Sipas BQK rritja e përshpejtuar e aktivitetit kreditues u shoqërua me zvogëlimin e normave të interesit në kredi, të cilat në muajin shkurt 2019 kishin një mesatare prej 6.8 për qind.

"Treguesit e shëndetit financiar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia shumë e mirë e portofolit kreditues me një normë të kredive joperformuese prej vetëm 2.6% në shkurt 2019, e cila shënoi rënie të mëtejshme në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar prej 3.1%."

Por, edhe me depozitat qytetarët e Kosovës nuk qëndrojnë keq. Në BQK kanë treguar se depozitat kanë arritur në 3.36 miliardë euro.

"Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë edhe depozitat, vlera e të cilave gjatë kësaj periudhe, arriti në 3.36 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.2 për qind".

Në të njëjtën kohë, sektori bankar gjatë vitit 2018 vazhdoi të karakterizohet me performancë të mirë financiare, duke mbajtur nivel të lartë të profitabilitetit. Vlera e fitimit neto në vitin 2018 ishte 87 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 1.9 për qind.

## Shqipëria do të krijoj Task Forcë për përforcimin e pozitës së Kosovës

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Gent Cakaj ka thënë se situatën në këtë ministri e ka marrë mes rezultateve të ish-ministrit Ditmir Bushati dhe planeve të tij për të lëvizur disa gjëra. Ai ka theksuar në 'Opinion' se Bushati praktikisht është dashur të fillojë nga situata kur politika e jashtme e Shqipërisë ka qenë amorfe dhe organizimi nuk ka qenë në nivel dhe se nuk e paragjykon atë.

"Nuk vije në pikëpyetje puna e Bushatit, unë e mora ministrinë në stad kur diplomacia ka qenë në kuotën më të lartë, e Bushati arriti suksesin më të madh në këtë ministri", tha Cakaj.

I pyetur pse Rama e zgjodhi në këtë post, ai thotë se nuk kam qenë pjesë aktive e politikës e partive atëkohë, por mori anën e partisë së Ramës sepse ka treguar shembullin si partia rigjenerohet.

"Unë si zvmnistër kam qenë përgjegjës për tri procese relevante në ministri dhe kjo gjatë kësaj periudhe kryeministri ka forcuar besimin se kam aftësitë e domosdoshme organizative sepse kam kryer një punë të rëndësishme për

Shqipërinë. Sa i përket moshës, e para moshë e re nuk është as disavantazh politik, Shqipëria ka pas kryeministra të një moshe pikërisht sa unë, presidenti i një vendi në rajon është të një moshe sa unë, kancelarja e Austrisë po ashtu.

Ekziston një prirje në Evropë për forcimin e prijësve të rinj, e në Shqipëri ka arsye të dyfishta për të ndodh një gjë e tillë. Shqipëria pas Kosovës është vendi më i ri në Ballkan, e vendet tjera kanë moshë më të madhe mesatare. Unë reflektoj mesataren e popullsisë së Shqipërisë e që është edhe qëllim i qeverisë Rama.

Është e pavërtetë që Rama më ka emëruar në këtë pozitë sepse bashkëjetoj me të bijën e dikujt të afërt të tij, e me ata që kanë publikuar këto gënjeshtër do të ballafaqohem në gjykatë.

Kjo është gënjeshtër sepse vjen nga armikët e armikut, sepse korrespondon me një iniciativë që e kemi marrë unë e Rama në ministri me të cilën jo çdokush mund t'punojë, si është lufta kundër nepotizmit", ka shtuar Cakaj, duke mohuar se është në lidhje dhe se



jeton me dikë.

Duke folur për presidentin e Shqipërisë, Cakaj ka thënë se shpreh konsideratë të plotë për të dhe se shembullin e fundit të bashkëpunimit të suksesshëm e kanë pasur sot me emërimin e ambasadorit të ri në Spanjë.

Ai tha se sa ishte zëvendësnistër e ka takuar shumë shpesh presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta, kurse nga janari që u emërua ushtrues detyre i ministrit, nuk e ka takuar më asnjëherë presidentin.

Cakaj dha edhe një lajm ekskluziv në këtë emision, duke thënë se Shqipëria do të krijoj një task forcë për forcimin e Kosovës.

"Komunikoj se MEPJ do të ngrej Task Force për forcimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës me diplomatet më të kualifikuar nga Kosova dhe Shqipëria. Shumë shpejt do të ketë ambasada për përdorim të përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës. Do të vazhdojë planifikimi për hapjen e konsullatave të përbashkëta. Do të ketë përfshirje të mundësive të këmbimit të stafit profesional në ministri dhe staf diplomatik. Do të ketë gjithashtu edhe një kalendar të përbashkët të artikulluar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

# PAS ZJARRIT NË NOTRE DAME, PRITEN STUHI NË PARIS

Pas zjarreve të "Ferrit" katedrales ikonike e Parisit "Notre Dame" tanimë rrezikohet nga reshjet e shiut. Kështu arkitektët francezë po punojnë për ruajtjen e saj nga dëmtimet e mundshme.

Masat po merren ndërkohë që meteorologët kanë parashikuar reshje intensive shiu dhe stuhi në Paris. Frika e arkitektëve qëndron në mundësinë që të ketë shembje të tjetra në strukturë, ndërkohë që tavanin e katedrales është i mbytur nga uji i përdorur për shuarjen e flakëve.

"E shikojmë me prioritet të lartë vendosjen në mënyrë emergjente të mbulesave kundër ujit. E rëndësishme është të kemi sukses në vendosjen e tyre për të



mbrojtur elementët më të dobët të godinës. Ka copëza drurësh që mund të bien, prandaj është një zonë shumë e rrezikshme", u shpreh Philippe Villeneuve, kryearkitekti i Notre Dame.

Ekzistojnë tashmë plane për të ngritur një tendë të madhe, të

ndërtuar qëllimisht në zonën e çatisë, që do të mbrojtë strukturën gjatë rindërtimit.

Parashikohet që reshje të dendura shiu të ketë ditën e enjte, ndërkohë që tenda nuk është ende gati. Tre vrima të mëdha në tavanin e katedrales janë shenjat

më të dukshme të dëmeve të pësuar, ku njëra u shkaktua nga reënia e majës.

Presidenti francez Emmanuel Macron është zotuar ta rindërtojë simbolin e Parisit brenda pesë vjetëve, për të qenë në kohë për Olimpiadën e vitit 2024.



## Kim Jong ka udhëtuar për Rusi me trenin e tij të blinduar

Lideri koreano-verior, Kim Jong-un ka mbërritur në Rusi mëngjesin e të mërkurës për takimin e tij të paralajmëruar me Presidentin Vladimir Putin, në qytetin port të Vladivostokut. Por ndryshe nga liderët e tjerë botërorë që zgjedhin avionin për të vizituar Rusinë, Kim Jong-un, ka zgjedhur të udhëtojë me trenin e tij të blinduar. Media koreano-veriore publikoi foto të Kimit që përshëndeste Rojat e Nderit dhe njerëzit me lule, në stacionin hekurudhor para se të ngjitej në trenin e tij të blinduar, ngjyrë kaki, për udhëtimin e gjatë, transmeton "Top Channel". Agjencia ruse e lajmeve Tas citonte një zyrtar lokal që thoshte se Kimit i ishin dhënë lule, bukë dhe kripë pasi kishte kaluar kufirin. Takimi me Putinin do të mbahet të enjten dhe do të fokusohet, sipas Kremlinit, tek programi bërthamor i Koresë së Veriut, me Rusinë që do të tentojë të konsolidojë trendet pozitive që vijnë nga takimet e mëparshme me Presidentin amerikan, Donald Trump.

## Arabia ekzekuton 37 terroristë, dy prej tyre lihen në publik

Arabia Saudite ekzekutoi 37 të burgosur të cilët kishin lidhje me grupe terroriste. Lajmi u bë i ditur nga Ministria e Brendshme ndërsa fillimisht për ekzekutimet është marrë miratimi i oborrit mbretëror.

Trupat e dy prej të ekzekutuarve qëndruan për disa orë në publik, veprim që tregon ashpërsinë dhe vendosmërinë me të cilin autoritetet kanë dashur ta trumbetojnë këtë vendim.

Qeveria e konsideroi këtë gjest si një

mënyrë për ti bërë të tjerët të kuptojnë çdo të thotë të lidhesh me akte terroriste dhe pasojat që mund të sjellin vepra të tilla.

Sipas autoriteteve, personat e ekzekutuar kanë përvetësuar ideologji ekstremiste si dhe kanë formuar celula terroriste me qëllim të përhapjes së kaosit dhe provokimin e përçarjeve midis sekteve.

"Këta individë janë gjetur fajtorë për sulme me eksplozivë ndaj forcave të sigurisë duke lënë të vranë një numër të pjesëtarëve si



dhe bashkëpunim me organizatat armike", thuhet në komunikatë.

Publicitet

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për rezerva të mallrave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.84/08, 77/09, 24/11, 43/14 dhe 83/18), nenet 46-49 të Ligjit për shfrytëzimin dhe disponimin me sendet në pronësi shtetërore dhe komunale ("Gazeta zyrtare e R.M." nr.78/15, 106/15 dhe 153/15), Vlerësimi CB V – 11/19 të datës 22.01.2019 dhe Vendimit për shitjen e sendeve të lëvizshme – grurë merkantil nr. 45-1107/1 të datës 25.02.2019, Komisioni për disponim me patundshmëritë dhe sendet e lëvizshme në Agjencinë për rezerva të mallrave publikon:

### SHPALLJE nr.2/19

#### për shitjen e sendeve të lëvizshme - grurë merkantil nga rezervat e mallrave me anë të ankandit publik elektronik

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Shitës i grurit është **AGJENCIA PËR REZERVA TË MALLRAVE** me seli në rrugën "Orce Nikolov" nr.71, 1000 Shkup

#### II. LËNDA E SHITJES

1. Bëhet shitja e:

- **7.164 ton GRURË MERKANTIL** nga rezervat e mallit

#### III. ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

1. Çmimi fillestar i GRURIT - lëndë e shitjes është 93.132,000,00 denarë, gjegjësisht **13,00 denarë për kilogram**, pa TVSH të llogaritur, që paraqet vlerën e parashikuar, me paritet franko silose në Prilep.

#### IV. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Lënda e shitjes është e pandashme.

2. Shitja do të bëhet me anë të ankandit publik elektronik përmes sistemit për ankand publik elektronik.

3. Internet faqja në të cilët do të bëhet ankandi publik:

<http://e-aukci.finance.gov.mk/>

4. Të drejtë në pjesëmarrje në ankandin publik elektronik kanë të gjithë subjektet fizik dhe juridik të huaj dhe vendas të cilët mund ta marrin të drejtën me pronësi të sendeve të tundshme dhe patundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.

5. Shitja do të bëhet sipas principit "e parë-e blerë". Reklamacione shtesë për kualitetin nuk pranohen.

Shqyrtim në vendin e ngjarjes mund të bëhet më datë 03.05.2019 (e premte) në silos e NP Agro berza në Prilep nga ora 10:00 deri 14:00.

6. Afati për parashtrim të fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik: 06.05.2019 (e hënë) deri në ora 14:00.

Fletëparaqitja për pjesëmarrje në ankandin publik parashtrrohet në mënyrë elektronike në internet faqen në vijim: e-aukci.finance.gov.mk dhe duhet të përmbajë:

• gjendja aktuale nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht dokument përkatës i dhënë nga organi kompetent nga vendi ku është regjistruar subjekti juridik, i cili

nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga dita e mbylljes së shpalljes (për persona juridik),

• kopje e letërnjoftimit valid ose dokument udhëtimi valid (për persona fizik),

• Garanci bankare për ofertë serioze me shume prej 2% nga çmimi fillestar i sendeve të lëvizshme, me vlefshmëri 60 ditë nga publikimi. Përveç në formë elektronike, e njëjta dorëzohet dhe në formë të shkruar (origjinal) deri te Komisioni për sende të palëvizshme dhe të lëvizshme të Agjencisë për rezerva të mallrave, adresa:Rr. "Orce Nikolov" nr.71, 1000 Shkup, më së voni deri në afatin e paraparë për dorëzim të fletëparaqitjeve për pjesëmarrje.

Në ankand publik elektronik nuk do të mund të merr pjesë personi (fizik apo juridik) me të cilën fletëparaqitje nuk janë dorëzuar dokumentacioni i kompletuar sipas pikës 6 të kësaj shpallje ose nuk ka dorëzuar garancinë bankare origjinale deri tek Komisioni për mjete të patundshme dhe të tundshme të Agjencisë për rezervë të mallrave deri në afatin e paraparë për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje.

7. Komisioni parashtruesve të cilët në sistem për ankand publik elektronik janë regjistruar me komplet dokumente të bashkangjitur, në afat prej 3 ditëve nga dita e parashtrimit të ofertave u dorëzon emër përdorues dhe fjalëkalim për pjesëmarrje në ankandin publik, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë parashtruar dokumentacion të kompletuar u dorëzon lajmërim me arsyetimin se nuk do të marrin pjesë në ankandin publik.

8. Mënyra dhe procedura për realizimin e ankandit publik:

- Ankandi publik realizohet në pajtim me dispozitat nga neni 25, neni 26, neni 48 dhe neni 49 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15)

- Që të mbahet ankandi publik, duhet së paku të ketë një pjesëmarrës.

- Si ofertues më i volitshëm në ankandin publik konsiderohet pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin e fundit, që paraqet çmimin më të lartë për shitje të mjetit të tundshëm.

- Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga pranimi i lajmërimit me shkrim për zgjedhje është i obliguar të paguajë mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar nga ankandi, ndërsa nëse nuk paguan mjetet në këtë afat nuk do të lidhet marrëveshje, garancia bankare do të aktivizohet dhe ofertuesi në periudhë prej një viti nuk do të mund të merr pjesë në çdo ankand tjetër të ardhshëm për mjetin e tundshëm në fjalë.

- Shfrytëzuesi i mjetit të tundshëm me blerësin më të volitshëm do të lidhë marrëveshje për shitblerje në afat prej 15 ditëve të punës pas pagesës së realizuar të çmimit të mjetit të tundshëm.

- Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

-Pjesëmarrësit në ankandin publik kanë të drejtë për ankesë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik. Ankesa parashtrrohet deri tek Komisioni në afat prej 3 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik. Komisioni vendosë në lidhje me ankesën me vendim në afat prej 5 ditëve nga pranimi i ankesës. Kundër vendimit të Komisionit mund të parashtrrohet ankesë deri tek Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

9. Informacionet në lidhje me shitjen, blerësin e interesuar mund t'i marrin në numrin e telefonit: 02/3116-249. Personi për kontakt: Zoran Donçev.

24.04.2019

Shkup

KOMISIONI PËR MJETE TË TUNDSHME  
Zoran Donçev, Kryetar  
Liljana Grozdanoska, Anëtar  
Imer Rexhepi, Anëtar



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
YHËRPSHITET HA OTCIOCTOPHA EPPOCA  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## KONKURS

### PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN E EVROPËS JUGLINDORE PËR VITIN AKADEMIK 2019/2020

Në bazë të nenin 149 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 82/18), nenit 31, paragrafi 1, pika 11 dhe nenit 92 të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Universiteti i E.J.L, më 23.04.2019 shpall:

#### PËRMBAJTJA

I	CIKLI I PARË I STUDIMEVE AKADEMIKE (STUDIME DERIDIPLOMIKE).....	0
I.1	STUDIME TË RREGULLTA - trevjeçare dhe katërvjeçare.....	0
I.2	STUDIME ME KORRESPONDENCË - trevjeçare dhe katërvjeçare.....	0
I.2.1	SHËNIMI 1 (për pjesën I.1 dhe I.2).....	0
I.2.2	SHËNIMI 2 (skema e bursave për pjesën I.1).....	0
I.2.3	SHËNIMI 3 0	
II	CIKLI I DYTË I STUDIMEVE AKADEMIKE (STUDIME PASDIPLOMIKE).....	1
II.1	STUDIMET DUVJEÇARE - 120 ECTS (Modeli: 3+2).....	1
II.2	STUDIME NJËVJEÇARE - 60 ECTS (Modeli: 4+1).....	1
II.3	STUDIME PROFESIONALE TË CIKLI TË DYTË (njëvjeçare - 60 ECTS).....	1
II.3.1	SHËNIMI 1 (për pjesën II.1, II.2 dhe II.3).....	1
III	CIKLI I TRETË I STUDIMEVE AKADEMIKE (STUDIME TË DOKTORATËS).....	1
III.1	SHKOLLA E DOKTORATËS.....	1

Numri i studentëve që do të regjistrohen në studimet me korrespondencë (viti i parë) është 30% nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt të paraparë me konkurs në programet studimore në pjesën  
Studimet me korrespondencë sipas programit "në-linjë" janë studime të pavarura në përputhje me standardet e universitetit. Rregulli i studimeve është si vijon:

- në fillim të semestrit studentët kanë ligjëratë hyrëse me profesorët e lëndës përkatëse;
- përmes sistemit për menaxhim elektronik studentët do të marrin instruksione lidhur me mësimin, kriteret e notimit, materialet e nevojshme si dhe do të kenë mundësi pjesëmarrjeje në forume elektronike;

#### I.2.1 SHËNIMI 1 (PËR PJESEN I.1 DHE I.2)

- Në rast të paraqitjes së kandidatëve në numër më të madh se numri i paraparë në këtë konkurs dhe nëse vlerësohet se ata i plotësojnë kriteret dhe standardet e kërkuara për regjistrim në UEJL, atëherë Këshilli i Rektorit mund të vendosë që të pranohet më së shumti deri më 20% prej tyre nga numri i paraparë me konkurs.

• Në rast se paraqiten më pak se 20 kandidatë në programin e caktuar studimor, universiteti ka të drejtë të mos e fillojë mësimin për programin përkatës studimor, kurse kandidatëve të paraqitur t'ua ofrojë mundësinë të regjistrohen në ndonjë program tjetër studimor.

- Rregullat e studimit për të gjithë studentët janë shpallur në rregulloret përkatëse që janë në dispozicion në ueb faqen e universitetit: <https://www.seeu.edu.mk/sq/about/important-documents>

- Studentët që studiojnë në kampusin në Shkup, në bazë të kërkesave të programit një pjesë të ligjëratave mund t'i ndjekin në kampusin në Tetovë ose e kundërta.

#### I.2.2 SHËNIMI 2 (SKEMA E BURSAVE PËR PJESEN I.1)

UEJL ofron bursa meritore (MBS) në bazë të suksesit të arritur gjatë shkollimit të mesëm.

1. Për kandidatët me notë mesatare 5.0 gjatë shkollimit të mesëm (duke mos i përfshirë notat nga provimi i maturës), bursa mbulon 60% të shkollimit;

2. Për kandidatët me notë mesatare 4.5 - 4.99 gjatë shkollimit të mesëm (duke mos i përfshirë notat nga provimi i maturës), bursa mbulon 40% të shkollimit.

Kriteret për vazhdimin e bursave do të përfshihen në Letrën e akordimit të bursave, në bazë të njoftimit për bursa që do të shpallet në ueb faqen e universitetit.

Afati i aplikimit dhe regjistrimit vlen deri më 14. 09. 2019.

#### I.2.3 SHËNIMI 3

Universiteti në mënyrë të përshtatshme i mirëpret studentët e kualifikuar të cilët kanë aftësi të kufizuara ose nevoja të veçanta dhe synon t'i mbështesë ata në arrijten e potencialit të tyre akademik dhe mundësitë e punësimit.

#### KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIM

1. Në cilin e parë të studimeve akademike mund të regjistrohen kandidatët të cilët e kanë kaluar maturën shtetërore apo maturën ndërkombëtare apo të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm katërvjeçar sipas rregullave të cilat kanë pasur vlerë para vendosjes së maturës shtetërore dhe kandidatët, shtetas të huaj që kanë mbaruar arsimin e mesëm adekuat jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2. Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose arsimin gjegjës me të para vitit 2008, kanë të drejtë të regjistrohen vetëm në bazë të suksesit të shkollës së mesme.

3. Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose arsimin gjegjës me të jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë të drejtë të regjistrohen, vetëm në bazë të suksesit të shkollës së mesme. Ata janë të obliguar që gjatë vitit të parë akademik të nostrifikojnë diplomën në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Vlerësimi i suksesit nga shkolle e mesme dhe matura shtetërore bëhet me anë të pikëve dhe atë 80% nga sukcesi në katër vitet e shkollimit të mesëm dhe 20% nga matura shtetërore. Në bazë të këtyre pikëve do të bëhet rangimi i kandidatëve.

5. Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt apo me korrespondencë me financim të studimeve.

6. Përparësi gjatë pranimit të studentëve me korrespondencë do të kenë kandidatët që kanë status të të punësuarit dhe që kanë sukses me të mirë nga shkollimi i mesëm. Të punësuarit duhet ta dokumentojnë statusin e tyre.

7. Studentët që transferohen në mënyrë plotësuere duhet të sigurojnë transkriptin e notave të tyre nga institucioni i mëparshëm i arsimit të lartë.

8. Studentët e të gjitha programeve studimore pas përfundimit të studimeve trevjeçare (që marrin diplomën për përfundimin e ciklit të parë të studimeve me 180 ECTS), nëse dëshirojnë mund të vazhdojnë edhe studimin shtesë njëvjeçar, pas përfundimit të të cilit mund të marrin edhe diplomën për përfundimin e ciklit të parë të studimeve katërvjeçare me 240 ECTS.

9. Nëse numri i studentëve të regjistruar është nën 20, atëherë programi studimor do të organizohet në kampusin e UEJL-së në Tetovë ose në Shkup, mvarësisht se në cilin kampusin numri i studentëve të regjistruar do të jetë më i madh.

#### NJOHJA E GJUHËVE

1. Të gjithë kandidatët do t'i nënshtrohen testimit për njohuritë e tyre për shkallën e njohjes së gjuhës angleze. Ky testim nuk ka karakter eliminues, por nevojitet për ta përcaktuar nivelin e njohjes së gjuhës angleze, me qëllim për të siguruar përmirësimin e duhur të të njëjtës. Kandidatët do të njoftohen në kohë për datat e testimit.

2. Për programet me mësim në gjuhën angleze, kriteret minimale janë: Niveli B1 (përdorues i pavarur) në bazë të Kornizës evropiane për njohjen e gjuhëve (CEFR) të dëshmuar me certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose rezultat ekuivalent në testin institucional për njohje të gjuhës angleze nga Qendra e gjuhëve, UEJL. Kandidatët do të njoftohen në kohë për datat e testimit.

3. Nëse kandidati ka mbaruar arsimin e mesëm jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjuhë tjetër nga gjuha e studimit të programit studimor në të cilën aplikon dhe regjistrohet në program studimor me gjuhë studimi gjuhën shqipe apo gjuhën maqedonase duhet të dëshmojë me certifikatë njohjen e gjuhës përkatëse.

#### AFATET PËR PARAQITJE

Kandidatët e interesuar mund të paraqiten duke filluar nga data **6 maj 2019** deri në datën **14 shtator 2019**. Kandidatët që aplikojnë para provimit të maturës shtetërore e ruajnë të drejtën të studiojnë në programin në të cilin kanë aplikuar, duke pasur parasysh se programet studimore janë konkurrenca dhe nuk mund të regjistrohen më shumë studentë se numri i paraparë për regjistrim me konkurs. Këta kandidatë duhet t'i dorëzojnë dokumentet e shënuara në pikët: 1, 2, 3, 4 (vetëm dëftesat e tri viteve të kryera), 6 dhe 7. Regjistrimi i këtyre kandidatëve do të zyrtarizohet pas kompletimit të dokumentacionit.

#### PARAQITJA E KANDIDATËVE

Të drejtë paraqitjeje kanë të gjithë kandidatët që i përmbushin kushtet e parapara me konkurs. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e postshënuara, në Shërbimin studentor (në kampusin universitar në Tetovë ose në Shkup) ose nëpërmjet postës, në adresën vijuese:

**Tetovë:** Universiteti i Evropës Juglindore, Bul. Ilindenska, nr. 335, 1200 Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut  
**Shkup:** Universiteti i Evropës Juglindore, Rr. Arhiepiskop Angelarij, nr. 1, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut  
Për më shumë hollësi kontaktoni Zyrën për pranimit:

**Tetovë:** Tel: +389 44 356 188; +389 44 356 091; E-mail: [admissions@seeu.edu.mk](mailto:admissions@seeu.edu.mk)  
**Shkup:** Tel: +389 44 356 396; +389 44 356 397; E-mail: [admissions@seeu.edu.mk](mailto:admissions@seeu.edu.mk)

#### DOKUMENTET PËR PARAQITJE NË KONKURS DHE REGJISTRIM

Të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë në vitin akademik 2019/2020 duhet ta dorëzojnë dokumentacionin e postshënuar:

1. Formulari i plotësuar Online: <https://apply.seeu.edu.mk/>

2. Fletëpagesa në shumë prej 1500 MKD (25 Euro)

Hollësi për pagesën në denarë:

Pranuesi: UEJL

Emri i bankës: STOPANSKA BANKA  
Llogaria rrjedhëse: 200-0008775390-10

**Hollësi për pagesën në euro:**

Pranuesi: UEJL

Emri i bankës: STOPANSKA BANKA

Adresa e bankës: Bul. M. Tito bb, Tetovo 1200, Republika e Maqedonisë së Veriut

Llogaria rrjedhëse: 0009009090

IBAN: MK07200000900909026

SWIFT: STOBMK2X

3. Biografia e shkurtër/letër motivimi e cila do të përmbajë më së paku 500 fjalë. Në këtë ese duhet të përmenden arsyet pse studentit aplikon në Universitetin e E.J.L.

4. Dëftesat origjinale ose kopje të noterizura për të gjitha vitet e shkollës së mesme (nëse shkolle e mesme është e kryer sipas modelit 9+3, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dëftesën e klasës së 9-të).

5. Diploma origjinale ose kopje e noterizuar për mbarim të shkollës së mesme me rezultatet nga matura shtetërore, gjegjësisht matura shkollore ose provimin përfundimtar.

6. Certifikata e lindjes.

7. Fotokopje e letërjofimit ose e pasaportës.

**SHËNIM:** Kandidatët të cilët aplikojnë për transferim në UEJL përveç dokumenteve të lartshënuara duhet të dorëzojnë edhe certifikatë të notave nga institucioni i mëparshëm i arsimit të lartë.

#### II CIKLI I DYTË I STUDIMEVE AKADEMIKE (STUDIME PASDIPLOMIKE)

Studimet e ciklit të dytë (studimet pasdiplomike) për vitin akademik 2019/2020 do të realizohen në tre forma: dyvjeçare (sipas modelit 3+2, 120 ECTS), njëvjeçare (sipas modelit 4+1, 60 ECTS) dhe studime profesionale (njëvjeçare, 60 ECTS).

#### I CIKLI I PARË I STUDIMEVE AKADEMIKE (STUDIME DERIDIPLOMIKE)

##### I.1 STUDIME TË RREGULLTA - TREVJEÇARE DHE KATËRVJEÇARE

Numri i studentëve në studimet e rregullta në vitin akademik 2019/2020 është si vijon:

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	GJUHA				ÇMIMI I PLOTË/PËR SEMESTER 100%	ÇMIMI PËR BURSAVE/PËR SEMESTER ME NOTE MESATARE 5.0	ME NOTE MESATARE 4.5-4.99
		SOI	MKD	ENG	DEU			
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>								
Studime të drejtësisë	TE	40	20		650 €	260 €	390 €	
	SK	30	15		650 €	260 €	390 €	
Kriminalistikë dhe siguri	TE	20	15		650 €	260 €	390 €	
	SK	15	10		650 €	260 €	390 €	
<b>Studime të drejtësisë (1)</b>								
Drejtimi: Studime të drejtësisë	TE	20	15		650 €	260 €	390 €	
	SK	15	15		650 €	260 €	390 €	
Drejtimi: Kriminalistikë dhe siguri*	TE	30	20		650 €	260 €	390 €	
	SK	20			650 €	260 €	390 €	
Drejtimi: Informatikë juridike*	TE	20	15		650 €	260 €	390 €	
	SK	15	15		650 €	260 €	390 €	
<b>FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË</b>								
<b>Biznes dhe ekonomi</b>								
Drejtimi: Menaxhment dhe marketing	TE	80	15		900 €	360 €	540 €	
Drejtimi: Financa dhe kontabilitet	SK	60	15		900 €	360 €	540 €	
Drejtimi: Ekonomi								
<b>Biznes dhe ekonomi</b>								
Drejtimi: Financat dhe bankat (2)	TE/SK	20	15		900 €	360 €	540 €	
	TE/SK			20	1,000 €	400 €	600 €	
<b>Biznes dhe ekonomi</b>								
Drejtimi: Ndërmarrësia (3)*	TE			50	1,000 €	400 €	600 €	
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE</b>								
<b>Menaxhmenti publik dhe administrata</b>								
Drejtimi: Menaxhimi publik dhe politikat publike	TE	40			650 €	260 €	390 €	
Drejtimi: Menaxhimi i organizatave joqeveritare	SK	30	15	15	650 €	260 €	390 €	
<b>Shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare</b>								
Drejtimi: Shkencat politike	TE	20	10		650 €	260 €	390 €	
Drejtimi: Marrëdhëniet ndërkombëtare	SK	20			650 €	260 €	390 €	
Punë dhe politikë sociale (1)*	TE	20	10		650 €	260 €	390 €	
	SK	20			650 €	260 €	390 €	
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE</b>								
<b>Shkenca kompjuterike</b>								
Drejtimi: Shkenca kompjuterike	TE	75	20		900 €	360 €	540 €	
	SK	30			900 €	360 €	540 €	
	TE			20	1,000 €	400 €	600 €	
Drejtimi: Inxhinieria kompjuterike	TE	20			900 €	360 €	540 €	
Drejtimi: Informatikë biznesi	TE			20	1,000 €	400 €	600 €	
	SK			20	1,000 €	400 €	600 €	
<b>FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT</b>								
Gjuhë dhe letërsi angleze	TE			50	650 €	260 €	390 €	
	SK			20	650 €	260 €	390 €	
Gjuhë dhe letërsi gjermane	TE			30	650 €	260 €	390 €	
	SK			20	650 €	260 €	390 €	
Gjuhë, kulturë dhe letërsi shqipe	TE	15			650 €	260 €	390 €	
Komunikimi ndërkombëtar	TE	25			650 €	260 €	390 €	
	SK	20	20		650 €	260 €	390 €	

(1) Programet studimore janë vetëm katërvjeçare.

(2) Programi studimor "Financat dhe bankat" është dizajnuar në bazë të bashkëpunimit me Universitetin e Londrës (UoL) - London School of Economics (LSE).

(3) Përzgjedhja e kandidatëve që do të paraqiten në programin studimor "Ndërmarrësia" do të realizohet nga ana ND Group - kompani që do të ofrojë bursa për studentët.

(\*) Programi studimor është në proces (ri)akreditimi.

##### I.2 STUDIME ME KORRESPONDENCË - TREVJEÇARE DHE KATËRVJEÇARE

Numri i studentëve në studimet me korrespondencë në vitin akademik 2019/2020 është si vijon:

PROGRAMET STUDIMORE	VENDI	ÇMIMI PËR SEMESTER
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>		
Studime të drejtësisë	TE/SK	650 €
<b>FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË</b>		
Biznes dhe ekonomi	TE/SK	900 €
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE</b>		
<b>Menaxhmenti publik dhe administrata</b>		
Drejtimi: Menaxhimi publik dhe politikat publike	TE/SK	650 €
Drejtimi: Menaxhimi i organizatave joqeveritare	TE/SK	650 €
<b>Shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare</b>		
Drejtimi: Shkencat politike	TE/SK	650 €
Drejtimi: Marrëdhëniet ndërkombëtare	TE/SK	650 €
Punë dhe politikë sociale		
Punë dhe politikë sociale	TE/SK	650 €
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE</b>		
Shkenca kompjuterike	TE/SK	900 €
<b>FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT</b>		
Gjuhë dhe letërsi angleze	TE/SK	650 €
Komunikimi ndërkombëtar	TE/SK	650 €






Leximi i jep trurit tuaj një "stërvitje" të ndryshme nga shikimi i televizorit ose dëgjimi i radios.

Nëse jeni të zhytur në një libër shumë interesant, apo thjesht shfletoni një manual udhëzimi për makinën tuaj të kafesë, "pjesë të trurit që kanë evoluar për funksione të tjera – të tilla si shikimi, gjuha dhe të mësuarit asociativ – lidhen në një qark të caktuar nervor për leximin, gjë që është shumë sfiduese", tha për revistën Oprah, profesor Ken Pugh, president dhe drejtor i studimit të Haskins Labs. Ky zakon e nxit trurin tuaj të mendojë dhe të përqëndrohet.

Zhytja në një libër të mirë mund të heqë shumë vite nga mendja juaj, sipas një studimi të kohëve të fundit nga Qendra Mjekësore e Universitetit Rush, siç raportohet nga "Prevention". Të rriturit që kalojnë kohën e lirë me aktivitete krijuese ose intelektuale (si leximi) kishin një ritëm më të ngadaltë, prej 32 për qind, të rënies së aftësive njohëse në fundin e jetës, se sa ata që nuk e bënin. "Sjelljet e zgjuara e bëjnë trurin më efikas duke ndryshuar strukturën e tij për të vazhduar funksionimin e duhur,

# LIBRI SI "ILAÇ", LEXIMI E MBAN TRURIN TUAJ TË RI NË MOSHË



pavarësisht nga neuropatologjia e lidhura me moshën", tha Robert S. Uilson, profesor i neuropsikologjisë në Qendrën Mjekësore të Universitetit Rush. Një tjetër studim i kohëve të fundit zbuloi se të rriturit më të mëdhenj në moshë që lexojnë ose luajnë rregullisht lojëra mendore, si shahu apo gjëzat, janë dy herë e gjysmë më pak të prirur të zhvillojnë sëmundjen e Alzheimerit.

## LEXIMI LARGON STRESIN

Nëse zhyteni në një libër të mirë ju ulni nivelet e hormoneve të stresit si kortizoli. Në një studim britanik, pjesëmarrësit u angazhuan në një aktivitet që provokonte ankth, dhe më pas ose lexonin për disa minuta, ose dëgjonin muzikë, ose luanin lojëra video.

Nivelet e stresit të atyre që lexuan ranë 67 për qind, gjë që ish-

te një rënie më e madhe sesa ajo e grupeve të tjera.

## JU RRIJT FJALORIN

Edhe në qoftë se keni qenë dekada që s'jeni shqetësuar për provimet, ju ende mund të përdorni libra për të zgjeruar fjalorin tuaj mendor. Në fakt, studiuesit vlerësojnë se ne mësojmë pesë deri në 15 përqind të të gjitha fjalëve që njohim përmes leximit, sipas një raporti skollastik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët, madhësia e fjalorit të të cilëve është direkt dhe dramatisht e lidhur me librat që lexojnë.

## KUPTOJMË MË MIRË TË TJERËT

Tregimet që lexojmë ofrojnë perspektivë që ndryshon jetën, thonë studiuesit e Universitetit të York-ut. Përfshirja në jetën e personazheve forcon aftësinë tuaj për të kuptuar ndjenjat e të tjerëve. Për shembull, duke e parë botën nëpërmjet syve të Jane Eyre, mund ta bëni më të lehtë që të lidheni me pikëpamjen e motrës suaj.

## INKURAJON PËR OBJEKTIVAT QË KENI NË JETË

Leximi për një personazh që kapërcen pengesat mund t'ju motivojë për të përmbushur qëllimet

tuaja, sipas një zbulimi nga studiuesit e Universitetit Shtetëror të Ohajos. Nëse dëshironi një ngritje në pagë, ndjekja e një personazhi në zyrën e shefit mund t'ju japë guximin për të bërë të njëjtën kërkesë. Sa më shumë që identifikoheni me një personazh dhe përjetoni ngjarjet sikur po ndodhnin me ju, aq më shumë do të jeni në gjendje për të ndërmarrë veprime.

## NDIHMON TË NDJEHENI MË TË LIDHUR

Kur identifikoheni me personazhe në një libër, përjetoni një lloj marrëdhënieje të vërtetë që mund të rrisë ndjenjën tuaj të përfshirjes, thonë psikologët në Universitetin e Buffalos. Me fjalë të tjera, leximi i Marley & Me mund të rrisë bashkëpunimin me pronarët e qenve në park.

## MUND T'JU NDRIÇOJË DITËN

Një fund i lumtur ju ngre humorin, por romanet mund të na nxisin ndjenja pozitive edhe në mënyra më direkte. Edhe ngjarjet më të vogla në rrëfime mund të na zbulojnë kujtime të ngrohta. A merr pjesë personazhi kryesor në një barbeky në plazh? Me shumë gjasë do të kujtoni një festë ku ju keni marrë pjesë. (bota.al)

## HARUKI MURAKAMI, I PËRKTHYER NË 50 GJUHË

Shkrimtari japonez me famë botërore, Haruki Murakami, është cilësuar si njëri ndër 100 njerëzit me më së shumti ndikim në botë dhe duhet të lexoni disa nga veprat e tij, të cilat janë të jashtëzakonshme.

Librat e tij janë përkthyer në 50 gjuhë, janë komentuar dhe blerë jashtëzakonisht shumë – ky është ndikimi që mban emrin 'Murakami'.


"Killing Commendatore" (Vrasja e Kryekalorësit) është një nga veprat e tij të fundit – më 2017 kur libri doli në shitje qindra lexues pritën në radhë për shumë ditë, vetëm dhe vetëm që ta kenë një kopje të tij. Në edicionin e parë ishin shtypur 1 milion kopje të librit, gjë që është e rrallë në mesin e botuesve.

Romani përmban një zile misterioze që tringëllon vetveti. Një ide abstrakte që vjedh trupin e një njeriu të shkurtër në pikturë; dhe

një udhëtim i çuditshëm në një nëntokë të frekuentuar. Ndër të tjera, edhe disa metafora të dyfish-ta të frikshme.

Ky është Murakami, trillimet intensive të tij të popullarizuara prekin kufijtë ndërmjet realitetit dhe surrelizmit, jetës së zakonshme dhe asaj fantastike, të rregulltës dhe ngjarjeve të çrregullta, transmeton Klan Kosova.

"Vrasja e Kryekalorësit" është roman i vështirë për t'u shpjeguar, por prek shumë nga temat e njohura në romanet e Murakami: misterin e dashurisë romantike, peshën e historisë, transcendencën e artit, gjëra të pakapshme për qenien tonë.



Karriera e autorit japonez filloi me romanin "Dëgjojeni erën të këndojë", ndërkaq ai u bë sensacion kombëtar në vitin 1987 me publikimin e librit "Pylli norvegjez", novela e tij më reale, e cila më vonë


u bë edhe film.

Përveç romaneve, ai gjithashtu shkruan tregime të shkurtra dhe letërsi artistike që ai i përkthen nga anglishtja në japonisht.

Ai është një vrapues i zellshëm dhe një dëgjues i muzikës së zhurmshme. Ai në intervista shpesh ka folur për misteret e procesit krijues, dashurinë e tij për hekurrosjen, dhe ka shpjeguar se si natyra e tij e disiplinuar dhe respektimi i orarit të rreptë të punës, i ndihmon atij në çlirimin e imagjinatës së çuditshme, transmeton Klan Kosova.

Në Ditën Ndërkombëtare të Librit mos e lini pa blerë ndonjë nga veprat e Haruki Murakami; gjithmonë ju lënë pa frymë.

Librat që janë të përkthyer në gjuhën shqipe: "Pylli norvegjez", "E dashura ime Sputnik", "Kronikat e Zogut Kurdisës", "Kafka në breg", "Elefanti zhduket", "Në jug të kufirit në perëndim të diellit", "I pangjyri Tsukuru Tazaki dhe vitet e tij të pelegrinazhit"



## Fakte të reja për Skënderbeun nga Kristo Frashëri

Kolana prej 10 vëllimesh e akademikut dhe historianit Kristo Frashëri me titull Skënderbeu dhe Lufta shqiptaro-osmane në shek. 15 u prezantua nga Akademia e Shkencave 3 vjet pas vdekjes së tij. Vepra voluminoze sjell fakte të reja te mbështetura mbi dokumentet e arkivave europiane. Ashtu siç pati deklaruar dikur vete autori hero i kombëtar i shqiptarëve Gjergj Kastrioti Skënderbeu vjen përmes dokumenteve dhe jo përrallave. Gjergj Frashëri djali i historianit te njohur kujtoi përpjekjet e babait te tij për te ndriçuar njërin prej etapave te rëndësishme të historisë se Shqipërisë. Me rastin e botimit te kolanes, historiani Kristo Frashëri u dekoruar nga Presidenti i Republikës.

# ORGANIZATA E ARBITRAVE MBAJTI FORUM PËR RREGULLAT E REJA NË FUTBOLL

FFM organizoi forum me përfaqësuesit e mediave për sport, gjegjësisht gazetarë që raportojnë apo komentojnë ndeshje të futbollit. Tema kryesore ishte në lidhje me rregullat e reja në lojën e futbollit të cilat do të hyjnë në fuqi në qershor dhe do të aplikohen në të gjitha garat nën organizim të UEFA-së dhe FIFA-s

Shkup, 24 prill - Federata e futbollit të Maqedonisë organizoi forum me përfaqësuesit e mediave për sport, gjegjësisht gazetarë që raportojnë apo komentojnë ndeshje të futbollit me personat udhëheqës të Organizatës së Arbitrave të FFM-së, Emil Bozhinovski (president i Këshillit të Arbitrave dhe Marjan Risteskit (anëtarë i Këshillit të Arbitrave dhe kontrollor për arbitra në ndeshjet e organizuara nga FFM). Tema kryesore ishte në lidhje me rregullat e reja në lojën e futbollit të cilat do të hyjnë në fuqi në qershor dhe do të aplikohen në të gjitha garat nën organizim të UEFA-së dhe FIFA-s. Në forumin me gazetarë u prezantuan edhe video inçizime (momente të dyshimta) nga ndeshjet e Ligës së Parë të futbollit të Maqedonisë dhe në mënyrë të detajuar u sqaruan vendimet e arbitrave që kishin provokuar kujdes të veçantë nga mediat, bile jo rrallë edhe aku-



za për gabime eventuale të arbitrave për vendimet e marra. Përfaqësuesit e Organizatës së Arbitrave potencuan se referimi në ndeshjet e organizuara nga FFM pas çdo ndeshje analizohet në mënyrë të detajuar. Ata shtojnë se gabime ndodhin, ashtu si që jemi dëshmitarë të gabimeve edhe nga ana e aktorëve tjerë në futboll (futbollistë, portierë, trajnerë), mirëpo në përgjithësi janë të kënaqur me drejtësinë, të qenurit principelë dhe të vendosur në respektimin e rregullave të lojës së futbollit nga ana e arbitrave.

## NDRYSHIMET QË DO TË HYNË NË FUQI NGA MUAJI QERSHOR:

- Lojtari i zëvendësuar mund (duhet) të del nga terreni në cilëndo pjesë, jo si bëhej deri tani në mes të terrenit të arbitri i katërt apo vendi ku qëndron futbollisti që inkuadrohet në lojë;

- Maicën që lojtarët e mbajnë nën fanellën me krahë të shkurtra, patjetër të jetë me ngjyrë apo laramani të njëjtë si vetë fanella;

- Nëse arbitri tregon fundin dhe lojtarët nisen drejt dhomave të zhveshjes, nëse ka sugjestion nga VAR për penalti eventuale, ai patjetër t'i kthejë lojtarët në terren për t'u ekzekutuar penaltia. Kjo mund të ndodh edhe pas fundit të pjesës së parë;

- Lojtari i lënduar ndaj të cilit ndodh ndërhyrja për penalit, mund të merr ndihmë mjekësore deri në tre minuta për të mundur pikërisht ai të ekzekutojë goditjen nga 11 metra;

- Nëse arbitri prek topin, loja ndërpritet. Rastet kur loja vazhdon pa u ndërprerë është nëse nuk ndryshon posedimi i topit në aspekt të ekipit;

- Loja ndërpritet nëse lojtari sulmues me apo pa dashje luan me dorë dhe shënon gol, pa marrë parasysh nëse dora është apo jo në pozicion natyral. Nuk guxon kontakti i fundit para se të ndodh gol të jetë me dorë;

- Në rastet kur lojtari e heq fanellën për të festuar golin e shënuar dhe i njejtë anulohet nga

VAR-i për një arsye të caktuar, atëherë goli anulohet, ndërsa kartoni mbetet në fuqi;

-Penalti për prekje të topit me dorë do të fërsëllehet vetëm nëse dora është lartë, që do të thotë ndodhet në një pozitë të panatyrshme.

- Në rastet e ekzekutimit të goditjeve të dënimit nuk ka të drejtë asnjë lojtari i ekipit që ekzekuton goditjen të qëndrojë në murin e gjallë dhe detyrimisht distanca më e vogël të jetë 1 metër nga muri i gjallë i vendosur nga lojtarët e ekipit që mbrohet. Nëse ka shkelje të këtij rregulli, topi i merret ekipit që ekzekuton goditje dënimi;

- Para ekzekutimit të penalltisë, portieri nuk do të jetë i detyruar të qëndrojë me dy këmbët në vijën e portës, dhe në të ardhmen mjafton që vetëm njërin këmbë ta ketë në vijën e portës.

- Gjatë ekzekutimit të rivënies anësore, nuk guxon të ketë lojtar kundërshtar në afërsi më të vogël se 2 metra nga lojtari që e ekzekuton atë.




## Alioski: Do të kthehem më i fortë

Shkup, 24 prill - Reprerentuesi i Maqedonisë Ezgjan Alioski do t'i mungojë Lids Junajtedit në ndeshjet e mbetura të sezonit. Alioski ka operuar meniskun e këmbës së majtë, pasi në ndeshjen ndaj Brentfordit mori dëmtim serioz, që detyroi të largohet nga fusha që nga minuta e 11. "Ne jemi të zhgënjyer me lajmin që Gjani nuk do të mund të luaj deri në fund të sezonit. Ai tregoi kualitetin e tij gjatë gjithë sezonit, duke luajtur në pozicione të ndryshme. Alioski është futbollist i dëshiruar në skuadrën tonë, gjithmonë i vendos bashkëlojtarët në rend të parë dhe është shembull për të gjithë në skuadër", ka thënë drejtori sportiv i Lids Junajtedit, Viktor Orta. Nga ana tjetër pas operimit Alioski ka falënderuar të gjithë për përkrahjen që i është bërë. "Falënderoj të gjithë për dëshirën e mira si dhe porositë për mbështetjen. Do të kthehem më i fortë, forca Lids", shkroi Alioski në rrjetet sociale. Alioski me shumë gjasa do të mungojë edhe në dy ndeshjet e radhës eliminatore "Euro 2020" që Maqedonia do t'i luajë në muajin qershor kundër Polonisë dhe Austrisë.



## Maqedonia U18 barazon me Shqipërinë

Shkup, 24 prill - Të martën është zhvilluara takimi i parë kontrol-lues mes Shqipërisë U-18 dhe Maqedonisë së Veriut U-18. Ndeshja është mbyllur me barazim 2-2. Ndeshja nisi më mirë për 18-vjeçarët e Shqipërisë që që gjetën avantazhin me Neshat Muratin në pjesën e parë. Maqedonia arriti të barazon në pjesën e dytë, ku në minutën e 65 me anë të Behar Fetës, por vetëm pesë minuta më pas, Sulovari nga pika e bardhë e penalltisë riktheu avantazhin tek të besuarit e Dedes. Maqedonia në minutat e fundit të takimit arriti përsëri të barazon shprat në 2:2, me anë të Metodij Maksimov. (F.N)



Tifozët e Arsenalit dhe analistët e futbollit në Angli e kritikuan ashpër mbrojtësin e Arsenalit për paraqitjen e tij kundër Crystal Palace, mirëpo trajneri i tij thotë se ai është lojtar shumë i mirë. Trajneri i Arsenalit, Unai Emery, insistoi se Shkodran Mustafi është mjaftueshëm i mirë për të luajtur për Arsenalin, përkundër që paraqitet e qendërmbrojtësit nuk kanë qenë edhe aq të mira gjatë kohës së fundit. 27-vjeçari ka hasur në shumë kritika që kur u transferua nga Valencia në vitin 2016 për

## Emery i del në mbrojtje Mustafit

40 milionë euro. Mirëpo, Emery nuk ka asnjë dyshim për aftësinë e përfaqësuesit gjerman, duke e theksuar paraqitjen e tij të mirë në fitoren 1:0 kundër Watfordit, më 15 prill. "Dua t'i mbroj lojtarët. Mustafi është lojtar shumë i mirë, qendërmbrojtës shumë i mirë. Ai e ka zakon të bëjë ndërhyrje dhe të shtrihet në tokë, duke e përdorur parashikimin e tij kundër rivalëve", është shprehur Emery. "Ai mund ta fitojë një ndërhyrje, dy, tri apo katër – por, nëse e humb një dhe ne pranojmë gol, kjo mbetet në mendje. Kam folur me të, i kam thënë: "Ti je i ri, mund të përmirësohesh dhe duhet të punosh shumë sepse ke shumë talent për pozitën e qendërmbrojtësit". "Për shembull, kundër Watfordit, ai ishte më i mirë ndër të gjithë, ai e fitonte topin në ajër me kokë dhe kjo është një statistikë shumë e mirë për të. Të dielën e kishite më të vështirë kundër Christian Bentekes, mirëpo dueli ishte 50-50". Emery ka kaluar nga formacioni me katër mbrojtës tek ai me tre e anasjelltas gjatë këtij sezoni të tij të parë në Premierligë dhe spanjollli beson se Mustafi luan

më mirë kur luan edhe me dy qendërmbrojtës të tjerë. "Kur i përdorim tre qendërmbrojtës, i mbrojmë ata më shumë. Ti mund ta humbasësh një ndërhyrje, por janë edhe dy lojtarë të tjerë. Kur ke vetëm dy qendërmbrojtës, nëse njëri e humb topin, mbetet vetëm një lojtar prapa. Kjo po i ndodh shpesh Mustafit, por unë dua që ai të mos bëjë ndërhyrje duke rrëshqitur në tokë çdo herë". "Duhet të jesh i mençur për momentet kur mund të bësh ndërhyrje të tilla, ta vlerësosh kur është momenti i duhur e kur jo. Por, kjo është pjesë e procesit". Mustafi e lejoi Wilfried Zahan ta kalojë atë lehtësisht për golin e dytë të Crystal Palace, mirëpo Emery nuk e fajëson atë. "Ai është i ri, është duke u përmirësuar dhe të dielën u fokusua tek ai për shkak të golit të dytë. Mirëpo, nuk është faji i tij. Gabimi ishte taktik sepse ne duhet ta mbrojmë atë me edhe dy qendërmbrojtës të tjerë kundër Zahas. Unë e mbroj sepse i besoj atij". Arsenali është në pozitën e pestë në tabelën e Premierligës, me një pikë prapa Chelseat në vend të katërt.



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KOMUNA KUMANOVË

Sektori për urbanizëm

21-1710/  
23.04.2019

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 i Ligjit për Ligjin e planifikimit hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr.5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 e Statutit të Komunës së Kumanovës ("Lajmëtar zyrtar i Komunës së Kumanovës nr. 13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës e jep këtë njoftim:

**NJOFTIM**

Për organizim të Anketës publike dhe Prezantimit publik në lidhje me:

- o Projektin urbanistik arkitektonik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje me klasë themelore për qëllim A1 të PK 24871/2-pjesa, PK 24871/1- pjesa, PK 26357/10 dhe PK 26357/1-pjesa KK Kumanovë, nga PDU për lagjen "Zelen Rid", dokumentacioni teknik nr.0701-133 i përpunuar nga "KVADAR" SHPK - Shkup
- o Projektin urbanistik arkitektonik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje me klasë themelore për qëllim A1 të PK 24983, PK 24984/pjesa, dhe PK 24987/pjesa KK Kumanovë, nga PDU për lagjen "Goce Dellçev", dokumentacioni teknik nr.0701-66 i përpunuar nga "KVADAR" SHPK - Shkup
- o Projektin arkitektonik urbanistik i PK 785/1 me qëllim G2 - industri e lehtë dhe jo ndotëse, shtypore, fshati Dobroshan KK Dobroshan -Komuna Kumanovë, dokumentacioni teknik nr.64/17 i përpunuar nga "INGRA" SHPKNJ -Shkup

Anketa publike dhe Prezantimi publik në lidhje me Propozim PDU-të do të realizohet me daljen e Propozim PDU-ve në Sirtarët e Komunës në sheshin e qytetit, të cilat ndodhen në ish "Tutun" - Kumanovë.

Anketa publike do të zgjasë 5 ditë pune duke filluar nga 06.05.2019 deri më 13.05.2019.

Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet fizike dhe juridike të interesuar informacione më të hollësishme mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm dhe veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Gjatë anketës publike propozime dhe vërejtje në fletat anketuese mund të parashtrihen të gjithë subjektet fizike dhe juridike të interesuar.

**PREZANTIMI PUBLIK**

Më datë 08.05.2019 në ora 12:00, në sallën e takimeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantimi publik me prezantim profesional të

- o Projektin urbanistik arkitektonik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje me klasë themelore për qëllim të A1 të PK 24871/2 pjesa, PK 24871/1- pjesa, PK 26357/10 dhe PK 26357/1-pjesa KK Kumanovë, nga PDU për lagjen "Zelen Rid", dokumentacioni teknik nr.0701-133 i përpunuar nga "KVADAR" SHPK - Shkup
- o Projektin urbanistik arkitektonik për ndryshim të kufirit të dy parcelave ndërtimore fqinje me klasë themelore për qëllim të A1 të PK 24983, PK 24984/pjesa, dhe PK 24987/pjesa KK Kumanovë, nga PDU për lagjen "Goce Dellçev", dokumentacioni teknik nr.0701-66 i përpunuar nga "KVADAR" SHPK - Shkup
- o Projektin arkitektonik urbanistik i PK 785/1 me qëllim G2 - industri e lehtë dhe jo ndotëse, shtypore, fshati Dobroshan KK Dobroshan -Komuna Kumanovë, dokumentacioni teknik nr.64/17 i përpunuar nga "INGRA" SHPKNJ -Shkup

Kryetari i Komunës  
Maksim  
Dimitrievski

Në bazë të nenit 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollorë të nxënësve të shkollave të mesme, ndërsa në lidhje me ekskursionet e planifikuara në Programin për punë për vitin shkollor 2018/19, Komisioni për grumbullim të ofertave për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm nga Shkolla e mesme e qytetit të Shkupit, Gjumnazi "Rade Jovçevski-Korçagin" - Shkup publikon

**SHPALLJE PUBLIKE PËR PARASHTRIM TË OFERTAVE**

për ekskursion të nxënësve nga viti I dhe II në relacionin Shkup - Ohër - Shkup

**Dita e parë** - Nisja e grupit në ora 07:30 para shkollës. Nisja për Ohër me vizitë gjatë rrugës të Manastirit Shën Jovan Bigorski, shëtitje panoramike të HE Shpilje, HE Gllboçicë, vizitë Vevçani dhe Strugë - shtëpia e vëllezërve Milladinovci. Në orët e mbrëmjes arrijtje në Ohër. Akomodim në hotel. **Darkë. Fjetje.**

**Dita e dytë - Mëngjes.** Pas mëngjesit vizitë Ohrit, qytetit i cili është i mbrojtur nga UNESCO: Samoiloova tvrdina, Teatri antik, Plaoshnik, Shën Jovan Kaneo, Universiteti Shën Kliment, Sveta Sofija, Çarshia e vjetër. Në orët e pasditës nisja për Shkup. Arrija në Shkup në orët e mbrëmjes.

**Koha e realizimit:** Dekada e tretë e muajit maj  
**Kriteret për dhënie të marrëveshjes:** Çmimi më i ultë

Ofertuesit duhet t'i plotësojnë kushtet minimale në vijim:

- të jetë i regjistruar sipas dispozitave pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë përkatëse turistike. **Dëshmi:** Licencë A valide për kryerjen e veprimtarisë turistike në emër të ofertuesit e vërtetuar me vulë e besueshme në origjinalin
- të ketë realizuar së paku 3 (tre) ekskursione të nxënësve dhe aktivitete tjera të lira në 3 (tre) vitet e fundit. Dëshmi: Së paku 3 (tre) marrëveshje për organizim të ekskursioneve dhe aktivitete tjera të lira të shoqëruara me 3 (tre) vërtetime për realizim kualitativ, të saktë në kohë dhe profesional
- të bëjë para rezervim për akomodim të grupit në një hotel
- t'i plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve sipas Ligjit për siguri në komunikacion të rrugës dhe Rregullores për kërkesa të veçanta teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve. **Dëshmi:** Deklaratë që nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale që operatori ekonomik i cili do të paraqitet si ofertues ka mundësi të sigurojë ofertë për transport sipas kushteve për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion të rrugëve dhe Rregullores për kërkesat e veçanta teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

**Ofertat nuk duhet të përmbajnë zgjedhje alternative. Oferta e cila ka elemente ose shërbime plotësuese nuk ka përparësi gjatë vlerësimit të saj.**

Çmimi i ofertës duhet të jetë fikse, gjegjësisht nuk lejohet korrigjim i çmimit gjatë realizimit të marrëveshjes.

Ofertuesi i përzgjedhur në ditën e lidhjes së marrëveshjes duhet të sigurohet garanci bankare në shumën prej 5% nga vlera e marrëveshjes.

**Në ofertë duhet të theksohet:**

- o Emri i subjektit juridik, nënshkrimi i personit përgjegjës dhe vulë
- o Çmim individual dhe të përgjithshëm të shërbimeve (transport, akomodim dhe ushqim)
- o Kushtet për akomodim, meny, transport
- o Në çmim hyn edhe sigurimi i veçantë i nxënësve
- o Mënyra e pagesës
- o Udhëheqës, numri i mësimdhënësve, mjek
- o Kushte të volitshme për nxënësit që rrjedhin nga familjet e prekura sociale.

**Afati për parashtrim të ofertave:** 5 (pesë) ditë duke mos e llogaritur ditën e publikimit.

**Mënyra dhe vendi për parashtrim të ofertave:** Në zarf të mbyllur në Arkivin e SHMQSH Gjumnazi Rade Jovçevski - Korçagin, ose përmes postës në adresën "III Makedonska udarna brigada" numër 9, Shkup, me të vetmën shenjë: "Deri te Komisioni për realizim të procedurës për zgjedhje të personit juridik për realizim të ekskursionit shkollor".

Hapja dhe vlerësimi i ofertave do të bëhet në hapësirat e Gjumnazit Rade Jovçevski - Korçagin dhe i njëjti nuk do të jetë publik.

Komisioni për grumbullim të ofertave

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KOMUNA E BOGOVINËS

Nr.10-818/1  
24.04.2019

Në bazë të nenit 55 të ligjit për tatime në pronë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.61/04...23/16),nenit 16 të ligjit për taksë komunale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.61/04...23/16) dhe nenit 84 të ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.124/15), kryetari i komunës së Bogovinës, publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për dorëzim në mënyrë të rregullt të AKTVENDIM PËR NDALESË TË SHFRYTËZIMIT TË MJETEVE për borxh tatimor në bazë të taksës komunale për emrin dhe tatim në pronë për të gjithë personat fizik dhe juridik që kanë detyrime tatimore ndaj komunës së Bogovinës.

**THIRRENI QË**

1. Ta merrni Aktvendimin për ndalesë të shfrytëzimit të mjeteve për borxh tatimor në bazë të taksës komunale për emrin dhe tatim në pronë për të gjithë personat juridik dhe fizik, përfundimisht me 31.12.2018 vit.  
**\*për obliguesit që kanë borxh dhe që nuk kanë pranuar Aktvendimin për ndalesë të shfrytëzimit të mjeteve (dorëzim jo i rregullt).**
2. Në afat prej 8 ditëve t'i shlyeni obligimet tatimore në bazë të taksës komunale për emrin dhe tatim në pronë për të gjithë personat juridik dhe fizik, përfundimisht me 31.12.2018.

Obligimet mund t'i paguani në këto llogari:

Pranuesi	Llogaria e thesarit
Banka e pranuesit	Banka Popullore e RM
Llogaria	100 000000630 95

Nr.rend.	Lloji i tatimit	Llogaria pagesore	Shifra hyrëse
1.	Për emërtim të hapësirave afariste(taksa komunale për firmën)	840-105-03210	717112
2.	Tatim në pronë për personat fizik	840-105-02507	713111
3	Tatim në pronë për personat juridik	840-105-02512	713113

Në pajtim me nenin 84 paragrafi 6 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative. Kjo shpallje hynë në fuqi me ditën e publikimit të saj dhe llogaritet se pala është njoftuar me shkrim përmes -dërgesës së drejtë. Për pasojat negative (pagesë e dhunshme, ndëshkim në para, shpenzime plotësuese etj.), që eventualisht mund të shfaqen, ato do t'i mbulojë vet pala.

Në qoftë se keni kryer pagesa që nuk janë evidencuar ose nevojitet të bëhet nivelizimi i tyre mbi bazën e borxhit/kërkesës, Ju lutemi t'i drejtoheni komunës së Bogovinës, Njësia e administrimit me të hyra (zyra për tatime) për të dorëzuar dëshmi për pagesat e kryera ose na kontaktoni në adresat e poshtëshënuara.

Adresat e kontaktimit:  
Komuna e Bogovinës, Bogovinë,  
e-mail: tatime@komunabogovine.gov.mk  
www.komunabogovine.gov.mk

Komuna e Bogovinës  
Kryetar  
Albon Xher

Në bazë të nenit 97 paragrafi 3 të Ligjit për arsim të lartë dhe nenit 121 paragrafi 4 dhe 5 të Statutit të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" - Manastir, si dhe në bazë të Vendimit të Senatit universitar të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" - Manastir nr.14-593/11-2 të datës 22.04.2019, Universiteti "Shën Kliment Ohridski" - Manastir, publikon

**SHPALLJE PUBLIKE  
për zgjedhje të Rektorit**

Universiteti "Shën Kliment Ohridski" - Manastir e filloi procedurën për zgjedhje të Rektorit në zgjedhje të lira të drejtpërdrejta dhe sekrete nga ana e anëtarëve të këshillave mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimdhënës të njësive, për kohë prej tre vjet, gjegjësisht për periudhën prej 01.10.2019 deri 30.09.2022.

**Kushtet për zgjedhje të Rektorit:**

Kandidati për Rektor, duhet t'i plotësojë kushtet në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Të jetë profesor i rregullt

Kandidati për Rektor, ndaj Fletëparaqitjes është i detyruar të parashtrijë:

- Fletëparaqitje;
- Biografi me bibliografi;
- Vendim për zgjedhje në profesor të rregullt;
- Program për punë dhe zhvillim të Universitetit për periudhën e mandatit dhe
- Certifikatë të shtetësisë.

Kandidatët për Rektor duhet t'i parashtrijnë dokumentet e duhura në afat prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve pas ditës së publikimit të Shpalljes publike në gazetën ditore të shtypura "Nova Makedonija" dhe "Koha", deri te Komisioni zgjedhor universitar, Universiteti "Shën Kliment Ohridski" - Manastir, rr."Bul 1-vi Maj" pn Manastir, me shenjë "Për Shpalljen publike".

Personi për kontakt: m-r Ofelija Hristovska, tel 047-223-788, lokal 116.

Zgjedhja e kandidatit do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për arsim të lartë dhe Statusin e Universitetit "Shën Kliment Ohridski" - Manastir.

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera të nxënësve të shkollave fillore nr.19-2250/1 të datës 05.09.2013, Komisioni për organizimin dhe realizimin e ekskursionit të SHFK "Faik Konica" f.Sllupçan publikon:

SHFK "FAIK KONICA" f.SLLUPÇAN

Numri i arkivimit: 02-331/1

Data: 18.04.2019

**SHPALLJE  
për mbledhjen e ofertave**

**1. FURNITORI**

SHFK "Faik Konica" f.Sllupçan; tel. 031-462-173

Personi për kontakt: **Mevludin Avdija**; tel. 071-358-350

Informata plotësuese dhe dokumentet e tenderit mund të merren në SHFK "Faik Konica" f.Sllupçan

**2. OFERTUESI**

Të drejtën për të parashtruar ofertë e ka çdo objekt person juridik që është regjistruar sipas rregullave pozitive për ushtrimin e veprimtarisë turistike adekuate.

**3. LËNDA E FURNIZIMIT**

3.1 Realimi i ekskursionit njëditësh me nxënësit e klasave të V dhe VIII-ta në fillim të muajit qershor 2019 në Shkup - Saraj.

3.2 Realizimi i ekskursionit dyditësh nëpër Maqedoninë për nxënësit e klasës së IX në fillim të muajit qershor 2019 në Ohër dhe Strugë.

Për marrjen e dokumentacionit tenderues dhe Programit për realizimin e ekskursionit ofertuesit duhet të paguajë 3000 denarë në xh.ll. 742010548778713, deponent BPRM konto e të hyrave 723112, Programi N1.

**4. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E OFERTËS MË TË VOLITSHME**

Çmimi më i ulët për nxënësit.

**5. AFATI DHE MËNYRA E DËRGIMIT TË OFERTAVE**

Ofertat duhet të dorëzohen në afat prej 3 ditësh nga dita e parë e shpalljes në dy gazeta, drejtpërdrejt në shkollë ose me anë të postës në këtë adresë:

SHFK "Faik Konica" f.Sllupçan

1307 Likovë.

Periudha e vlefshmërisë së ofertave është \_\_\_\_ 2019.

Hapja e ofertave do të bëhet nga Komisioni për realizimin e ekskursioneve.

Nga Komisioni për realizimin  
e ekskursioneve

Janë përcaktuar edhe tri skuadra të tjera të NBA, që kualifikohen në raundin çerekfinal të "play off"-it: Toronto Raptors, Philadelphia 76ers dhe Portland Trail Blazers. Në gjysmëfinale të Konferencës së Lindjes, Raptors do të përballen me Philadelphia 76ers. Në gjysmëfinale të Perëndimit, Blazers do të ndeshen me fituesin e çiftit Denver Nuggets-San Antonio Spurs

NBA - PLAY OFF

# RAPTORS, 76-ERS E BLAZERS NË ÇEREKFINALE




Përcaktohen edhe tri skuadra të tjera në NBA që kualifikohen në çerekfinale të play off-it. Ato janë Toronto Raptors, Philadelphia 76ers dhe Portland Trail Blazers. Raptors i mbyllën në sfidën e pestë të serisë llogaritë me Orlando Magic (4-1), duke iu imponuar me rezultatin 115-96. Shkëlqyen për ekipin kanadez Kawhi Leonard dhe Pascal Siakam, që realizuan respektivisht 27 dhe 24 pikë. 5 minuta e 13 sekonda para rënies së sirenës për përfundimin e takimit Raptors kryesonin me +37 pikë (115-78) e pavarësisht rezultatit të pjesshëm 0-18 në favor të Magic, nuk e rrezikuan në asnjë moment suksesin. Ky është sezoni i katërt radhazi që Toronto Raptors e ka

lojnë raundin e parë të play off-it. Në gjysmëfinale të Konferencës së Lindjes Raptors do të përballen me Philadelphia 76ers, që me suksesin 122-100 ndaj Brooklyn Nets siguruan kualifikimin, duke e mbyllur serinë me rezultatin 4-1. Një përballje pa shumë histori kjo e "Wells Fargo Center" të Philadelphia, ku statistikat më të mira i kishte Joel Embiid: 23 pikë e 13 "rebound". Vlen të përmendet zënka masive dy minuta para fundit, që çoi në përjashtimin e dy lojtarëve për çdo skuadër,

të Greg Monroe e Jonah Bolden për 76ers dhe të Dzanan Musa e Rodions Kurucs për Nets. Verdicti i fundit u dha në Konferencën e Perëndimit, ku Portland Trail Blazers kaluan në raundin tjetër, pasi mposhtën 118-115 Oklahoma City Thunder, duke e mbyllur serinë me rezultatin 4-1. Paraqitje prej jashtëtokësori e Damian Lillard (rekord personal në play off), që shënoi plot 50 pikë, dha 6 asiste dhe kontrolloi 7 topa. Vendimtar në fitoren e skuadrës së tij, pasi realizoi trepikëshin e

fundit nga një largësi prej 11 metra. Në gjysmëfinale të Perëndimit Blazers do të përballen me fituesin e çiftit Denver Nuggets-San Antonio Spurs. "Në Pepsi Center" të Denverit, skuadra nga Colorado triumfoi 108-90 me teksanët, duke marrë kryesimin e serisë me rezultatin 3-2. Plot 6 basketbollistë të Nuggets arritën numër dyshifror pikësh, të udhëhequr nga Jamal Murray me 23 pikë, ndërsa Will Barton shtoi edhe 17 pikë të tjera. Takimi i radhës zhvendoset në Teksas.



## Shpallet i pafajshëm ish-presidenti i Barcelonës

Gjykata Kombëtare në Spanjë ka liruar ish-presidentin e Barcelonës Sandro Rosell, i cili qëndroi i burgosur për dy vjet në pritje të gjyqit, një rekord, sepse kurrë më parë një person nuk kishte qëndruar 643 ditë në burg parandalues (nga frika e largimit nga vendi) për një krim ekonomik në Spanjë. Po ashtu, është liruar edhe ortaku i tij, Joan Besoli, gjithashtu për mungesë provash. Rosell akuzohej për krijim organizate kriminale, shpërdorim fondesh dhe përvetësim të paligjshëm të tyre (rreth 20 milionë euro), nga shitja e të drejtave televizive dhe organizimi i miqësoreve të Brazilit, si dhe nga një kontratë sponsorizimi mes Brazilit dhe kompanisë Nike, për të cilën Rosell ka punuar si shef ekzekutiv në Brazil. Gjykata konsideroi se me provat e ofruara, akuzat kundër ish-presidentit të Barcelonës nuk janë vërtetuar. Prokuroria më herët kishte kërkuar 11 vjet burg dhe 60 milionë euro gjobë. Avokati i Sandro Rosell, Andrés Maluenda, tha pas vendimit: "Është një ditë për t'u festuar, besoj se familja e Rosell është shumë e lumtur. Ka qenë një rrugë e gjatë, plot vuajtje, në një proces mjaft të ndërlikuar. Nuk është normale që një person të qëndrojë 21 muaj në burg, pa u dënua, dhe më pas të lirohet. Na u mohua 13 herë kërkesa për lirim me kusht, në një rast ofruam deri në 35 milionë euro garanci".

## I bën 800 kilometra për ekipin e zembrës dhe zbulon se është i vetmi në stadium

Një histori e jashtëzakonshme dashurie për futbollin ka ardhur nga Spanja, ku Javi Jimenez, tifoz i Cordoba-s, klub që luan në kategorinë e tretë të futbollit spanjoll, ka bërë 800 kilometra, vajtje dhe kthim, për të mbështetur ekipin e zembrës në takimin kundër Real Oviedos. Pro-

blemi është se kur ka mbërritur në stadium ka zbuluar se ishte i vetmi tifoz që kishte ndjekur skuadrën, duke marrë falënderimet nga klubi dhe lojtarët. Ky ka qenë komenti i tij në Twitter: "Sipas mesazheve që qarkullojnë në internet, jam budalla. Nuk jam as i pari dhe as i fundit

që bën një gjë të tillë. Nuk jam në kërkim të famës. E bëj prej shumë vitesh dhe do të vazhdoj ta bëj për dashurinë që kam për këto ngjyra". Fatkeqësisht, ndeshja me Real Oviedo-n ka përfunduar 3-3, një rezultat që e largon akoma më shumë Cordoba-n nga mbijetesa.

Publicitet

IP Qendra Informativë kulturore - Shkup, Rr: "Filip Vtori Makedonski" pn - Shkup, publikon

## SH P A L L J E

Për dhënien me qira të pasurisë së patundshme (gjësë së paluajtshme) - hapësirë Objekt i ankandit publik është gjëja e paluajtshme (e patundshme) - hapësirë në IP Qendra Informativë kulturore - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut Rr: "Filip Vtori Makedonski" pn - Shkup, dhe atë:

Hapësirë prej 28m2, (tualet për meshkuj dhe femra me një pjesë të foajesë).

Çmimi fillestar i ankandit publik të hapësirës është 7.000,00 denarë pa llogaritjen e TVSH-së në muaj. Përdorimi i hapësirës nuk do të ndikon në sigurinë e të punësuarve, kafshëve dhe të vizitorëve - shfrytëzues të shërbimeve të Institucionit, si dhe te personat që do ta shfrytëzojnë hapësirën qiramarrëse.

IP Qendra Informativë Kulturore - Shkup, e jep me qira hapësirën me të vetmin qëllim që qiramarrësi duhet të bën rikonstruimin e të njëjtës hapësirë duke shtuar tualet për invalid edhe për gjininë mashkullore edhe atë femërore, sipas Ligjit për marrëdhënie pune nen 177, sipas Rregullores së mënyrës së sigurimit të qasjes pa pengesa, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me invaliditet deri dhe në ndërtime. Neni 4,5,6,12 dhe 32.

Me të drejtën e shfrytëzimit të hapësirës bartet edhe detyrimi për pagesën e shpenzimeve rrjedhëse komunale. Periudha e dhënies me qira të hapësirës është 1 vjet, por në qoftë se shfrytëzimi i hapësirës është i lidhur me investim nga ana e ofertëdhënësit më të volitshëm. Marrëveshja për qira mundet të lidhet edhe për periudhë më të gjatë, por jo më shumë se 5 vjet, dhe atë:

- Për investim deri më 3000 Euro në kundërvlerë në denarë, marrëveshja për qira mundet të lidhet për periudhë dyvjeçare;

- Për investim deri më 5000 Euro në kundërvlerë në denarë, marrëveshja për qira mundet të lidhet për periudhë trevjeçare;

- Për investim deri më 10.000 Euro në kundërvlerë në denarë, marrëveshja për qira mundet të lidhet për periudhë katërvjeçare;

- Për investim mbi 10.000 Euro në kundërvlerë në denarë, marrëveshja për qira mundet të lidhet për periudhë pesëvjeçare.

Investimet nuk mund të jenë lëndë kompensimi për hapësirën qiramarrëse në asnjë mënyrë E drejta për pjesëmarrjen në ankand, fitohet me bashkëngjitjen e dëshmisë (fletëpagesës) në shumë prej 590,00 denarë, më së voni 1 (një) ditë para mbajtjes së ankandit publik në xhirologari të IP Qendra Informativë Kulturore - Shkup, xhirologaria 785010886978719, numri i tatimit 4030990179124, numri amë 4142497 deponent Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe bashkëngjitjen e autorizimit me shkrim dhe gjendjen rrjedhëse të pjesëmarrësit.

Ankandi publik do të mbahet në hapësirat e IP Qendra Informativë Kulturore, Shkup, RMV - Rr: "Filip Vtori Makedonski" pn Shkup, më 02.05.2019 në ora 12:00.

IP Qendra Informativë Kulturore - Shkup.

## Nadal: Prej 18 muajsh po më mundim dëmtimet dhe jo rivalët

Rafael Nadal ka rrëfyer sot se dëmtimet e shpeshta fizike në muajt e fundit po e pengojnë që ai të ketë vijueshmëri në rezultate. Tenisti spanjoll u eliminua në gjysmëfinalen e turneut Masters të Montekarlos, një eliminim surprizë, duke qenë se këtu ai ka triumfuar 11 herë në karrierën e tij. Gjithsesi, Nadal shprehet se ky eliminim e ka një shpjegim. "Në 18 muajt e fundit kam patur shumë luhajtje për sa i përket lojës, kushtëzuar nga problemet fizike. Kjo nuk të lejon që të luash me besim te vetja dhe të ruash të njëjtin ritëm kudo. Shpresoj që në Barcelonë dhe Madrid situata të jetë ndryshe. Unë e kuptoj që nuk mund të fitoj në çdo turne që luhet në fushat me dhë, por do të përpiqem", tha Nadal. Duke folur për gjendjen aktuale, numri 2 në botë sqaron: "Fizikisht ndihem në përgjithësi mirë edhe pse vij nga një periudhë pak e ndërlikuar, ku problemet kanë pasuar njëri-tjet-



trin. Këtë vit nuk kam fituar asnjë turne dhe pikërisht ana fizike ka qenë shkaktar që nuk më ka lejuar të jap atë që unë dëshiroj në fushë", deklaroi Rafael Nadal.

Federata e Futbollit të Anglisë ka vendosur që t'i japë fund traditës së dhurimit të shisheve shampanjë fituesit të FA Cup në shenjë respekti për besimet fetare të futbollistëve

Shoqata e Futbollit do të heq traditën e dhurimit të një shisheje me shampanjë për ekipin fitues të finales së FA Kupës. Sipas "Daily Mail", organi drejtues ka vendosur që të heqin dorë nga ky veprim në mënyrë që të mos ofendohen lojtarët besimet fetare të cilëve ndalojnë konsumimin e alkoolit. Një gjë e tillë po ashtu do të shmang problemet që mund të shfaqen me lojtarë më të rinj sesa moshë ligjore për konsumim të alkoolit në Britani të Madhe. Në vend të shampanjës alkoolike, ata do të ofrojnë një shampanjë pa alkool për ekipin fitues. Ky veprim ka pasuar atë të Premier Ligës, që vendosi kundër dhurimit të shampanjës alkoolike për performancat e "lojtarit të ndeshjes" qysh më 2012. Vendimi nuk është marrë për shkak të ndonjë ankese nga fituesit e mëhershëm, dhe raportimi i "Daily Mail" thotë se FA-ja ka mun-


## KAMPIONËVE NË ANGLI S'DO T'U DHUROHET MË SHAMPANJË



dur të marrë këtë vendim edhe më herët, por s'ka dashur të konsiderohet si "prishës i festave". FA-ja ka punuar shumë që të luftojë problemet multi-racore dhe multi-fetare në futboll muajve të fundit dhe ky hap tregon përkushtimin e

tyre. "Ekipet fituese do të marrin një 'shampanjë' pa alkool për festimet e tyre në të gjitha garat e FA-së, duke nisur nga Finalja e sivjetme e Emirates FA Cup", ka thënë një zëdhënës i FA-së. "Kjo po bëhet për të garantuar se jemi

shumë përfshirës me lojtarët dhe komunitetet që mund të kenë të ndaluar alkoolin, e po ashtu edhe për lojtarë që janë nën 18 vjeç". Manchester City do të ndeshet me Watfordin në finalen e sivjetme të FA Kupës në Wembley.



### Milani kërkon Malcomin

Gazeta italiane e sportit, Corriere dello Sport, raporton se Milani i ka filluar bisedimet me futbollistin e Barcelonës, Malcomin, për ta transferuar gjatë afatit kalimtar të kësaj vere. Sipas disa burimeve nga Spanja, përfaqësuesit e Milanit tashmë janë takuar me disa anëtarë të stafit të Malcomit dhe aty i filluan diskutimet për mundësinë e transferimit të futbollistit. Brazili kishte qenë shumë afër transferimit në Romë verën e kaluar, mirëpo në momentet e fundit ishte vendosur që ai t'i bashkohej Barcelonës. Por, ky vendim mund të mos ketë qenë më i miri për të pasi që nga atëherë, ai i ka luajtur vetëm tri ndeshje në ligë këtë sezon. Gazeta italiane Corriere dello Sport shton se kuqezinjët ishin interesuar për Malcomin edhe gjatë afatit kalimtar të verës, mirëpo atyre u ishte thënë se 22-vjeçari do të kushtonte së paku 50 milionë euro. Në San Siro po ka ndikim gjithnjë e më të madh të brazilianve dhe drejtori sportiv i Milanit, Leonardo, tashmë e ka përforcuar skuadrën e tij me Lucas Paqueta. Problem te një marrëveshje e tillë mbeten telashet financiare të klubit italian, pasi që Milani është paditur sërish nga FIFA për shkeljen e rregullave të ndershmërisë financiare (FFP).



### Isco e refuzon Juventusin

Mesfushori spanjoll Isco e ka hedhur poshtë ofertën e Juventusit, sepse dëshiron të qëndrojë në Real Madridit, sipas El Chiringuito. Për të ardhmen e 27-vjeçarit është përflur shumë në vitin e fundit, për shkak se nuk parapëlqehet, sidomos nga ish-trajneri Santiago Solari. Por, tani, me kthimin e Zinedine Zidane, duhet se Isco dëshiron t'i tregojë vlerat dhe të vazhdojë me klubin madrilen. Juventusit e kishte përcjell nga afër situatën e spanjollit, por është refuzuar në përpjekje për ta transferuar atë në verë.

## Liverpooli e Chelsea në garë për yllin e Serie A

Dy gjigantët e futbollit anglez, Liverpool e Chelsea janë futur në garë për yllin e Napolit dhe të Serie A, Lorenzo Insigne. Liverpooli e Chelsea janë duke menduar për përforsimet që do t'i bëjnë gjatë verës që vjen. Dy gjigantët e Premierligës ia kanë vënë syrin sulmuesit të krahut të Napolit, Lorenzo Insigne. Lajmin e ka bërë të ditur e përditshmja italiane "Corriere dello Sport". Për momentin nuk ka pasur ndonjë ofertë konkrete,



por spekulimet e fundit thonë se largimi i lojtarit nga "San Paolo" në përfundim të sezonit është i mundshëm dhe se Premierliga është një opsion për të. Trajneri i

"Reds", Jurgen Klopp në të kaluarën e kishte shprehur admirimin për lojtarin, ndërkohë që Insigne ka raporte të shkëlqyeshme me ish-trajnerin e tij, Maurizio Sarri, aktualisht trajner i Chelseat. Edhe Parisi është një destinacion potencial, pasi në Paris Saint-Germain përfaqësuesi italian do ta gjente shokun e skuadrës tek "Azzurri", Marco Verratti. Insigne është njëri prej futbollistëve të krahut më të rrezikshëm në Evropë.

## Dhjetë mesfushorët e rinj më të vlefshëm në botë

Futbolli është i mbushur me plot futbollistë të rinj tejet të talentuar, të cilët kanë arritur ta dëshmojnë veten në ligat e mëdha të Evropës përkundër moshës së tyre dhe mungesës së përvojës. Në Premierligë, emra si Marcus Rashford, Gabriel Jesus dhe Declan Rice janë vetëm disa ndër ata që përmenden kur flitet për lojtarët që kanë qenë mbresëlënës në skenat e mëdha të futbollit qysh në fillim të karrierës. Ylli i Paris Saint-Germainit, Kylian Mbappe, njihet si lojtari më i mirë nën moshën 23-vjeçare dhe tashmë e ka sigu-

ruar medaljen e artë të Kupës së Botës dhe tri medalje të arta radhazi të Ligue 1. Për këta talente të rinj, klubet e mëdha të Evropës janë të gatshëm të shpenzojnë shuma marramendës parash, dhe transfermarkt e ka publikuar listën me top dhjetë mesfushorët më të vlefshëm, që janë nën moshën 23-vjeçare. Disa prej tyre, si Frenkie de Jong u Ajaxit që ka arritur marrëveshje me Barcelonën, ishin të pritshëm. Megjithatë, janë disa futbollistë në këtë listë që i kanë lënë të habitur tifozët e futbollit.

MOST VALUABLE CENTRAL MIDFIELDERS 23 AND YOUNGER			
RANK	PLAYER	AGE	VALUE
1.	DE JONG	21	€75M
2.	ARTHUR	22	€60M
3.	RODRIGO	22	€60M
4.	TORREIRA	23	€55M
5.	NDOMBÉLÉ	22	€50M
6.	AQUAR	20	€40M
7.	NEVES	22	€40M
8.	LO CELSO	23	€40M
9.	RUIZ	23	€40M
10.	RICE	20	€35M




## I DHANË 18 MUAJ JETË, I MITURI FITON BETEJËN ME TUMORIN NË TRU PAS 5 VJETËSH



Një djalë i diagnostikuar me kancer në tru ka arritur të mposhtë sëmundjen e rëndë pas një beteje 5-vjeçare. Daniel Morton ishte vetëm 10 vjeç kur doktorët e diagnostikuan me tumor në tru dhe mjekët i thanë se do të kishte maksimumi 18 muaj jete.

I mituri iu nënshtrua në atë kohë një operacioni të rëndë gjatë të cilit doktorët i hoqën një pjesë të madhe të tumorit në tru, por përsëri nuk i dhanë asnjë shpresë për jetë.

Kjo nuk e dorëzoi djalosin që vazhdoi me ngulm terapitë duke u bërë pjesë e një



programi për metoda të reja kundër tumorit në tru. Edhe pse i lodhur dhe i rënduar nga kimioterapitë e shumta nuk rehti kurrë se luftuari.

Pas shumë muajsh doktorët kuptuan që truri i tij filloi të stabilizohej. Sot ai është 100% i kuruar.



### Plaku i fut duart kujdestares, ajo e mbyll në ballkon!

Me justifikimin për ta për-qafuar, ai filloi të prekë nga gjoksi kujdestaren 30-vjeçare, me origjinë nga Santo Domingo. Një 80-vjeçar nga Ankona e Italisë, është bërë protagonist i një ngacmimi seksual. Megjithatë, gruaja nuk e humbi kontrollin, duke arritur ta tërheqë të moshuarin jashtë ballkonit të shtëpisë ku ndodhej. Këtu 30-vjeçarja i mbylli derën, duke bllokuar plakun e zjarrtë dhe të pushtuar nga epshi. Pastaj ajo paralajmëroi vajzën e 80-vjeçarit. Dominikania kishte filluar të punonte për pensionistin për pak më shumë se një javë më parë. Pas episodit të pakëndshëm, vajza e plakut vendosi të merrte një kujdestar tjetër, por këtë herë - ndoshta jo rastësisht - zgjodhi një burrë.

## Ky është shteti ku lexohet më së shumti në botë

Në mesin e 10 vendeve të para në botë ku lexohet më shumë libri ndodhen 6 vende aziatike dhe 4 vende evropiane. Megjithatë, tërheq vëmendjen India që është radhitur si vendi i parë në botë ku lexohet më shumë libri. Në nën-kontinentin indian çdo qytetar lexon mesatarisht më shumë se 10 orë në javë.

Dita e 23 prillit, festohet si Dita Botërore e Librit dhe e të Drejtave të Autorit me një vendim të marrë në Konferencën e 28-të të Përgjithshme në vitin 1995 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO).

Në Indi, që është në krye të listës si vendi ku lexohen më shumë libra në botë, çdo qytetar lexon rreth 10 orë e 42 minuta në javë. Ndërsa në vendin e dytë është radhitur Tajlanda ku



çdo qytetar lexon rreth 9 orë e 24 minuta dhe në vendin e tretë Kina ku çdo qytetar kalon 8 orë në javë duke lexuar libra.

## Një vendbanim në Rrafshnaltën e Golanit do të quhet "Donald Trump"



Izraeli njoftoi se do të emërojë një vendbanim në Rrafshnaltën e Golanit me emrin e Presidentit të SHBA-së, Donald Trump. Ky veprim, sipas autoriteteve izraelite, bëhet si shenjë mirënjohje për njohjen e sovranitetit të Izraelit në këtë rajon. "Të gjithë izraelitët e kanë

vlerësuar thellë vendimin historik të Presidentit Trump", tha kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu.

Ai tha se do ta paraqesë vendimin për miratim në qeveri pas festës së Pashkëve hebreje. Më 25 Mars, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, njohu sovranitetin e Izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit, rajon të cilin forcat izraelite e kanë pushtuar nga Siria në fazat e fundit të Luftës Gjashtëditëshe të vitit 1967. Duke nënshkruar njohjen zyrtare në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha se Shtetet e Bashkuara është dashur ta bëjnë një hap të tillë "disa dekada më parë".

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, qëndroi pranë Trump në Shtëpinë e Bardhë teksa ai e nënshkroi njohjen. Netanyahu tha se kjo është një "ditë historike" që i transformon "fitoret ushtarake të Izraelit në Rrafshnaltën e Golanit në fitore diplomatike".

1607 - Beteja e Gjibraltarit: Flota holandeze mund flotën spanjollo-portugeze.

1792 - Për herë të parë përdoret gijotina. Ekzekutohet banditi Nicolas J Pelletier.

1867 - Tokio hapet për tregti të jashtme.

1881 - Trupat franceze okupojnë Algjerinë dhe Tunizinë.

1898 - SHBA i shpall luftë Spanjës për shkak të Kubës.

1941 - Operacioni Merkur: Hitleri urdhëron pushtimin e Kretës.

1950 - Chuck Cooper bëhet zezaku i parë që luan në ligën NBA.

1953 - Shkencëtarët identifikojnë ADN.

1961 - Premieri i Katangës, Moise Tsjombe of Katanga arrestohet në Kongo.

1975 - Grihet në ajër Ambasada e Gjermanisë Perëndimore në Stokholm të Suedisë

1983 - Juri Andropov fton nxënësen amerikane Samantha Smith për të vizituar BRSS.



### ÇDO VIT 300 MILIONË KAFSHË NGORDHIN NË TESTIME LABORATORIKE

Sot është Dita botërore e mbrojtjes së kafshëve laboratorike. Më shumë se 150 vjet çdo ditë ndaj mijëra kafshëve kryhen eksperimente për qëllime mjekësore, kozmetike, ushtarake dhe industriale. Çdo vit në botë në eksperimente laboratorike ngordhin 300 milionë kafshë laboratorike të cilat shfrytëzohen sot, datojnë që nga shekulli i mesëm, por nuk japin asnjë rezultat. Dita botërore e mbrojtjes së kafshëve laboratorike shënohet që nga viti 1985.

### NË BURG

Dy të burgosur duke biseduar mes vete:

- Për çka të dënuan?
- E kum thyer një dritare në punë.
- Po a, e ku ke punuar?!
- Qaty bre, në një nëndetëse.



Lavdia jonë më e madhe qëndron jo në faktin që nuk dështojmë asnjëherë, por në faktin që ringrihem çdo herë që dështojmë.

(Konfuci)

KALENDARI HISTORIK 25 PRILL

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS